

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

834-32

g 96



tregime  
të zgjedhura

milto

sotir gurra ✓

814-32

PP6

S

MILTO SOTIR GURRA

MSB

TREGIME TË  
ZGJEDHURA



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## P A R A T H E N J E

### 1

Më 1908, njëzetekatër vjeçari Milto Sotiri, botoi në gazetën «Kombi» të shqiptarëve të Amerikës tregimin e tij të parë «Fyelli i fabrikës». Ky ishte një tregim i thjeshtë, që bënte fjalë për jetën e punëtorëve shqiptarë në Amerikë, por që ka rëndësi, sepse shënon fillimin e një veprimtarie të gjatë patriotike-letrare prej më shumë se gjysmë shekulli të shkrimitarit veteran Milto Sotir Gurra.

Shkrimitari Milto Sotir Gurra, hyri në letërsi në fillim të shekullit tonë, në prak të përpjekjeve të mëdha që bënnte populli ynë për çlirimin e tij kombëtar. Në këto përpjekje fisnike ai dha kontributin e tij si shkrimitar e publicist i palodhur.

I brumosur me idetë patriotike të rilindasve, duke jetuar pranë interesave të popullit, pa u shkëputur nga problemet e kohës dhe ngjarjet e ditës, i ushqyer nga idealet humanitare të letërsisë së madhe ruse, ai u bë një militant i çështjes shqiptare dhe u njoh si njeri i pendës në shtypin dhe botimet e kohës.

Milto Sotiri ose Milto Sotir Gurra, siç njihet në letërsi, lindi më 15 maj të vitit 1884 në fshatin Marjan të krahinës së Oparit. I ati, Ligori, i shtyrë nga vështirësitë eko-

*nomike, kishte emigruar prej kohësh më Odesë të Rusisë. Kur Miltoja ish në moshën 5 vjeçare, familja e tij u mbart nga fshati në Korçë. Këtu ai mbaroi shkollën plotore të qytetit, kurse më vonë e tërhoqi i ati në Odesë, ku kreua shkollën e mesme.*

Në këtë kohë, nëpër kolonitë shqiptare, dhe veçanërisht në koloninë e shqiptarëve të Amerikës, kishte marrë hov lëvizja patriotike, e cila drejtosej, jo vetëm kundër turqve, që e mbanin vendin tonë prej shekujsh në robëri, por edhe kundër shovinistëve grekë, që nën maska të ndryshme punonin në dëm të Shqipërisë. Për t'i ardhur në ndihmë lëvizjes për liri të popullit shqiptar filluan të ngrihen shoqëri patriotike dhe të dalin gazeta. Milto Gurra, që sapo mbaroi shkollën në Odesë, hidhet në Amerikë dhe bie në kontakt me këto përpjekje. Hyn punëtor në një fabrikë dhe, nga ana tjetër, vazhdon të punojë për çështjen e çlirimtë atdheut të largët. Së bashku me Fan Nolin e patriotë të tjerë lufton për shkëputjen e kishës shqiptare nga kisha greke.

Kur më 1908, në Amerikë shpërtheu një krizë e rënëdë ekonomike dhe u mbyllën shumë fabrika. Milto Sotir Gurra u kthye prapë në Rusi. Kësaj here nuk qëndroi shumë këtu, sepse ishte koha kur u shpall Hyrjeti. Edhe ai, si shumë patriotë të tjerë, i shtyrë nga shpresat e koiz, shkon në Stamboll e pastaj në Korçë. Pikërisht në këtë kohë ai nis aktivitetin letraro-publicistik: boton në kalendarin «Afërdita», që drejtonte Cile Vretua artikullin e tij të parë «Kur do të kemi opera në Shqipëri?», shkruan dramën «Nderi» që mbeti e pabotuar, boton tregimin e parë që përmendëm më lart dhe nis të përkthetë vepra të vogla nga letërsia ruse. Më vonë ai e zgjeron aktivitetin e tij letrar duke botuar tregime të ndryshme në përgazeta e kalendare dhe vëllime më vete.

Para shpalljes së pavarësisë, M.S. Gurra ishte redaktor i gazetës «Liria e Shqipërisë» në Sofie. Më vonë është nga redaktori i gazetës «Atdheu» në Shkodër.

Më 1914, kur fuqitë e mëdha vendosën të sjellin si mbret të Shqipërisë princ Vidin, Milto Sotir Gurra zgj-

*dhet si delegat i kolonisë shqiptare të Odesës dhe dërgohet në Shqipëri. Por pas largimit të princ Vudit dhe me fillimin e Luftës së parë botërore, ai kthehet për të fundit herë në Rusi. Këtu tani shkruan tregimet dhe novelat e tij më të mira. Kur triumfoi Revolucioni i Tetorit ai ndodhet në Peterburg dhe bëhet dëshmitar i ngjarjeve të mëdha.*

*Me të mbaruar lufta e parë botërore, ai vjen në atdhe. Në Shqipëri, në këtë kohë zjente një luftë e madhe politike. Milto Sotir Gurra merr pjesë në Kongresin e Lushnjës dhe zgjidhet si sekretar i delegacionit shqiptar që mori pjesë në Konferencën e Paqes të Versajës.*

*Në vitin 1921, ai kthehet përfundimisht në Shqipëri. Vendoset në Korçë dhe vazhdon të merret me aktivitet letrar publicistik. Fillon e nxjerr revistën letrare-kulturore «Shkëndia», revistën satiriqe «Zekthi» dhe bashkëpunon me organet e shtypit të kohës.*

Ardhja në fuqi e satrapit Zog pas luftës së ashpër politike që u zhvillua në vitet 20 ishte një goditje e rëndë për forcat demokratike në Shqipëri. Ishte dhe një goditje për shkrimitarin patriot Milto Sotir Gurra. Por, kur pas disa vjetësh, Zogu e stabilizoi përkohësisht situatën politike në vend dhe arriti të bënte me vete disa nga patriotët, duke spekulluar në ndjenjën e tyre të atdheda-shurisë, shkrimitari Milto Sotir Gurra, që kish luftuar për një Shqipëri të përparuar, pati edhe ai ndonjë moment çoroditje. Këtë shkëputje nga idealet e tij demokratike, Milto Sotir Gurra e kuptoi më vonë, me Luftën nacional-çlirimtare, të cilën e aprovoi dhe e përkrahu plotësisht.

Në vitet nga çlirimi e këtej shkrimitari patriot, megjithëse në një moshë të thyer, i entuziazmuar nga transformimet e përparimet e Shqipërisë së re, punon me zjarrin e një të riu, i bindur se vetëm në ditët tona, nën pushtetin popullor, ai sheh të realizuara e të çuara më tej idealet për të cilat ëndërrroi dhe luftoi gjatë gjithë jetë së tij.

*F. S. Noli, këtë gjë, do ta quajë privilegj, në një letër*

që do t'i shkruajë shokut të tij të vjetër, më 1964. Ndërmjet të tjerave, ai do t'i thotë:

«Që atëhere kohët kanë ndryshuar dhe kjo do të thotë se lufta juaj e gjatë ka pasur suksese. Ajo ka pasur më shumë suksese nga sa e prisnim. Ne që të dy kemi patur fatin se kemi rrojtur gjatë sa për ta parë këtë. Sa shumë të tjerë nuk e gjuan këte privilegj. Kështu, sidoqoftë, ne i përkasim grupit të fatlumëve. . .»

## 2

*Shkrimtari Milto Sotir Gurra ka një veprimitari letra-re prej më shumë se gjysmë shekulli. Krijimet e tij të para janë disa vjersha patriotike, të shkruara në vitet 1901-1903, nëpërmjet të cilave ai bënte thirrje për luftë të armatosur kundër turqve dhe radhitej kështu me krahun e përparuar të rilindasve.*

Më vonë, duke filluar nga viti 1908, shkrimtari patriot nis e shkruan tregime e artikuj, të cilat i boton në shtypin shqiptar të kohës, si në gazetat «Kombi», «Dielli», «Kaledar i kombiar», «Atdheu», «Liria e Shqipërisë» etj. Në prak të shpalljes së pavarësisë dhe veçanërisht në vjet 1912-1920, i frymëzuar nga ngjarjet e kohës, ai zhvilloi një punë të frytshme letrare. Të kësaj prejudhe janë dy vëllimet me tregime që boton në vitin 1911. «Goca e malësisë» dhe «Rrëfenja». Veç këtyre dy librave që ai shtyp në kolonitë shqiptare të Sofies boton edhe mjaft tregime me tematikë patriotike dhe shqërore, të cilat i gjejmë nëpër revistat, gazetat e kalendaret, që dilnin benda ose jashtë vendit.

Duke filluar nga viti 1921, shkrimtari ynë drejton në Korçë për tre vjet rrjesht revistën «Shkëndia», në të cilën boton shumë nga krijimet e veta. Bie në sy veçanërisht prodhimi i tij poetik, që ai publikon në këtë revistë. Këtu, përvëç krijimeve origjinale të autorit, do të gjejmë edhe mjaft përkthime nga letërsia ruse, si treg-

me të Gorkit, të Turgenjevit, vjersha të Pushkinit, Nikitinit etj. Puna e tij si përkthyes i parë dhe popullarizues i letërsisë së madhe ruse, shihet më mirë në vitin 1924, kur përktheu tri dramat e A.S. Pushkinit, «Mocarti dhe Salieri», «Kalorësi dorështrënguar» dhe «Rusalka».

Në këto vite Milto Sotir Gurra do të shkruajë në «Gazeten e Korçës» me dhjetëra skica letrare, nëpërmjet të cilave jepen mjaft aspekte të jetës shqiptare të asaj kohe. Në vitin 1925 ai përktheu komedinë «Fshatari zotni» të shkrimittarit danez L. Holberg. Punën e dobishme si përkthyes e zgjeron më shumë në vitin 1928, kur themelon «Bibliotekën e të rinjve» dhe boton gjashtë broshura me tregime nga të Gorkit, Çehovit, Tolstoit etj.

Gjatë kësaj kohe, ai nuk lë pas krijimet origjinale dhe, në vitin 1938, boton vëllimin me tregime «Plagët e kurbetit» që u mirëprit nga lexuesit dhe shtypi.

Disa vjet më vonë, më 1944, boton një vëllim tjetër me tregime: «Goca e Kaçanikut». Po këtë vit, drejton edhe revistën tërheqëse përfëmijë «Mituria».

Nuk po përmendim këtu shkrimet e tij për të vegjëlit, artikujt publicistikë, disa studime me karakter informativ mbi rilindasit tanë apo veprat e përkthyera si «Fajtorët pa faj» të A. Ostrovskit, tregime të M. Siberjakut etj.

Sic shihet nga sa shkruam më lart, shkrimitari Milto Sotir Gurra ka një aktivitet të gjerë letrar, aktivitet ky që i ka sjellë dobi zhvillimit të letërsisë dhe kulturës sonë.

Tregimet që po botojmë, të marra nga librat dhe shtypi, janë një pjesë e krijimtarisë shumëvjeçare të shkrimittarit tonë. Këto tregime të shkruara shumica në kohën kur vendosej fati i Shqipërisë, kur në sajë të një lufte të madhe, atdheu ynë po rilindej pas pesë shekuj rohërie, janë një dëshmi e gjallë, që rrëfejnë përpatriotizmin e shkrimittarit dhe ekzistencën e një letërsie që militonte në atë kohë përluftën e popullit.

Megjithëse vëllimi eshtë ndarë në katër pjesë, prapë-serapë atë e bashkon një ide e përbashkët dhe kjo ide eshtë dashuria përf Shqipërinë e robëruar dhe urrejtja kundër shtypjes së huaj.

Në pjesën e parë «Kur rilindej Shqipëria» kemi zgjedhur përgjithësisht tregime me tema patriotike, që pasqyrojnë pamje të ndryshme të luftës së shqiptarëve kundër pushtuesëve turq në fillim të shekullit tonë. Në pjesën e dytë «Plagët e kurbetit» hyjnë tregime që flasin për të këqijat e mëdha që i ka sjellë kurbetit popullit tonë, kurse në pjesë «të ndryshme» përmblidhen tregime me motive dashrie, të gërshtuara me ide patriotike si edhe tregime me subjekte të marra në përgjithësi ngajeta e rendë e vegjelisë shqiptare, pas shpalljes së pavarësisë.

Gjëja kryesore në këto tregime është fryma e shëndoshë që i përshkon. Kjo frymë e ka burimin në zjarrin patriotik, që kishte ndezur luftha për çlirim në zemrat e popullit tonë. Atdheu dhe fati i tij — ja tema qëndrore që kushtëzon fatin e heronjve dhe drejtimin e ngjarjeve pothuajse në të gjitha këto tregime.

Heronjt e tregimeve të Milto Sotir Gurrës janë njëz të thjeshtë, të dalë nga vegjelia e fshatit dhe e qytetit, janë ata që i kanë kthyer krahët parësise dhe kanë marrë përsipër çlirimin e vëndit nga sundimi i huaj. Këta janë luftëtarët trima që mbushin çetat e lirisë, njerëzit që përhapin idetë e luftës për çlirim, që shpërndajnë ilegalisht libra dhe gazeta patriotike, që bëjnë sakrifika të panumërt, njerëz me zemër të madhe, që japid edhe jetën për kauzën e lirisë. Kështu p.sh., në tregimin «Ustai dhe çiraku» tregohet se si një çirak jep rogen e tij të vogël për t'u pajtuar në një gazetë patriotike, kurse ustai i tij, një tregëtar i pasur refuzon të ndihmojë dhe të pajtohet në gazetë. Por për një çirak patriot që punon fshehurazi në qytet për çetat e lirisë ben fjalë edhe tregimi «Dy mendimet».

Tregimet mbi kurbetin janë faqe të dhimbshme të jetës sonë të kaluar, faqe që zbulojnë dramën e shumë familjeve shqiptare në të kaluarën. Ato flasin për lotët e nënave e të nuseve të braktisura, për ndarjet pa shpresë, për rrugët e gjata që marrin kurbetlinjtë, për varfërinë e tyre, për mallin dhe pendesën, për kthimin e tyre pranë vatrës të gjymtuar fizikisht e shpirtërisht. Shkrimtari

tregoi se realiteti i koruptuar i mërgimit prishte jetën e kurbetlinjve, i varféronte e i damkoste shpirtërish, Tregimet e kurbetit janë shkruar me ndjenjë, sepse autor i ka marrë vetë disa herë rrugën e rëndë të mërgimit.

Tregimet që përbledhin në këtë vëllim, mund të tingëllojnë në kohën tonë pak si naive, sentimentale dhe me tone didaktike. Është e natyrshme se, duke i parë këto tregime të shkruara shumë vjet përpata, me syrin e sotëm do të gjejmë dobësi artistike, të cilat në përgjithësi i takojnë edhe prozës sonë të asaj kohe. Por kjo nuk na pengon të konstatojmë talentin e autorit, fryshten patriotike dhe prirjen demokratike, thjeshtësinë, disa figura të goditura e mbi të gjitha fiksimin e jetës së vegjëlisë, mendimet dhe aspiratat e saj.

Shkrimtari M. S. Gurra është një autor që zë një vend të merituar në historinë e letërsisë sonë gjatë viteve të fundit të Rilindjes dhe të pas Rilindjes. Duke qenë bashkëkohës dhe shok ideje e pende i Nolit e i Gramenos, at u përpoq që, nëpërmjet veprave të veta, të përhapë idetë e luftës për çlirim, të forcojë në popullin tonë ndërgjegjen kombëtare dhe të kontribuojë në lëvrimin e letërsisë shqipe.

Botimi i kësaj përbledhjeje me tregime do t'i japë rast lexuesit, sidomos të rinjve të njohën disa nga faqet e prozës sonë të kaluar që pasqyroj përpjekjet kur rilindej Shqipëria, pas disa shekjush robërie.

1958-1972

Nasho Jorgaqi

## PRANVERA

Cikma u zhduk nga Shqipëria. Qielli i murmë mori prapë njyrrën e kaltër. Akulli u tret dhe, vetëm ujët e shumtë nëpër vijat, përrenjtë e lumenjtë na e kujton dimrin e shkuar.

Natyra që ishte e brengosur po buzëqesh se mbi të më nuk vjen rrrotull era e ftohtë e veriut, nuk fryn era e marrë, që ngreh furfuri nën, nuk bie borë, nuk bën cikmë, po fryn zefiri i hollë, që është pak i ftohtë natën, po i shëndetshëm. Qielli rri pa re. Dielli i lëshon shkëndijat e tij më drejt. Hëna ndrit natën me dritë të sërmajtë dhe yjet kanë më shumë dritë. Ja pse buzëqesh natyra!

Po buzëqesh tërë rodi i kafshëve, i bimëve, i shpehëve, i gjarpérinjve, i shtërpinjve, i mizave. Po buzëqesh stërgu me qipin e tij të gjatë, se kthehet prapë në viset e vjetra ku do të vejë, nëpër moçalet e para për të gjetur bretkosa e gjarpérushka. Buzëqesh qyqja, duke flutuar dru më dru, duke kënduar «ku-ku.. ku-ku» dhe duke kërkuar ndonjë çerdhe për të lënë vezët e saj. Buzëqesh duke na flutuar mbi krye dallëndyshja, ardhja e së cilës na tregon plotësisht ardhjen e pranverës, që ja thotë këngës së saj monotone e që shfaros mizat e vogla. Buzëqesh bilbili, duke kënduar bukur ferrave e duke na shpënë në qiejt e harmonisë. Buzëqeshin drurët, buzëqesh shelgu me degët e varura, buzëqesh plepi me trupin e hollë e të gjatë, buzëqesh pisha me bredhin, lisi me ahun, molla, kajsia, lajthia, dardha, duke lëshuar syçkat, që bëhen fletë dhe deçka dhe bëjnë atë hijen e shpeshtë, nën të cilën shkojmë vapën.

Me një fjalë natyra i shtyn gjithë gjërat e gjalla që të buzëqeshin në pranverë.

Po rodi i njerëzisë qesh apo qan?

Nuk dihet, ngaqë njerëzvet kujt i qesh buza në dimër, kujt në vjeshtë, kujt në verë dhe kujt në pranverë. Po neve, shqiptarëve, kur do të na qeshë buza? Neve që shohim gjithë natyrën si buzëqesh.

Po, po, do të buzëqeshin këtë verë, se do të hipim në majërat e maleve<sup>1)</sup> për të buzëqeshur më bukur e më ëmbël, se që atje e kemi diellin, yjet dhe qiellin më pranë. Vendin tonë do ta lëmë të buzëqesh si urdhëron natyra. Sikur fushat e vogla, të mbusheshin me misër, me grurë, me elb, me tershërë, me urov e me bimë të tjera!

Ka tre vjet që vendi ynë po buzëqesh pas qejfit të tij dhe lëndinat e bukura e të gjelbëra, që ishin mësuar të këmbenin fjalime të ëmbëla me dhentë, me shqerrat, me lopët, me viçat e me dhitë e kecat, po buzëqeshin me vetë-veten dhe po fjalosen me diellin, i cili i thau dhe ngjyrën e tyre të gjelbër e këmbeu me të verdhë. Fusha që ishte mësuar çdo vit të ngrinte një umbrellë të madhe dhe të mbrohej nga shkëndijat e zjarrrta të diellit vesor, sivjet do të jetë krahëhapur dhe do t'i presë me laki shkëndijat e diellit të fortë. Shtëpitë do të buzëqeshin gjersa përpinqet mbi to shkëndija e diellit dhe gjersa nuk ka zënë të gjëmojë me quell të kthjellët.

— Po ju, moj shqiptare, pse nuk buzëqeshni, kurse gjithë bota buzëqesh?

Kësaj pyetjeje m'i përgjegjet një zë plot pikëllim:

— Përse më pyet? Apo që të m'i lëndosh plagët dhe të m'i malcosh?

— Po, a do të mund unë kërcurja të buzëqesn, kur burri s'më ka bërë gjashtë muaj, djali s'më ka bërë një mot që janë vrarë, e kur vajza ndodhet në duart e turqvet?

A do të mund të buzëqesh, kur hambarin e kam të zbrazët, kur dhentë e dhitë m'i rrëmbyen, kur mallin ma plaqkitën, kur gjënë e gjallë dhe shpendët m'i shuan?

---

1) aludim për të dalë komitë.

Më pyet a do të buzëqesh? A do të mund të buzëqesh, në gjendjen që jam, kur nuk e shquaj dot verën nga dimri! Nuk e shquaj, se zemra më është zhuritur; rroj, po nuk rroj; hedh sytë, po nuk vështroj; prek, po nuk takoj; zëri më vjen mbi veshët, po nuk dëgjoj, se jam çmësuar meqë kam ca muaj që nuk kam dëgjuar zë njeriu. Nuk e mora vesh që erdhi pranvera. Nga vuajtjet dhe mjerimet isha në gjumin e tutkunosjes. Zëri yt i ëmbël e plot kujdesje më shkundi nga gjumi, që më kishte zënë nga të mirat e miqve tanë, që po na vijnë, për tre vjet rresht. A s'më thua, mua qyqes, kërcures, murgës, more bir i dashur, a është Shqipëria? A rron shqiptari? Po trimat a janë gjallë?

— A janë gjallë, më pyet moj zonjë. A janë gjallë patriotët tanë, që na e mbajnë nderin e kombësisë e që luftuan si dragonj. Për ata që luftuan me trimëri të jash-tëzakonshme, po më pyet a janë gjallë? Gjallë janë ata, si edhe shumë të tjerë që po rriten. Kurrë nuk e shuan dot anadollaku Shqipërinë, se ka qenë e do të jetë. Po ti, moj zonjë, ku e ke shkuar këtë kohë të keqe, këtë dimër të ftotë?

— Oh, mos më pyet, mos më pyet, po përgjegjmu. A do të mundim të marrim frymë lirisht? A do të na lënë ta mësojmë lirisht këtë shkrim të shenjtëuar? — Dhe nxori prej kraharorit një abetare, të cilën filloj ta këndon-te. Nuk këndoi dot as dy radhë dhe mbi librin filluan të pikonin pika loti.

— Përse qan, moj zonjë? C't'u kujtua?

— Ç'm'u kujtua? M'u kujtua një ditë si kjo e sotmja, kur gjithë bota buzëqeshite. M'u kujtua djali nga kurbeti ku kish dhjetë vjet të plota. Ky solli ndonja dhjetë abetare, nga të cilat më mbeti kjo. E tregoi dhe e pushtoi. — Me këtë mësuam këndim gjithë të shtëpisë. Ja pse qaj, se unë, që nuk dija, mësova të këndoj... E tani këtë duan të na e ndalojnë.

Fillova ta qetësoja, mirëpo fjalën time ma preu gruaja, që më tha:

— Eja të shkojmë! Të vemi malevet; të luftojmë e të vdesim që të gjithë për të drejtat tona.

## **PER NJË TELEGRAM**

Qe ditë pranvere kur e tërë natyra buzëqesh. Qielli nuk kishte asnë re. Kur dola jashtë që të merrja ajër të pastër, u ngrit një mjergull e tillë. Vura re natyrën që kishte nisur të ngjallej. Duke shkuar, udhës, dëgjova këto fjalë: «Po të ftohet koha, gjithë bimët do të venë në djall, se do t'u ngrijinë syçkat dhe do të mos mundin të dalin vllastarët e rinj». Duke u larguar, fillova ta mejtoja dhe unë këtë gjë dhe, plotësisht, u bashkova me mejtimin e tyre. Nisa të çuditesha me natyrën, e cila vdes në dimër dhe merr jetë në pranverë.

I pushtuar nga këto mejtime arrita te miku im i zemrës, të cilin, me të hyrë, e pyeta:

— A more ndonjë gazetë nga Shqipëria? Dua ta këndoi, se interesohem dhe për çapin më të vogël, që bëhet atje.

E vura re që miku nuk ishte në të dhe, nga fytyra e tij melankolike, e kuptova që diçka do të kishte. Ju afrova, ja shtrëngova dorën dhe e pyeta:

— Kidhi, pse je i brengosur? Si vete me punën? Mos ke marrë nonjë haber të keq nga shtëpia? Apo mos je i sëmurë? — Dhe me shumë pyetje të tjera e mbulova mikun, se desha të merrja vesh q'i kishte ngjarë e të merrja pjesë në hidhërimin e tij që t'ja lehtësoja.

Kidhi nuk më foli. Pas pak, sikur atëhere më vuri re që isha në odën e tij, më tha:

— O, mirë se ardhe! Më ndje po... Që të gjitha, për sa më pyet, janë mirë dhe, asgjë prej tyre nuk do të më mundonte shpirtin kaq sa po më mundohet sot. Po, i dashur mik, me mundon një gjë e madhe, e cila këm frikë se do të na sjellë shkatërrimin.

— C' deshe të theshe me fjalën «shkatërrim», Kidhi? Thua jma më shkoqur?

— Ja se si është puna, — më tha dhe u ngrit më këmbë. U drejtua te rafti i librave e mori një paketë me gazeta. Me to në dorë m'u afrua dhe nisi t'i shihte njëren pas tjetrës. Kur i qëndruan sytë mbi një lajm, kërceu nga vendi dhe, me zë të dredhur e të turbullt, zuri të këndonte: «Gjashtëmbëdhjetë deputetë shqiptarë, në parlementin e Turqisë, biseduan mbi çështjen e shkrimit shqip dhe vendosën që shqipja të shkruhet me shkronja arabishtë. Rezolutën ja dërguan Ministrisë së Arësimit».

Unë nuk e kuptova rëndësinë e shënimit të gazetës dhe nisa ta pyesja veten: «C'do të jetë kjo?» Po pastaj m'u kujtuan fjalët e fundit: «Shqipja të shkruhet me shkronja arabishtë». E gjykova më thellë dhe e kuptova rëndësinë e lajmit. U bëra si i tërbuar. Harrova ku ndodhesha. Kur ktheva sytë nga miku, e pashtë që e kishte marrë prapë gazeten në dorë dhe se ç'po kërkonte në të. Shkoi mjafth kohë. Unë po mejtohesha pa i gjetur asnje zgjidhje çështjes.

Mijëra mejtime, të kundërtat njëra me tjetrën, rrrotulloheshin në trutë e mia. Zëri i shokut m'i largoi.

— Po ti, Adhi, ç'thua? C' duhet bërë për të mbrojtur Abecenë?

— Nuk kam haber fare nga këto gjëra se as më ndonjë histori të botës nuk e kam parë që të ndjekin shkrinin. Jo... Nuk di ç'të them — dhe heshta. Miku po mejtohej e heshtte duke më parë në sy. I pari, unë i pari i dhashë fund heshtjes:

— Po me ne, more, të sillen kështu? Me ne që u sollillëm lirinë? Që u shpëtuam Stambollin? E sot duan të na burgosin mejtimin? Jo, kjo nuk do të ngjasë kurrë, se mejtimi, kur ndalohet, egrerohet, përhapet më shumë dhe

kap më shumë mendje... Mos u dëshpëro, se fitimi është nga ana jonë. «Do të bjerë shi dhe në arat tonë», thotë fjala e pleqvet. U gëzova nga fjala e mikut dhe mora shpresë të reja nga fjala e urtë.

— Po, sido që të jetë, duke ndenjur me duar në gjë, nuk do të mundim të bëjmë gjë. «Po të mos qajë foshnja, nuk i jepin sisë», thotë një fjalë tjetër e pleqvet.

— Epo, si i bëhet halli?

— Ja se si: sado që jemi të pakët këtu dhe nuk do të mundim të sjellim ndonjë fitim të madh, duhet të bashkohemi, se bashkimi bën fuqinë dhe t'i dërgojmë Ministritë së mësimit një telegram proteste kundër shkrönave arabe. Edhe guri më i vogël e ka vendin e ti i në ndërte-sën e madhe.

— Mejtimi është i pëlqyer dhe shumë i mirë. Duhet ta mbarojmë menjëherë. Me vrap... yrysh... — U veshëm dhe dolëm pasi bëmë një listë për të mbledhur të holla për shpenzimet e telegramit.

Mejtimi u pëlqye prej të gjithëve dhe telegrami u bë. Gazetat e vendit, që kishin filluar të interesoheshin për çështjen tonë, e morën lajmin dhe e kishin radhitur tekstin e telegramit me shkronja të mëdha në faqen e parë.

\* \* \*

Agimi edhe nuk kishte çelur kur e kisha lënë shtratin. U mora pas pune. Po ç'punë, kur në trutë e mia rrulloheshin pikurat e Atdheut. Më dukej sikur i shihja ndjekësit e shkrimit latin, që ndiqnin librat. I shihja rrëxhallarët me çallmat e mëdha si i shikonin me urrejtje ata djem, që shkruanin ndonjë shenjë të alfabetetit latin mbi dhogën e zezë dhe si ua bënин duart pleh. Rashë në mejtime. Më përmendi gazetashitësi, që më solli gazetën ku ishte shtypur telegrami.

## PASHKA NË SHQIPERI

Kumbimi i kambanave më zgjoi nga gjumi. Të ngrihesha, përtonja se gjumi i mëngjezit ish aq i ëmbël sa më kish lidhur për shtrati. U zgjata dy-tri herë, hapa gojën dhe më zuri gjumi përsëri.

Në këtë hop erdhi im më dhe më spërkat me ujë. U trempshë dhe u ngritshë. Përnjëherej m'u kuit<sup>1</sup> që ish dita e pashkës dhe adeti i të squarit me të spërkat. U ndërruash me shpejtëm, vesha robat e reja, që m'i kish sjellë pranë im më, dhe kështu i zbukuruar mora udhën për në kishë. Qielli qe i mbushur me re. Frynte një erë e hollë dhe vise-vise cërkonte 1) U kujtuash që duhej marrë umbrella se, po të më zinte shiu, do të më bënte si ndonjë mace të lagur.

Kisha ish mjaft larg dhe pas ca minutave arrita. Kishin ardhur njerëz plot, po edhe nuk ish kënduar «Krishti u ngjall».

Prifti, i cili ish i thinjur dhe plot me rrudha, me një zë të ngjirur po këndonte lutjet, të cilat gjindja i dëgjonte me një evllavi 2) të madhe. Sa më shumë afrohej koha që do të thuhej «Krishti u ngjall», aqë më shumë më pikëlløhej zemra se, 35 vjeç njeri u bëshë gjer më sot, nuk e kam dëgjuar nonjë mot shqip. Koha erdhi

---

1) cërkonte — pikonte.

2) evllavi — nderim i veçantë, venerim.

dhe prifti e këndoi gërqisht. «Krishti u ngjall». Unë, në vënd që ta drejtonja vërejtjen time mi këndimin e priftit, u pushtuash nga mejtimet se m'u kujtua e ngrata Shqipëri dhe thashë: Ja, shkoi dhe një mot si të parët! Sa ligsht, t'i dëgjosh lutjet e zotit në gjuhë që nuk e kpton! Sa ligsht që nuk kanë arrirë ta kuptojnë që të gjithë dhe t'i jasin shkelmin qarkut të errësirës që i rrëthon!

U bëshë si i marrë, pa ditur ku gjëndem dhe ç'bëj, ju afëruash priftit dhe i thashë: «Uratë, këndojeni dhe një herë shqip!»

Urata u zemërua, u vrejt në fytyrë dhe më pa me sy të lik. Nga që ndodhej në shërbim e sipër, nuk m'u përgjegj; e kuptova që e malcova<sup>1)</sup> shumë me fjalët e mia dhe që ish gati të më çgjakësonte në rastin e parë.

Mesha mbaroi. Njerëzit u çdukën, pasi u çokiten vëzët, gjithkush mori udhën e tij. E unë si ndonjë i lënë, automatikisht hyra në shtëpi, u drejtuash në dhomën dhe rashë mi shtratin si i vrarë.

## II

Retë, që ishin të dëndura, u përhapën dhe rrrezet e diellit u futën në dhomën time. Im më kish ardhur ndonja pesë herë të më sqonte, mirépo unë isha si i lënë dhe s'mundnja t'i mblithnja mëndtë në kokë. E kisha humbur aqë shumë, sa s'mbanja mënd ç'kish ngjarë. Nisa t'i kujtonja, po s'munda, se mejtimet më ngatërrroheshin aqë shumë, sa ma errësonin të vërtetën. I pushtuar nga mendimet, më zuri gjumi dhe pashë ëndërr sikur ish pashkë dhe unë shkonja më një udhë të gjérë, që ish e zbukuruar më të dy anët me drurë. Automatikisht u futshë me një sallë, ku pashë që hynin gjithë djem të rinj. Vura veshin të dëgjoj më ç'gjuhë flasën. Përmi veshin tim qëndruan

---

1) e malcova — e preka, e lëndova.

ca fjalë të mbytura, nga të cilat s'munda të kupëtoj dot asgjë. Po, na erdhi një njeri dhe që të gjithë u ngritën më këmbë. Njeriu që erdhi ish i veshur me rroba të zeza, kish mjekrën dhe mustaqet të zeza sterri; s'ish aq i bukur në fytyrë dhe nga boja ish mesatar. M'u duk sikur vuri gishtin për të bekuar, u drejtua të katedra, hodhi ca vështrimi rrerherrotull, dhe tha: «Paqje ndër ju», heshti. I ngriti sytë përpjete dhe me të pëshpëritur, si më dukej, po këndonte lutjet e zotit.

Një fjalim i dy zotërinjve, që ishin pranë meje, qëndroi mbi veshin tim: «Ky është prifti i parë i shqiptarëve», dhe u dëgjua zëri i priftit, që m'i shurdhoi fjalët e zotërinjve. Kur ktheva sytë e pashë uratën më këmbë dhe, me zë të fortë dhe melodik, tha:

— Të uruar e të bekuar! Sot po lusëm pashkën. Është e kremte për të krishterët. Po për ne shqiptarët nuk është e madhe, ngaqë nuk kemi fatin ta ndëgjojmë më gjuhën tënë. Se jadhe na dëfteu neve — vetëm kjo pakicë ka fatin ta ndëgjojë shërbimin e shenjtë më gjuhën e vet, kur qindra mijë nga vëllezërit tanë nuk e kanë këtë fatbardhësi!

Vëllezër të dashur! Mejtimi del nga një njeri, po, kur është i drejtë, i pushton mëndjet e të gjithëve dhe përhapet. Kështu do të përhapet dhe mejtimi pér shërbimin e lirë me gjuhën e vët në kishë. Dhe, në mos shpejt, vonë, do t'i pushtojë që të gjithë ndenjësit 1) e Shqipërisë.

Vjet, nuk e kish fatin as nonjë shqiptar, ta ndëgjonte «Krishti u ngjall» me gjuhën e vet, kurse sivjet janë përmi 500 që e dëgjuan. Po mot? Mot kam shpresë se cilido nga ju do të bëhet një apostull që ta ungjillëzonjë 2) gjuhën tonë në Shqipëri...

Një trokitje e tërbuar më sqoi dhe ma humbi ëmbëlsirën dhe sërën e ëndrrës. Mallëkova të gjallë e të

---

1) ndenjësit — banorët.

2) t'ungjillëzonjë gjuhën — predikoj pér gjuhën.

vdekur, se aq shumë u dhashë pas saj, sa desha të ish e pasosur.

Kur hapa sytë, ç'të shoh? Përpara meje qëndronte një xhandar, që më tha se më duan në polici.

U vesha dhe, bashkë me xhandarin, që e kish sfyn-gjinë 1) nxjerrë, u drejtuash në polici. Nuk e dinja për-se më suallë, po, duke parë ca njerëz të njojur dhe priftin në mes të tyre, e kuptova që nuk më deshën për sytë e zes.

Në këtë kohë nuk kujtonja asgjë tjetër, por vetëm atë pakicën që patën fatin ta dëgjonin «Krishti u ngjall» më gjuhën shqipe.

### III

Kështu ndenja shumë kohë. Sa që ishin në dhomë u futën në këshillët dhe më lanë vetëm me xhandarin, i cili në pyetjen që i bëja «përse më suallë këtu», nuk më përgjigjeshe, po heshtte si peshku.

Nuk dinja ç'të mejtonja. E shihnjë lirinë time të humbur, se e shihnjë sa rëndë i gjykonin të dyshimtët për çështjen shqipe.

Shkoi më shumë se gjysmë orë që po këshilloheshin, gjer kur dolli një njeri i veshur me shallvare të gjëra, me festë të zgjyrosur dhe i tha xhandarit të më shpinte brenda.

Zëri i egër i xhandarit më luajti nga vëndi dhe u drejtuash në këshillë...

Kadiu po rrinte mi katedrën. Ky qe një njeri tepër i shëmtuar, me mjekër të verdhë, me sy të shtrembër, me hundë si qip 2) prej shqiponje, me gojën pa masë të madhe dhe fytyrën ja kishin mbuluar krundet. Ish i veshur, pas sistemit anadollak me një palë pantallona të gjëra dhe të shkurtëra sa i dukeshin gjelmitrit 3) e çorapeve të bar-

1) sfyngjia — bajoneta.

2) qip — sqep.

3) gjelmitri — gjalma.

dha. Këpucët i kish fino anadollake, jelekun, që e kish të murmët, si dhe xhaketën i kish të qepura pa mjeshtëri. Mesin ja shtrëngonte një brez tetëmbëdhjetë kut i gjatë, si dhe festen ja shtrëngonte një sérëk 1), që nga qelli gjer mbërdhe i gjatë. Ja, gjithë këto ishin stolitë e gjykatësit otoman.

Kur hyra, ai mori vrejtësinë që ja lypte ofiqi dhe, me anën e terxhumanit, më pyeti.

— As më thuaj në ç'kombësi nëmërohesh?

Heshta pak. E dinja që i ndjekin shqiptarët po, nga-që e dinja se është turp ta mshehësh kombësinë, pa frikë ju përgjejshë:

— Jam shqiptar!

— C'fe ke?

— Orthodhoks!

— Mos je dhe ti nga ata që duan të shkruhet gjuha shqip?

— Nuk ju kuptoj, zoti kadi?

— Si nuk më kuptoni?

— Po, nuk ju kuptoj, se më flisni për të këtilla gjëra. Po, meqenëse jam shqiptar, që të gjitha ato që i sjellin të ligë, i lëftoj.

— A-ha... ahorej nuk na duhen shahitër, se ti vëtë e dëshmove këtë gjë, për të cilën të kanë paditur.

— Po si të mos them se jam shqiptar, kur nuk di tjetër gjuhë? Ahorej pas mëndjes suaj ç'të jem?

— Meqenëse je i krishterë, duhet të quhesh rum 2). Po ti, siç e dëshmove më sipër, je nga ata që duan të lë-rohet gjuha, të hapen shkolla, të mësohet kjo gjuhë... ~~Kë~~ to i kuptojmë siç e kuptojmë që nesër, pasnesër, do të doni të bëni dhe mbretëri më vete.

U zemëruash pa masë kundër gjykimit të kadiut, që drejtoheshe mi mua, po ca më shumë, se zuri të m'i loste ato tela të zëmrës, që më sillnin më të mëdhatë dhembje. Tërë këtë kohë po e dëgjonja kadinë me kokë unjur. E

---

1) Sérëk — çallma.

2) Rum — quheshin të krishterët në kohën e Turqisë.

kuptova që gjyqi do të më bëheshe shumë i rëndë, u mbajta, desha t'i derdhnjë që të gjitha ato hidhërimë që ma mundonin zemrën. E ngrita kokën përpjetë, ja ngjita sytë kadiut dhe, me zë të fortë, që lëshonte oshëtimë dhe tingëllinte posa kumbim i kambarës. i thashë:

— Zoti kadi! Zotëria juaj jeni mësuar të gjykonit dhe, në kohën e gjatë që jeni përmisë këtë katedër, keni gjykuar shumë njerëz: ca i keni dënuar dhe ca i keni nxjerrë të pafajshëm. Me të këtilla ndodhira është mbushur libri i jetës suaj. Sot mi froni e fajtorit më kanë vënë mua, se jam i paditur nga një prift. Ju po më gjykonit dhe po rëmoni nyjet e kodit 1) gjyqësor që të më dënoni pas ligjit. Faji im është se dua që gjuha ime të shkruhet dhe të mësohet.

«A më dëgjuat, o njerëz, përse më gjykojnë?» — Këto ua thashë dëgjonjësve. Heshta pak minuta. Fshiva sytë se, nga zemërimi i madh që më kish pushtuar, nisën të më pikonin lotët. Pastaj u kthyesh nga kadiu dhe i thashë:

— Zoti kadi! Unë e di fort mirë që ju keni bërë be, përpara kurabit, të mos dënoni njeri të pafajshëm. Po mua, përse më suallët këtu dhe më sheshuat 2) mbi froni e fajtorit?.. Vallë, pas nomit, ç'faj kam bërë? Cilën nyjë kam shkelur? Ju lutem kërkojeni, rëmoni në kodin; po të këtillë nyjë nuk ka. Jo, të këtillë nyjë nuk ka dhe, siç keni dënuar shumë të pafajshëm, ashtu do të më dënoni dhe mua. Jam gati t'i duroj të gjitha: si gjyqin tuaj të shtrembër, si kallzimin e njerëzve të perëndisë, që veprojnë kundër porosive të tij. Ju gjykonit shumë ligjsh! Po, mos pandehni se, me të dënuar mua, vëllanë, kushërinë, do ta humbisni mejtimin e drejtë që u mbuall nga themelonjësit e shqiptarisë? Krahërorë, që i presën me gaz plumbat e armiqve për trashëgiminë ndjenjës së shenjtë, ka shumë, aqë shumë se as që e pandehni.

Kadiu po kthente fletët dhe po dëgjonte terxhumam-

---

1) nyjet e Kodit — nenet e Kodit.

2) më sheshuat — më vutë, më vendosët.

nin, i cili ja kthente turqisht. Unë isha si i tërbuar, se vështrimi i tallshëm dhe ironik i priftit më xhindosi fare dhe i thashë kadiut:

— Vallë ç'rémoni? Flisni, jepmëni dënimin! Shtoni dhe një nyjë mi të cilën do të mundni të keni mbësh-tetje që të më dënoni.

Kadiu u ngrit më këmbë dhe këndoi dënimin:

— Me urdhërin e N.M. së tij Sultan Abdull Hamidit, Qirjakoja dënohet me dhjetë vjet burg për ndryshimin që kërkon të sjellë në mbretëri.

Isha si në gjumë kur e dëgjova dënimin. U ngritshë më këmbë dhe me grobësi<sup>1)</sup> i thashë kadiut:

— Të gjithë e vulostë?

— Po, u vulos nga të gjithë — m'u dëgjua një zë.

— Jo, nuk e kanë vulosur të gjithë — u thashë me tërbim.

— Mjaft lehe — m'u dëgjua një zë, i cili ish i xhan-darit dhe dora e tij e fortë më zuri për krahu dhe më drejtoi në burg, ku duhej të rrinja dhjetë vjet.

«Dhjetë vjet — thashë me vete — do të mos mund t'i shërbej shqiptarisë» dhe nga sytë më pikuan lot që ishin të rëndë dhe të shpeshtë.

#### IV

U përhap revolta e xhonturqve.<sup>2)</sup> Ushtritë e sull-tanit u thyen. Mbretëria otomane mori koshtutën<sup>3)</sup>. Burgjet u hapën dhe unë u liruash bashkë me gjuhën shqip, pa mbushur as tre muaj.

*Odesë, 1912*

---

1) me grobësi — me arrogancë.

2) Është fjala për lëvizjen e turqve të rinj të vitit 1908.

3) koshtuta — kushtetuta.

## USTAI DHE ÇIRAKU

Kur dolla nga shtëpia, ora ish dhjetë; dolla që të mblidhnja ca ndihma për gazetat. Shtytjen, për këtë gjë, ma dhanë të qarat e gazetarëve.

Planin e kisha vendosur që mbrëmave po, duke parë kohën e ligë,— binte dëborë dhe ish shumë ftohtë,— desha ta linja për një ditë tjetër. Ngaqë s'kisha ç'të bënja, mora librin e Tolstoit «Qarku i këndimit» dhe këndova këto në faqen që m'u hap. «Njeriut që të kërkon ndihmë, dhe që e kuption se ka nevojë, mos ja shty për nesër cse për pasnesër se, po të vdesë, mëkatit të bie ty». U drodha nga kjo frazë. Pernjëherej u vesha me pallton dhe kapellën e beharit dhe, pa vënë re as erën, as furtunën dhe as cikmën, dolla nga shtëpia. Udha ish e largme po, duke ditur «përse vete», këmbët s'më ndjenin të lodhur.

Kur arrita te shqiptari i parë isha mbuluar më dëborë. I njohuri im kish ndënjur mi një fron dhe po këndonte gazetën e vëndit. Pasi nxora galloshet, që i kisha të grisura. i zgjata dorën dhe i thashë:

— Mirëmëngjez, zoti Thanas!

Zoti Thanas ma zgjati dorën me të ftohtë dhe më tha:

— Mirë se ardhe... po pse qenke lodhur?

E pashë që ju këmbye ftyra dhe s'desh të më fliste. E unë i thashë:

— Zoti Thanas, jam munduar gje, këtu që t'ju kër-

koj ndonjë ndihmë pér gazetat. Kanë nevojë të madne.  
Z. Thanas më shihte sikur desh të më hante.

E unë vazhdova:

— Ja, kombet e tjera po pérparojnë se nuk kursejnë asgjë. Kështu duhet të bëjmë dhe ne që të pérparojmë.

— Po, po, ashtu është, ke të drejtë, — më tha z. Thanas — po ne nuk kemi njerëz.

— Si nuk kemi njerëz?! — ja rrëmbeva fialën. — Njerëz kemi, po duhet t'i ndihmojmë që të mundin të punojnë.

Z. Thanas u zëmërua, u skuq. luajti nga vendi dhe më tha:

— Gazeta, gazeta, gazeta; ndihma, ndihma, gjithë pér të tilla na vini! U lodhmë de së dhëni! Ja, nuk ka as tre muaj që mblohdhmë pér atë gazetën që nuk vien. Dhe më pa drejt në sy.

E unë, duke dashur ta qetoja, i thashë:

— Zoti Thanas, ju lutem, mos u zemëroni se nuk keni të drejtë. Gazetari i varfër përpinqet gjer në fund, duke harxhuar ç'ka, pér ta parë të lirë e të pérparuar kombin shqiptar. Ne i ndihim vetëm me ca para, kurse ay bën kurban tërë jetën.

Zoti Thanas as që më dëgjoi; e unë i thashë:

— A do të më ipni gjë?

— Jo, unë s'jap dot asgjë, se dhe kështu u batërdisa me këtë shqipen.

— Detyra jonë është t'u ndihim, pa ju bëni si t'ju pëlqejë. — Dhe, si u vesha, duke shkuar, i thashë: — Rrini me shëndet.

— Ecë me shëndet, po kështu nuk kemi njerëz **ne**, jo. — Po me mendje thesh: «Ku e solle kokën, mos vafsh shëndoshë»!

Më pushtonin mendime të ndryshme kur barisnja rrugët e mbushura me dëborë. Vajta te tjatri, te tjatri, gjithsecili kish psikologjinë e tij, gjithsecili përdorte arësyet e tij dhe gjithsecilit duhej t'i flisnje dhe ta dëgjoje. Kur u kthyesh në shtëpi, ora kish vajtur dy e natës. Urija

tit Thanas. Ai, kur e mori në dorë, qeshi, e grisi kartën që ish shkruar adresa dhe tha:

— Dhjetë franga në mot, një gazetë në javë, bie 20 qindarë ar copa, shumë shtrenjtë.

Raqi s'ë mbajti dot të qeshurën, u fut në dhomën tjetër dhe u mejtua: «Po të kishin ardhur gazetat e mia në dyqan, im zot as sot, as mot, do të mos ish pajtuar. Kështu u bë pak shqiptar, se i ndihu shtypit me dhjetë franga.»

## NJË FAQE NGA JETA

«Njeriun e zbukurojnë virtutet e larta kur di të mba-jë idealet», thoshte një plak. Sot do t'ju tregoj një faqe ngajeta. Dëgjoni:

— Stefani na kishte pranuar idetë e atyre, që kishin themeluar patriotizmin shqiptar. Në kohërat e para ai merrëj me tregëti; nuk kishte shumë pasuri, po kishte karakter. Kishte mik Riston, me të cilin takohej shumë shpesh. Nuk kishin ideale të njëjtë dhe ngaherë ndaheshin në bisidimet. E një ditë, si kishin biseduar gjérë e gjatë mbi patriotizmin, Ristua i tha:

— Që të gjitha këto janë propagandë e Austrisë; kombësi shqiptare as ka patur e as do të ketë... ne jemi grekë e turq e asgjë tjetër.

Që nga kjo ditë u zvordhën në mes tyre dhe nuk takoheshin më.

\* \* \*

Stefani, për disa çështje familjare qe kthyer në atdhe. Në këto kohë kishte plasur lufta dhe udhët ishin mbyllur. Vendin e zuri ushtria greke dhe Stefani rrinte fshehur, se që të gjithë sa kishin ndjenja shqiptare i fut-

nin brenda. Në qytetin e tij erdhi një trup vetëdashës. Në krye të këtyre ishte Ristua. Stefani, pasi u mejtua pak, i shkoi në zyrë dhe ju drejtua me këto fjalë:

Nuk të kam ardhur këtu as që të bindem, as të të falem e as të bëj be që hoqa dorë nga idealet e mia, se kjo është vetëm mënyra e të poshtërve; erdha vetëm të ië lutem, në emrin e miqësisë së vjetër që kemi pasur, të më ndihmosh të dal jashtë kufirit, se nuk e duroj dot këtë flamur, që po na shtyp

Mirëpo Ristoja nuk dëgjonte nga këto, dha urdhër dhe e futën Stefanin në burg, ku ndenji gjersa u hoqën ushtritë greke dhe erdhën ushtritë kombëtare.

\* \* \*

Ngjanë shumë çudira. Shqipëria u shpall e pavarur. Idealistët shqiptarë u mblodhën dhe në bisedimin e parë vendosën: «T'i duam e t'i falim vëllezërit».

Stefani na kishte një vend me rëndësi. Një ditë përpara tij sollën një burrë, që e akuzonin për tradhëti. Ky na ishte Ristua. Stefani i foli me zë të ëmbël dhe, pasi i dha froni që të rrinte, i tha:

..Njeriu nuk heq dorë lehtë nga shenjtërirat e nga idealet, që ka pasur.

Po sa u çudit kur Ristua u ngrit më këmbë dhe i tha:

— Hoqa dorë nga marrëzitë, se kam shumë kohë që më kanë hyrë ndjenjat shqiptare. Gjer më sot jam përpjekur shumë për Shqipërinë: ky është vendi im; kjo është gjuha ime dhe ky që valon sot është flamuri im.

Stefani nuk i foli, po vetëm solli ndër mend atë tablonë kur ai e qërtonte për patriotizmin shqiptar, duke e quajtur propagandë të Austrisë. Dhe në trutë e tij zunë të lëvronin dy ndjenja: ndjenja për të falur dhe ndjenja për të dërmuar njerëzit e poshtër. Një zë i thosh: «Poshtërsinë duhet ta shuash që në rrënje, se, po s'e shoj-

te, do tē tē shuajë ty ajo». I jepte tē drejtë këtij zëri, po dëgjonte dhe një zë tjetër, që i thosh: «Shpejt a vonë do tē pendohen e do tē bëhen tē dobishëm për Atdhe». I tërhequr prej zërit tē dytë ja nxori Ristos vulën e cnderimit dhe e la tē lirë.

\* \* \*

Kishin shkuar edhe disa vjet. Në kohën e luftës Ristua i kishte mbërthyer ndjenjat si gratë çorapet dhe më në fund pranoi ndjenjën, që triumfoi. Me mendjen e tij gjithnjë thosh: «Njeriu nuk duhet tē shkojë kundër valës, se kjo është marrëzia e idealizmit». Dhe kështu, me anën e djallëzive të tij mundi tē zinte vise tē larë ta se e bëri botën ta besonte që ishte patriot i flaktë. Me gjithë këto nuk e duronte dot Stefanin, se ai ja dinte që tē gjitha. Një ditë përfitoi prej zbulimit tē një komploti dhe me dinakérinë e tij e solli punën në një mënyrë që t'i futte dyshime prokurorisë; kështu Stefanin e burgosën. Ristua fërkonte duart dhe thosh: «Po më buzë-qesh fati. Vala e jetës po më shpie atje ku dëshiroj, po nuk më lënë këta si Stefan. Me t'i parë këta, më kujtohet tërë jeta ime, se në sytë e tyre këndoja biografinë time. Ah, sikur tē mundja t'i zhduknja që tē gjithë, ahere do tē isha i qetë e i lumtur».

## **LETRAT E VETËDASHËSIT<sup>1)</sup> SHQIPTAR**

### **Letra e parë**

Të dashur prindër,

Më ndjeni që nuk ju thashë kur ika, po, ngaqë e dija që do të më linit dhe, ngaqë kisha frikë se mos lotët tuaj ma pakësonin zjarrin, që kisha në zemër, ika pa lejën dhe pa uratën tuaj. Prapë ju kërkoi ndjesë për hidhërimin, që ju solla, po, unë, nuk do të mund të rrija i qetë kur të dëgjoja që vëllezërit e mi luftonin dhe derdhnin gjakun për të drejtat e Shqipërisë. Do të mos quhesha më atdhetar, po të mbetesha pranë jush se, sado që një njeri është një fuqi e vogël, në luftë domethënë shumë.

Si djali juaj që jam, po e bëj detyrën dhe po ju shkruaj letër duke ju kërkuar ndjesën dhe uratën se unë, shkova për të luftuar, ngaqë më tërhoqi zëri i detyrës, i cili nuk më linte të qetë, po, kurdoherë më mundonte pa mëshirë. Këtë letër po jua dërgoj që udhës dhe, pas disa ditësh, kam shpresë të piqem me kryengritësit, të cilët do të më japin armët. Bashkë me ta, do të ngjitem në malet e atdheut tonë, që ëshë i skuqur me gjakun e vëllezërvet të mi si edhe me gjak pleqsh, plakash, fëmijësh po ca më shumë halldupësh.

Të dashur prindër

---

1) Vullnetarit.

Dëftehuni trima, bëjeni zemrën gur dhe mos lëshoni lot pikëllimi, po gëzohuni dhe mburruni që djali juaj mund të mbarojë jo vetëm detyrën e tij, po edhe tuajën; se, po të që që të kishit filluar ju, ne tashti do të lumtëronim kombëtarisht. Prandaj nuk duhet të pikëlloheni, asfare, dhe të mos lëshoni lot po të jetë se vritem në fu-shën e detyrës, po të gëzoheni dhe, kur të merrni mandatën, në vend që të qani me vaj, t'ja thoni marshit të kryengritjes.

Tashti që po i afrohem malësisë, nuk mejtoj asgjë tjetër përveç pushkës dhe fishekëvet, me të cilët dua t'i shuaj gjithë armiqtë e Shqipërisë, që na kanë sjellë gjithë këto fatkeqësira.

Me sa padurim dua t'i afrohem atdheut të lirë, malësisë, të dëgjoj të zbruzurat e pushkëve dhe të marrerën e barutit! Me sa padurim dua të gjendem në majërat e maleve e të bashkohem dhe unë lepuri me ata vëllezër luanë! Mos thoni, të dashur prindër, që nuk ju dua, nuk keni të drejtë të mendoni kështu. Ju dua shumë, më shumë se çdo tjetër mbi këtë dhe përveç Shqipërisë, që e dua më shumë edhe nga ju.

*Pres uratat tuaja dhe mbetem me dashuri.*

*Djali juaj A. Tanushi.*

15/VI/1911

### **Letra e dytë**

Të dashur prindër,

Arrita shëndoshë e mirë dhe i pashë trimat luftëtarë të Shqipërisë, me të cilët u putha me mall. U kërkova armë dhe, pasi bëra be «për kujtimin e Skënderbeut», m'i dhanë. Këtë bë, të dashur prindër, e bëra që të mos i i jap armët, po, do të bie i vdekur bashkë me to. Sikur të kisha fituar gjithësinë, do të mos gëzohesha kaq shumë, sa u gëzova kur ngjesha fishekët, mora koburen dhe hodha pushkën krahëvet. Këtë minutë, të dashur prindër, nuk mendoja asgjë tjetër, po vetëm kohën e shkuar të

Skënderbeut, kur ai luftonte me turqit e kur Shqipëria ishte e lirë dhe e lumtur.

Të dashur prindër,

Në fushën e luftës u njoha me shumë shokë, me të cilët, fjalosemi vetëm për luftën dhe për Shqipërinë. Sa dhe ju, të dashur prindër, tri ditë ju harrova fare. Sot më dërguan në treg për ca plaçka, këtu u kujtova dhe po ju shkruaj letrën e dytë. Më ndjeni që ju harrova, po do të ishte faji më i madh, po të kisha harruar Shqipërinë.

Sot, të dashur prindër, këtu në fushën e luftës e quajmë veten shumë të lumtur. Po, do ta quajmë edhe ca më të lumtur, kur do të përpinqemi me armiqtë, prej të cilëve dua të vras shumë, ngaqë ata janë shkaku që kemi mbetur kaq prapa dhe të paqytetëruar. Letrën do ta hedh në kutinë e postës pa pullë; paratë na duhen; ju kërkoj ndjesë që do ta paguani aty dyfish. Vetëm letra më mban këtu në treg, se gjithë plaçkat i kam blerë.

Të dashur prindër, më ngjan se nesër do të përpinqemi me armiqtë, me mizorët tanë. Këtë e kuptoj se po bëjmë goditje për dy javë dhe kryetari na tha se do të shtyhem më thellë në male. Sa jam i lumtur që po arrin ajo ditë, që pres me padurim! Po mos pandehni se vetëm unë pres kështu. Jo, që të gjithë sa janë këtu e presin ditën e goditjes sikur presin ditën e dasmës. E ju, pa dyshim, do të çuditeni kur të këndoni gjer këtu. Kurrë nuk e prisnit që të shkoja vetëdashës dhe unë, që më quanit frikash. Mos u çuditni! Dashuria për atdhe të dhënsa shumë fuqi dhe të bëka të pafrikshëm. Ajo të bën të fortë porsi luani dhe të shtyn në luftë pa qëndrim, se nuk është luftë për të rrëmbyer, po për t'u mbrojtur e për të fituar lirinë, të drejtat e shenjta. Asnjë nga shokët e mi nuk e di se ç'është frika e që të gjithë, me këngë trimërie ndizen dhe me padurim presin ta dëgjojnë zërin e trumbetës, që do të kasnecojë kushtimin, pas të cilit do të fillojë lufta.

Në mbetsha i gjallë, pas goditjes, së nesërme, do t'ju shkruaj, po në u vrafsha, mbetshi me shëndet dhe mos

qani. po këndoni dhe mburruni, që biri juaj e mbaroi de-tyrën e tij plotësisht.

*Djali i Shqipërisë, pastaj juaji*

*A. Tanushi.*

29/VI/1911

### **Letra e tretë**

Të dashur prindër,

Këtu e katër ditë dëgjuam zërin e trumpetës, u përpinqëm me armikun. Edhe unë vrava. Sa gjëzim i madh që është kur e sheh plumbin, që godet armikun! Pa sa është pikëllimi i patreguar kur plumbat të venë kot! Vërtet pikëllohesh dhe helmohesh pa masë, se e di shumë mi-ri që plumbat, në malet e Shqipërisë, kushtojnë shumë shtrenjtë. Mua, të dashur prindër, nga të pesëdhjetë plumbat, që zbraza, më vajtën mjaft kot se ende nuk jam i stërvitur mirë. Në këtë goditje kishim komandant trimin me fletë Kurbon, të cilit, para se të niste lufta, i putha dorën dhe, në vendin tuaj, i kërkova uratën. E ai, me fytyrë gazmore, më fliste me zërin e tij ëngjëllor fjalë burrë-rore, të cilat na bënë luanë. Ai na puthi në ballë dhe na uroi të dilnim faqe bardhë. Edhe sot e ndjej të puthurën e tij. Në këtë goditje kryetari u dëftyte strateg i mbaruar. Kur turqit deshën të na rrethonin, na ndau në shumë vi-se dhe na urdhëroi t'u binim vetëm nga pritat. Dhe kësh-tu, sado që armiku ishte si mizëria, e mundëm dhe vramë shumë syresh. Sa e bukur që ishte tabloja kur u shpër-ndanë armiqjtë dhe morën arratinë! Qielli ishte i kthjellët dhe në të disa hostena nga perëndimi, ishte hëna si dra-për dhe yjet me milionë si ushtarë të çakërdisur! Qetësinë

e natës asgjë nuk e prishte përveç të zbrazurit e pushkë-vet. Drurë nuk kishte, malet ishin të zhveshura, plot më gurë, që na i copëtuan opingat. Në trutë e mia më mbeti kjo natë, sepse qe e para përpjekje dhe ktheheshim me fitore. Kur u kthyem në qendrat tonë, e pamë se prej tanëvet qenë vrarë dhjetë shpirt. I mbuluam me nderime të mëdha. Dhe, kur ishim të mbledhur të gjithë vetëdashësit, komandanti ynë hipi mbi një gur dhe na tha: «Vëllezër trima! Dita e sotme shkoi e lumtur! Me këtë ditë i zbukuruam Shqipërisë dhe një faqe në historinë e saj të rilindjes. Ju, djemtë e mi, u dëftyet trima dhe ua shpërbleftë fati dhe unë e Shqipëria do t'ju mbajmë mend për jetë».

Ngaqë lufta, të dashur prindër, mbajti 18 orë dhe ngaqë në zgjatjen e kësaj kohe nuk hengrem asgjë përveç se nga dy galeta, që kishim me vete, kur mbaroi fjalën komandanti, urdhëroi dhe na dhanë bukë e dja! Kjo drekë m'u duk më e shijshme se ajo e milionerëvet.

Këtu ora shkon pa e kuptuar; janë mbledhur nga të gjitha pikat e Shqipërisë pa dallim feje. Po do të dëshiroja që të ngrihenë në të gjitha pikat e Shqipërisë që ta mbaronim punën më lehtë, ta çlironim Shqipërinë dhe të valonte kudo flamuri i bukur kuq e zi me shgabën dykrenare. Unë e di që ju nuk jeni në një mendje me mua, po unë ngaherë do t'ju shkruaj për ato që më sjellin dhembje në zemër e që i quaj të shenjta. Vërtet shqiptarë ka kudo në viset e huaja si dhe në Shqipëri. Po t'i pyesësh ç'janë, të thonë «shqiptarë» dhe, po t'u kundështosh, të vrasin. Po sot pse nuk ngrihen e t'i vrasin ata që u kundërshtojnë? Po, sot po na kundërshtojnë shumë dhe sot vendosetjeta apo vdekja e Shqipërisë!

Të dashur prindër, e di mirë që, kur ta këndoni këtë letër, do të helmoheni pa masë, se ju doni t'ju shkruaj për gjëra të tjera e doni që ta lë pushkën e fu-shën e nderit dhe të vij pranë jush, të më përkëdhelni dhe t'ju gëzoj në ditët e pleqërisë. Po, dijeni, përparrë detyrës së shenjtë nuk i bindem detyrës së dytë. Jua thashë: ju dua, ju dua shumë, po jo sa Shqipërinë.

Prandaj mos kini shpresë që të kthehem pa e çliruar plotësisht Shqipërinë. Dhe, nëështë se vijnë shokët e mij e pyesin se ku ndodhem dhe a ju kam dërguar ndonjë letër, thua juni që i thérres këtu, në malet e Shqipërisë, që të luftojmë së bashku dhe t'i fitojmë të drejtat, që na i kanë shkelur. Në mos daçin, këndojuani letrat e mia e, në mos u bindshin dhe kështu, jepuni mallëkimin e Shqipërisë, se të atillë djem nuk i duhen.

Dëftojuni dhe ju, o të dashur prindër, që jeni stërnipërit e Skënderbeut dhe të shqiptarëvet të vjetër, të cilët, kur e dërgonin djalin në luftë, pasi e puthnin, e porositnin: «Shko në luftë dhe ktheu fitimtar, përndryshe mos u kthe i gjallë».

Kështu dua të më porositni dhe ju, se vetëm atëherë re do të mund të mburrem duke thënë që kam prindër të vërtetë, siç duhet.

Në mos u vrafsha, do t'ju shkruaj prapë.

*Djali i Shqipërisë, pastaj juaji*

*A. Tanushi.*

5/VII/1911

## **DY MEJTIMET**

Dyqanet po mbylleshin. Njerëzia me trajstat plot me gjëra për në shtëpi, po ngjiteshin që nga pazari. Kafet ishin të hapura, plot me njerëz. Nga to dilte një shuzhimë e fortë.

Qielli ishte mbushur me re. Shkrepëtima, pas së cilës ndëgjohej gjëmimi, ipte të kupëtonim që do të binte shi.

Ora e tregut trëngëlliti një allaturka.

Në këtë kohë Taqoja, Piloja, Hyseni dhe Jakupi po lozni dabdanecin. Më tutje, ca të tjerë, lozni skambillë; ca të tjerë trambën. E në anën e djathtë, nga ana e derës, po lozni, Isufi me Raqin, tavllën.

«Has, fand dhjeta e mirë... bëjmë një... e poqa... cilë kemi kos... shkruijmë 17...8.» Tymi i duhanit hapej. Çesa fjalë, që nuk shkruhen dot, e mbushën odën e gjatë të kafes që i kish muret e nxira nga tymi dhe frotat s'i kish të sigurta të mos t'i çirrte pantallonat.

Ora shkonte. Zërat shumoheshin. Tymi i duhanit përhapej në dhomën e kafes dhe u qëndronte myshterinjve mbi kokë si ndonjë re.

Kur e mbaruan lodrën, u vajti kafexhiu... Porositën një pesëdhjetësh prej manash dhe, duke ngrënë meze, duke qeshur dhe duke ngarë ata q'u mundën, e pinë.

Njerëzia po ngriheshin dhe shkonin nëpër shtëpitë ku i prisin të hanin darkë.

Shoqëria jonë porositi dhe një pesëdhjetësh. Shaka-të, të qeshurat, u lanë mënjanë dhe bisedonin, me zë të unjtër, për gjëra me rëndësi.

— A kemi leje të rrimë — u tha Raqi me Isufin.

— Urdhëroni, urdhëroni, nga ju s'kemi të fshehta.

Këta që të gjashtë, ishin dhe nga kombësia, dhe nga ndjenjat shqiptarë. Bisedimi përmblidhej mi temën e kryengritjes së Veriut. Puna bisedohej me zjarr. Cilido çfaqte mejtmet.

— Nuk është vendi këtu, — u tha Jakupi — mund të na përgjojnë.

— Po, — tha Raqoja — dhe ashtu na kanë në defterin e djallit, se na njohnin.

Kupat ishin plot, i ngriten i çokitën dhe, duke thënë... «Perëndia na nxjerrtë faqebardhë», u dhanë fund.

— Kjo punë duhet biseduar mirë — tha Raqi.

— Ngrehuni të shkojmë. Vemi në shtëpi tonë — tha Taqoja. — Unë jam vetëm dhe s'ka kush të na bëhet bela.

Ora kish shkuar. Myshterinjtë kishin shkuar dhe kishin mbetur vetëm miqtë tanë. Në çipin e fundit ish një burrë i cili parreshtur e lëshonte tymin e duhanit nga ullukët e gjérë të hundës. E kish drejtuar veshin nga miqtë; desh të përgjonte, po mjerisht zërat nuk arrinin dot mi veshin e tij.

— Eja të ngrihem, se po shkon koha. Ja, kafexhiu, i mbylli qepenat, — tha Piloja — apo kërkon të paguaj ndonjë xheza për ne.

Paguan, u ngriten dhe duke i thënë kafexhiut «natën e mirë» muarr udhën për në shtëpitë duke ndarë fjalën të piqen pas darke në shtëpinë e Taqos.

Ullukgjeri, pasi e pa që u ndanë, i çkujdesur vajti të ipte raportin.

\* \* \*

Ora edhe nuk kish vajtur tre kur që të gjithë miqtë ishin në shtëpinë e Taqos. Plaka ua shtrëngoi dorën dhe i pyeti për shëndetin ashtu siç dinë ato të pyesin. Ajo ish një grua e fishkur, plakë, e thinjur dhe e sëmurë.

Filluan bisedimet. Fjalën e mori Raqi, i cili, pasi ua shpjegoi nevojën e kryengritjes dhe detyrën që ka çdo shqiptar, u tha:

— Besoj se që të gjithë mejtoni kështu! S'e besoj të ndodhet nonjë prej jush që t'i dhimbetjeta! Punërat qëndronin ashtu siç ju thashë. Gjoni me Rapin më shkruajnë se i kanë të gjitha gati. Këto ditë do ta fillojnë. Më shkruajnë të piqemi në Z... S'duhet ta turpërojmë Korçën... duhet dhe ne ta mbarojmë detyrën.

— Korça, kurrë, nuk ka mbetur prapa dhe s'e ka nxirë faqen. — tha Hyseni.

Në këtë kohë u dëgjuan zérat e tjerë «ta mbarojmë detyrën... të shkojmë...» «Vetëm zëri i Pilos ish i ujtër dhe si i dredhur.

Piloja ish një djalë gjer më ndonja 22 vjetsh, mjaft i bukur në fytyrë dhe i pëlqente mëndja. Sytë i kish të shkruar dhe në to, ngaherë, çquhej qeshja e shakasë. Ish-një nga shqiptarët e mirë, më çdo çështje ishte i pari. Kur tha fjalën «ta mbarojmë detyrën...», u verdh në fytyrë... i pa miqtë, të cilëve as tërr s'u bëri veshi dhe i mati me sy duke dashur të kuptojë «ç'mejtojnë.»

Në këtë kohë u ngrit Jakupi dhe desh të fliste, po hyri plaka që solli kafenë. E këmbyen bisedimin dhe, kur dolli plaka, e mori fjalën Jakupi dhe tha:

— S'besoj të ketë shqiptar në botë që të mos ndizet sot, kur po na forcohet dhe rëndësohet robëria... Pa shkollë... pa të drejta... s'mundim ta hapim gojën që jemi shqiptarë... E a durohet? Për besë jo... Të shkojmë... të vemi fshat më fshat... t'i ngremë që të gjitnë dhe ta lirojmë Shqipërinë.

— Po, po, duhet ta lirojmë — me një zë thanë miqtë. Piloja prapë me zë të dredhur i tha këto fjalë. Atij i hu-

mbi gojëartësia dhe ai, që ish si tagar i grisur, këtë natë nuk nxirrte asnje fjalë. I humbën që të gjithë dhe mezi ndëgjoheshin vërvshëllimet. E pushtuan mejtimet: ato ja mbyllën gojën, ja humbën fjalët dhe ja prishën kurdisien e mirë. Tashi përparrë tij i dukej si kur ish mali... si kur ish kryengritës... i pa ushtarët dhe u përpooq me ta... I dëgjonte plumbat si vërvshëllenin dhe më në fund ju duk sikur u vra. U drodh i téri. Ish i pushtuar nga këto mejtime kur i tha fjalët e sipërme. Ra prapë në mejtime. Tani i dukej sikur shkonin male të larta... sikur u hodh në luftë... I ndoqi askeri... e zunë skllav... e rrähën t'i dëftente shokët... e shpunë përparrë ofiqalit, i cili e pyeti me zë të lartë... I dukej sikur i përgjigjej: «Jo, s'di asgjë... jo, nuk e di ku e kanë qendrën... s'kam shokë... «E shtrinë në dru..., e munduan shumë... s'duronë dot... i dëfteu shokët... e futën haps... atje u poq me shokët... i vinte turp t'i shihte e ata, i dukej, thoshnin «jazëk të qoftë, ne të dhamë besën e ti na more më qafë».

Në këtë kohë teshtiu dhe i largoi mejtimet. Kur shtiu sytë nga miqtë, pa që ishin gati të dilnin.

— Fjalën e nderit, që do të jemi gati të premten, — u dëgjuan fjalët dhe miqtë u larguan nga shtëpia e 'fa-qos.

Piloja, kokëvarur dhe me çape të ngadalta, shkonte udhës së madhe. U freskua nga era e ftohtë e natës dhe sikur u lehtësua nga mejtimet duke thënë: «Duhet të vdes për kombësinë». Ju afrua shtëpisë dhe trokëlliti në derën e vjetër. Ja hapi e motra... hyri dhe u drejtua në odën e tij.

Llamba po digjej me fitil të unjur. Kandili i korës ish i ndezur. E hapi llambën dhe, duke ardhur vërdallë nëpër odë, në këndin e së cilës i kishin shtruar për të fjetur, ra në mejtime. Mejtohej për kryengritjen dhe e pyeste veten: «Bëj unë për kryengritës? A do të duroj dot uri, të ftohtë, etje, ndjekjen e ushtrisë? Po të plagosem? Po të më vrasin?» Vdekja e turbulloj shumë se dhe ky i kish kurdisur qëllimet e veta: desh të martohej, ta gjëzonte të ëmën, se ajo nuk kish ditë të mos ngul-

te këmbë për këtë gjë. Ai desh ta martonte të motrën. Desh ta mbante mirë të ëmën se ajo nuk kish parë asnjë ditë të bardhë në tërë jetën e saj. U mejtua për gjithë këto, i dhembzi zemra... u mejtua për Shqipërinë, për ndjejkjet, për errësirën dhe u helmua shumë... dhe e push-tuan dy rrjedhje mejtimest. Mejtimi i kombësisë me zë të fortë dhe pa frikë e urdhëronte: «E ke për detyrë, mos vështro asgjë, as nënë, as motër, as martesë... bëje veten kurban për mua». E zëri i mejtimit për nënën ish i unjtër, me lutje dhe me lot ndër sy i thosh: «Kombësinë e ke për detyrë... Puno për atë ide, po mos më lërë dhe mua... se ja nëna do të mbetet vetëm pa pérkrahje, dhe në duart e urisë... motra do të mbetet pa strehë... e pamartuar dhe kushedi se ku e shtyn nevoja».

Nuk dinte nga të shkonte, nuk dinte cilin zë të dëgjonte? Zerin e kombësisë apo të shtëpisë, i cili i lutej kaq shumë dhe ja kujtonte pësimet dhe vojtjet që do të hiqnin njerëzit më të dashur?

Pa mos mundur ta zgjidhë këtë enigmë u çvesh, shoi llambën dhe u shtri në shtresën e butë. Desh t'i dëboute mejtimet që e mundonin. Po më kot, se ato, tashi më të errët, më shumë dhe më shpesh e mundonin. Përpara tij, kur kish sytë e myllur, qëndronin shokët të armatosur dhe e prisnin të dilte. Pastaj i dukej sikur shkuan në mal dhe sikur i vërvshëllenin plumbat. I dukej sikur u ndeshën me ushtrinë... Gjaku u derdh si lumë... nga të dy anët u vranë shumë. Pastaj, ja si kur mbetën pa bukë të rre-thuar në një mal. Pastaj pa tëmën të ligur, të munduar dhe të sëmurë nga nevoja e madhe dhe nga uria. Pa të motrën të ligur që kish rënë më gjumë pranë së ëmës, kish ngritur duart në qiell dhe i lutej zotit t'u dërgonte ndihmë.

Bëri me dorë përpara syve që t'i dëbonte këto pik-tura, desh t'i largonte këto mejtime dhe niste të vër-shëllente ose të këndonte ndonjë këngë. Më kot, ngaqë pikaturat e liga, me pamje të tmerrshme, nuk e linin re-hat asnjë sekondë. Çdo minutë ose shihte veten të vrarë, ose miqtë që e prisnin, ose të ëmën që qante... ju lar-

guan këto mejtime dhe i hynë të tjera që nuk ishin të zeza sterrë, po të bardha si dëbora, si penda e patës... Tashi i dukej sikur i veshur me rrobat e malit dolli te vënëndi ku e prisnin shokët dhe së bashku shkuan maleve... U përpoqën me ushtrinë, luftuan dhe i mundën. Pastaj një ndeshje tjetër, në të cilën ky dëfteu trimëri të madhe, bëri yrysh dhe i thyen turqit. Pastaj, ju duk sikur bënë paqe. Ky ish bërë kapetan, kish marrë nishane dhe shumë ndere. E pa Shqipërinë të liruar. E pa veten të nderuar... Pastaj, e pa sikur u kthyte në Korçë me një shumicë. Ky ish përpara. Tërë bota e dëftenin me gisht... cilio fliste emrin e tij. Të gjithëve u faleshe me një mburësi... Pastaj e pa veten nëpunës të Shqipërisë, e pa të ëmën të gjëzuar dhe të lumtëruar.

Këto mejtime e dehën. I kish dhënë fund të shkojë kryengritës, e hodhi jorganin mi kokë dhe u kthyte nga ana tjetër duke thënë me vete: «Po të fle tashi, pa». Po, o fatkeqësi, me të kthyer, i rrëzoi mejtimet e bardha se vëndin e tyre e zunë të zezat.

I munduar, kur nga mejtimet e zeza, kur i gjëzuar nga mejtimet e bardha, mezi, ndaj të gdhirë, e zuri gjumi, i cili ja largoi mejtimet.



Për tërë botën ditët shkonin pa kuptim. Pilos, ditët i dukeshin muaj. Mejtimet asnjë sekondë nuk e linin. Mezi, kur u gdhi e prente, i kish dhënë fund të mos vëjë, se e gjente që nuk bënte dot dhe nuk kish ku ta linte dhe si ta linte të ëmën dhe të motrën.

Ora kish vajtur 12 alla-turka. Më një ish ora e pjesës, prapa Shën Thanosit. Pasi u tha të shtëpisë, «tashi do të kthehem», pa ngrënë darkë mori udhën nga Shën Thanasi.

Dheun e kish pushtuar një errësirë e fortë. Qielli ish i kthjellët, nuk kish hënë; dhe yjtë ndritnin pak që nga naltësia e tyre. Si ndonjë qilim i madh dukeshin vresh-

tat me fletët e tyre të dëndura. Pamje të bukur kishin malet që ishin pak larg, ku të veshur, ku të ç'veshur dhe dukeshin posi fortesa të kohës së vjetër. Një qetësi e madhe mbretëronte, të cilën e prishtë cicërimi i shpeshëve që nga koria e largmë, rrjedhja e ujës të mullirit që binte që nga një vënd i lartër... Nuk frynte as ndonjë erë. Si dukej asgjë nuk desh t'ja çqetësonte gjumin dheut. Në këtë hapësirë dëgjoheshin çapet e ngadalta të Pilos. Ai po shkonte duke menjuar. Nisi ta fajtonte veten që nuk u bë gati se tashë i desh të vinte. Në zgjatjen e pesë ditëve, sado që dhe më parë ish i dobët nga trupi, u lig fare, se as hante dhe as flinte. Mejtimet ja kishin çdukur që të gjitha.

Po shkonte bregut, menjtohej dhe shikonte tutje. Dukej karakollana, përpara së cilës me pushkën në sup, me çapa të përtimshme, një ushtar, po bënte marshrutin. Piloja u drodh dhe shkoi më mengadalë. E këmbeu udhën. Ushtari pasi bëri dhe ca marshrute u sheshua mi sofatin q'ish pranë derës dhe e zuri gjumi. Zuri të gërendej. Piloja po ngjitej.

Kur u unj nga ana tjetër e bregut, pa disa trima të armatosur. Në mes të tyre ishin dhe shokët e tij. Që të gjithë gati pér të ikur. Piloja u drodh, ju këmbye ngjyra e fytyrës, dridhej dhe u afroa më pranë. Miqtë, kur e panë, që pér së largu i thirrën: «Ç'u bëre, se ty po të presim». Kur u afroa dhe e panë të pa armatosur, ja thirrën të qeshurit dhe i thanë me ironi:

— Oj, paska frikë Piloja!

Kjo fjalë ja humbi dhe atë çikë të kuq që kish mbetur në fytyrën e tij. Zuri të shikonte njërin mik pas tjetrit duke dashur të shohë në fytyrat e tyre «ç'ndjenin». Desh që të kish ndonjë t'i ipte të drejtë. Vështrimi i tyre ish i mbushur me guxim, se nuk mejtonin asgjë tjetër përveç të mbaronin idealin e tyre. Piloja gjithë i vështronë dhe s'mundte t'u fliste as gjysmë fiale. Dukej si skelet. Këtë gjë e vuri re Raqi, i cili e desh më shumë nga shokët e tjerë. Desh t'i ipte të drejtë, po, kur pa Hy-senin, i cili nuk ish më i shëndoshë, heshti dhe zuri t'i parabiste miqtë. Padashur, në trutë e Raqit, i qëndroi

shtëpia e Pilos, me plakën e kërrusur dhe me të motrën që ushqeheshin nga puna e djalit. Pastaj ju kujtua shtëpia e Hysenit, e cila ish në rafshëri nga të gjithë të mirat, me të vëllezërët më të mëdhenj, me t'anë e shëndooshç. Nga këto mejtime, prapë padashur, mori anën e Pilos. Dhe, duke parë shokët, tha.

— Mirë bëri që nuk ardhni Piloja. Nuk e shihni, more, ai me këtë udhë dhe u bë si i vdekur! Nuk ka fuqi, ja, po gulçon sa ngjiti këtë të përpjetë. Po kur të ngjité male të larta?

Miqjtë nuk folën dhe as që kuptonin që Piloja ish i dobët. Në këtë kohë gjithsecili prej syresh mejtonte malin, goditjet dhe luftërat.

Piloja e mori veten dhe u tha:

— Të dashur miq! Sa për ndjenjën që e kam të shqiptartë, nuk besoj të dyshoni. Nuk mund të bashkohem me ju, e mejtova shumë, po nuk do t'ju sjell as ndonjë dobi... Në këtë hop në trutë e tij i qëndroi fjala «nuk je trim». Përnjëherë i lojti zemra, bëri një çap përpara, ish gati ta hapte gojën dhe t'u thosh që ish gati të shkojë. Përnjëherë ju dëgjua një zë tjetër «po shtëpinë kujt do do t'ja lësh» dhe e mblodhi veten. E mylli gojën. Pa miqtë që po bëheshin gati për udhë dhe që ishin të mbushur plot me mejtimin e kombësirë, duke mos gjetur vend, në zemrat' e tyre, mejtimet e tjera.

— Më ndjeni, udha e mbarë ju qoftë... dhëntë zoti e mbarofshi qëllimin.

— Dhënte zoti e mbarofshim, se edhe ti duhet të mos harrosh sa të thamë... — i tha Raqi, i cili foli çesa kohë me të dhe e porositi për shumë gjëra. — Njerinë nga javë do ta dërgojmë. Me letra do të t'i shkruajmë ç'të na duhet.

— Besoj se do t'ju jem i nevojshëm. Detyrën do ta mbaroj — u tha Piloja.

U fol dësht shumë nëmes të miqve. Yjtë çapitnin në qilli. Hëna, që dukej si drapër, e dëfteu njërin bri që nga majërat e malit. Piloja i pikëlluar që nuk mundi të vejë në mal dhe i lehtësuar që mori një barë përsipër u

kthye në shtëpi. Ora ish më shumë se tre e natës. E ëma nuk flinte, gjithë përgjonte. Sofra ish shtruar. E motra kish rënë pa ngrënë bukë. Kur ja hapi derën e ëma, e priti me një qërtim, në të cilën çquheshe kujdesje: — Ku ishe gjer tashi, o bir! Po të presim të hamë bukë.

Këto fjalë ja kujtuan mejtimet e para. Tashi më nuk e fajtonte veten që nuk shkoi se ai e kuptoi që me atë gjë do ta vriste të ëmën dhe të motrën.

Kokëunjur i shkoi përpara së ëmës dhe, duke u drejtuar në dhomën e tij, i tha:

— Njëqind herë të kam thënë, po të mos vij gjer më një sahati, të hani bukë.

\* \* \*

Kishin shkuar disa javë. Shumë herë kryengritësit ishin përpjekur me ushtrinë. Në këtë kohë në Korçë ish mbledhur një ushtri e madhe dhe e kishin ndër mend t'i shuanin kryengritësit. Policia po kërkonte më të katër anët dhe i futte haps ata që u shpinin bukë, opinga e fishekë. Piloja kish frikë a mos e zinin, po kurrë në trutë e tij nuk i hyri mejtimi ta linte punën që kish zënë. Ngaherë bashkë me ca të tjerë, mblidhnin para dhe dërgonin në mal q'kishin nevojë kryengritësit.

Shokët e Pilos, në mal, e kupëtuan që ai zgjodhi rolin më të math. Ai ish në duart e qeverisë dhe do të mundnin t'a zinin kur ata ishin në mal. Ngaherë, kur rrin rreth zjarrit që e ndiznin në mal në netët e ftohta, në bisedimet, e kujtonin Pilon dhe thoshin shumë shpesh:

— Shiko, more, Piloja po na bën shërbime të mëdha. Punërat e kryengritjes nuk kishin vajtur dhe aqë mbarë, se krerët po hanin kokën njëri me tjatrin. Po shpresa ish që ta ndreqnin.

Në Korçë u përhap lajmi se ushtria të mërkurën do t'u bjerë kryengritësve. Këtë gjë me siguri e mësoi Piloja nga një kolonel që e kish mik, i cili blinte plaçka në atë dyqan ku ish shërbëtor Piloja, Komitat, e dinte që

ishin dy sahat larg Korçës dhe spiunët ja kishin thënë qeverisë. Pilos nuk i rrihej më një vend. E dinte që ata do të humbisnin që të gjithë, po të mos i lajmëronte. Nuk kish as ndonjë njeri të besuar, me të cilin t'i lajmëronte. Njeriu i tyre nuk kish asnjë ditë që erdhi. Lajmet i mësoi më pastaj. Të priste, gjer të kthehej, ish tepër vonë. Koha nuk priste. I mejtoi tashi këto që të gjitha. Bëri sikur t'i merrte përsipër, zëri i familizmës po nuk gjeti dot vend. Tashi, nuk kish frikë dhe e quante më të madhe detyrë t'i lajmëronte.

Mori udhë dhe shkoi, fshehurazi, mbrëmave kur dheun e kish mbuluar errësira dhe qielin retë e dendura dhe të zeza. Me shumë mundime e gjeti shtëpinë e kapetanit. Pernjëherë u muar vesh si ta bënин planin. Po ushtria e kish shpejtuar punën dhe u gjetën të rrëthuar. Piloja e mori martinin dhe lëftonte si trim. Në mëngjes ushtarët u shumuan. Komitat bënë rysh dhe i çanë që natën. Piloja i plagosur në këmbë mbeti në fshat. Ushtarët e gjetën. E shpunë në Korçë ku, pasi e shëruan, e gjykuani. E pyetën për shokët, e rrahën, e munduan, po ai nuk rrëfeu asnjeri dhe i duroi që të gjitha.

\* \* \*

Kishin shkuar shumë muaj. Piloja po kalbej në hap-sanë. Nganonjëherë i vinin ca të njohur ta shihnin. Shumë shpesh koloneli me të tallur i thosh:

— Po dhe ti të ishnje nga ata, kurrë nuk e besonja.

Një ditë u hap lajmi se kryengritësit bënë paqe me qeverinë. Fituan shumë të drejta dhe amnisti të plotë. Piloja dolli nga hapsana. Dëgjova se u martua dhe rrën i lumtur bashkë me të ëmën.

## **PLAKU I MOÇËM**

Ish dimër. Tomorri i shenjtë zbardhte nga dëbora. Drurët dukeshin si të mbuluar me jaka. Era frynte si e marrë. Nëpër monopatet, ngadalë, shkonte një karvan me mushka. Unë, i çkëputur nga ushtria e thyer, kërkonja strehë. Tingëllimi i zileve, që lëshonte oshëtime, dëgjohej me një zë i fshehtë. Po shkonja, bashkë me karvanxhinë, duke folur e duke kërkuar ndonjë vend të ngrohtë.

— S'e kemi mirë udhën. Na humbën gjurmat. Vetëm instinkti i mushkave do të na nxjerrë në rrugën që duhet. Gjer më sot edhe s'kam parë të tillë dimër — më tha karvanxhiu. E unë në sytë e tij këndova frikën që e kish pushtuar. Të ftrohtët sa vinte po shtohej. Mua më mundonte dhe uria. E karvanxhiu vazhdoi: — Këtu afër duhet të jetë një kasolle... Ja, e sheh, atje ngaherë është i ndezur një kandil, po sot se pse s'duket dritë...

Shkuam me tahmin<sup>1)</sup> dhe shumë kohë duke ndjekur mushkat. Isha si i lënë dhe i hapnja këmbët si automat. Zëri i karvanxhiut më shkundi nga mejtimet e rënda dhe të shumta që më kishin pushtuar. Fjala e tij u përpoq në mal dhe oshëtima u kthye si më e fortë:

— Ja, a e sheh?

---

1) me tahmin — me mend, me hamendje.

Që tutje ndriti një kandil si i venitur. Muarrëm udhën nga drita. Rrëzë malit ish një kasolle. Trokitëm dhe hymë brënda. Ish vetëm një odë. Muret, trualli dhe dy vrimat, që ishin si penxhere, ishin të shtruara me lë-kurë egërsirash. Vatra ish plot me prush. Te ërrënia na pri-ti një plak i zbardhur si pata, i hollë si plepi dhe i rrudhur si ndonjë këmishë e larë, po e pahekurosur. E vura-re me kujdes. Desha të kuptoj vallë sa vjeç do ish. Në fyttyrën e tij s'i kish mbetur as ndonjë nga shenjat e njerëzve që rrojnë. Më të na parë, u kthyte në odë, na dëf-teu viset pranë vatrës, ndenji dhe na tha:

— Ngrohi! Dru kemi sa të duash. Nga buka jemi si ngushtë, po, atë që kemi, me njerëzit e mirë do ta ndaj-më.

Ju falëm underit. U ngopëm dhe u ngrohëm. Koha jashtë s'kish të ndreqejet. Mushkat, vajti karvanxhiu t'i vendoste në katua e unë ju lutshë plakut të më rrëfejë ndonjë gjë ngajeta e tij. Dhe ai nisi:

— Do të ta mbaroj lutjen tënde. Mos të mbetet hat-tri. E shoh, nga sa folëm, se je shqiptar i mirë. Unë i kam parë të gjitha punët siç rrodhë në Shqipëri. E kam njojur dhe Skënderbenë. I kam vajtur vetë në Jemen dhe ja kujtova detyrat të birit të Gjon Kastriotit. Në atë kohë ai ish dhënë i téri pas luftërave dhe pas famës. E kish harruar Krujën e bukur, gëzimet e foshnjërisë, përkëdheljet e së emës, traditat e gjyshëve dhe s'e dinte që atdheu i ish robëruar... Nderimet që e rrëtheonin, bashkë me bukuritë dhe me qejfet, që i kish në atë vend me çdo çast që të desh, ja kishin humbur kujtimet dhe mallin për Shqipërinë. Ja kujtova që të gjitha. Ju drodh zemra... I solli ndër mënd. Ja dhashë mandatën për t'anë, i thashë për të vëllezërit që ja kish vrarë sultani dhe i tregova që e éma, bashkë me të motrat, muarrën arratinë.. U ndez.. Zemërimi e pushtoi përnjëherë. Sa i bukur dhe madhështor që ishte në atë minutë! S'u mejtua aspak. E shkundi pluhurin e Anadollit nga këpucët e tij dhe, bashkë me mua, u kthyte në Shqipëri.

Lëftoi si dragua... E shoi armikun dhe e vuri në

vend nderin e vatrës së tij dhe të Shqipërisë. Kam qënë kurdoherë bashkë me të. E vinja re si parësia zihej në mes të saj dhe si, për ambicie personale, i solli shumë dëm Skënderbeut dhe përparimit shqiptar. I mbaj mënd që të gjitha tradhëtitë dhe tradhëtorët... Po, ai kurdoherë, do li faqe bardhë. Skënderbeu ka patur më shumë armiq se sa miq nga parësia... Po, jam që nga ajo kohë dhe e kam shëtitur Shqipërinë anembanë. E kam mbjellë farën e dashurisë sonë dhe jam përpjekur për shpëtimin e racës së madhe që të mos shuhet... Kemi mbetur pak?...

Po, se parësia është kurdoherë pas interesit personal dhe kurrë s'ka dashur ta bëjë veten kurban për atdheun... Populli? I shkreti popull, ai kurdoherë ka qenë gati ta ndjekë parësinë!.. E di... mos ma thuaj... Mos m'i kujto... ata, për ne, kurdoherë do të mbeten të huaj. Jo, s'janë shqiptarë, se ata kanë punuar për dëmin e Shqipërisë dhe për fitimin e armiqve të atdheut... Kanë qënë ea që e kanë dashur vendin e tyre... janë munduar t'i mbarojnë porositë e mia po, të tradhëtar, ca janë vrarë dhe ca po kalben nëpër hapsanet. Mos ma pre fjalën. Unë e kam parë diellin më parë nga ti dhe e njoh botën më mirë. Duhet ta dish se bota e madhe kurrë s'ka patur interes për të na ndihur; qëllimi i saj është t'i mijelë dhe përdorë popujt e vegjël. Dije, pra, o biri im, se Shqipërinë, si dhe çdo popull të vogël, e ka marrë më qafë parësia. Ja, nga ky shkak dhe populli ynë ka mbetur pas... I vetëm ish ay që e ka dashur popullin tonë... Ai ish Skënderbeu.

Kur ish i sëmurë dhe e pa që s'kish më shpresë të rrонte, si zuri besë asnjeriu prej të parësisë, që t'ja linte amanet flamurin dhe nuk gjeti as ndonjë të zotin t'i zinte këmbën. Ahere më thirri dhe, sy ndër sy, më tha:

«A e sheh atë flamurin që po valon atje mi kalanë e qytetit... Unë, nesër pasnesër, do të vdes, po ti unje vete që të mos bjerë në duart e turqve... Mbaje me kujdes... prit... ki durim... dhe gjuaje rastin që ta ngresh përsëri...» Kur vdiq Skënderbeu, unë e unja flamurin... E mbarova porosinë e tij... e parësia, kur trupi i tij edhe

s'ish futur në dhe, kish marrë udhën për në Stamboll, ku u bë shërbëtore e sulltanëve... Djalin e përcolla përtëj detit... Që nga ajo ditë e gjer më sot kam bredhur nëpër tërë Shqipërinë: kam pritur rastin që ta ngre përsëri flamurin e bekuar dhe çdo ngjarjeje ja kam vënë veshin me kujdes. Ora e mirë s'kish të vinte. Kishin shkuar disa qindra vjet që po jetonja mbi dhe. Kam parë shumë luftëra... E pashë dhe luftën e Ballkanit. Në atë kohë instinkti im që më thesh se roli im po afrohet. Gjer më atë ditë pandehnja se do të vdisnjë pa e mbaruar porosinë e Skënderbeut. Shëtitnja, si i marrë, nëpër malet, ku nuk ish vënë vala e robërisë dhe më gëzohej zemra. Një ditë, kur isha i mërzitur, zbrita te çipi i detit. I vura re valët e tërbuara, qiellin e mvrenjtur dhe horizontin që bashkohej me detin. Padashur m'u kujtuan ato gjemitë, me të cilat e përcolla të birin e Skënderbeut për në viset e huaja. Atë djalë e prita shumë kohë, po më kot, se ai s'u kthyte ta merrte trashëgimin e t'et. Në këtë kohë, në çip, plasi një valë dhe një zë plot me melodi më tha:

«Mos u bëj merak; mos u dëshpëro, se ky uji i bekuar, tek i cili raca e madhe e ilirëve, e gjyshëve të kombit tënd e shtroi gunën, do t'ju shpëtojë nga çdo robëri.»

Fjala e valës më vuri në mejtime dhe ma shtoi shpresën... Ushtritë e ballkanasve po hynin në Shqipëri. Në këtë kohë nuk dinja ku të fshihesha dhe mora udhën për në Tomorr. U ngjitshtë në majën më të lartë; rashë mbë gjunjë dhe ju lutshë qiellit dhe yjve. Në lutjet e mia m'u dëftyen tri fatia<sup>1)</sup>, që ishin si të bukurat e dheut.

E para më tha:

«Sot është dita për punën tënde. Shko... merr udhën për në Vlorë... Atje po të presin dhe ngrijë flamurin, mbaroje porosinë e Skënderbeut.»

E dyta më tha:

«Thuaçi parësisë të heqë dorë nga zakonet e vjetra; të mos bëjë intriga; ta dojë popullin; t'i vijë në ndihmë vendit dhe t'i bindet më të zotit.»

---

1) fatia — fallxhesha.

E treta më tha:

«Që sot e tutje në kasollen tënde, që e ke rrëzë këtij mali, do të ndizet një kandil; kur të shuhet drita e tij, të shpejtosh ta marrësh flamurin dhe ta ruash për ndonjë rast tjetër.

Fatiat, me të mbaruar fjalët, më humbisnin njëra pas tjatrës. Fërkova sytë, se m'u duk si éndërr. E mblojdhë mendjen dhe mora udhën për në Vlorë. Arriva me shumë mundime. Më prisnin... Kjo ditë ish 28-ta e vjeshtës së tretë 1912. Ishte si do zot sot. Kanë shkuar shtatë vjet...

— Djalë, vërë dru në vatër, — më tha plaku kur mbaroi — mos i kurse — dhe i shtiri sytë te kandili, drita e të cilit ish e venitur. E vura re plakun që u verdh... Rrëmbeu gunën dhe, duke shtyrë derën me rrëmbim, më tha:

— Jam për udhë... Shkoj tutje... Ju rrini këtu, se jeni të lodhur... Mund që shpejt të kthehem... Ja tek janë drutë... Shkova...

Kur u ngritshë më të nesërmët, se më kish zënë një gjumë i rëndë, plaku ish kthyer. E vura re se xheç mban-te fort në gji...

1919

## D E S H M O R I

Gjoni kish më shumë se një orë që po shëtiste në-për dhomën e tij që e kish të vogël, të bukur, po të mobiluar me shije fshataraku. Në këtë kohë, ai mejtonte pér punërat e Shqipërisë, që vinin keq e më keq. I solli ndër mënd që të gjitha sa rrodhën dhe si u krijua Shqipëria. Ju kujtua dita kur priste, në limanin e huaj, që të hiqej blokada dhe të vinte në Shqipëri. Gjoni ahore ish plot me shpresë; ai desh të bëhej, në mos ministër, dobare ndonjë drejtor. Kish besim të madh mi veten se, sado që s'kish mbaruar ndonjë shkollë, kish kënduar shumë dhe ish mbushur me teorira të larta, të cilat dëshironte t'i vinte në praktikë. Që të gjitha këto i dukeshin të lehta, dhe, me cilindo që piquej, vetëm pér këto bisedonte.

Blokada s'kish të hiqej; paratë, që kish sjellë me vete dhe që kish fituar me mundime të mëdha, ju mbaruaruan; miq s'kish; desh t'u shkruante letra ca kushërinjve, po, duke patur shpresa të pakta, e la mënjanë këtë mejtim. Kish pér të paguar në hotel dhe në restorant... Kish disa ditë që s'kish ngrënë me rregull. Flinte tërë ditën dhe shpirtin e tij e mbante me ujë... Dhe një ditë, kur kish mbetur i parrojtur, kur kish dy ditë që s'kish vënë në gojë erën e brumit, poqi një nga të njojurit e rinj që ish nga komitat e Shqipërisë. Këtij ja tregoi hallin, ju qa pér vojtjet dhe i lypi hua ca para. Ja, ky e njo-hu me ata që duhej... Ky ja bëri ndërmjetimet dhe Gjoni shpëtoi nga hallet.

Duke mejtuar gjer këtu, Gjoni e kuptoi se, dhe ai, ka gisht në prishjen e Shqipërisë. Trutë ju mbushën me mejtime dhe nga goja, padashur, i duall këto fjalë:

— Epiri u dogj e u çkatërrua; Shqipëria u prish dhe ra në duart e komitës turkomane... Ah, dhe unë kam gisht në këtë punë të pabesë kundër kombësisë sime!

Atij i dukej sikur kish mbi zemër ndonjë gur mulliri. Mesdita kish arrirë; Gjonit s'i vinte mëndja për bukë; ai po kujtonte ditën dhe orën që e bëri i mallëkuari me vete. Në trutë e tij hynin dhe dilnin shumë gjykime, që kundërshtoheshin në mes të tyre. Ca prej syresh ja lehtësonin fajin dhe ja zbardhnin ngjyrat e zëza. Në këtë minuta i thosh vetes:

— Pse ta mundoj veten? S'ndjej të kem bërë gjë kundër atdheut? Kisha nevojë për para; u ndodhën njerëz të mirë dhe më shpëtuan nga nevoja dhe uria. Pagova borxhet, u vesha, u mbatha... Vallë c'mëkat kam bërë? Kur i mora paratë, s'dhashë as ndonjë zotim, vetëm më kërkuan të pirpiqem për Shqipërinë, të bëj propagandë kundër armiqve të saj...

Gjyki i fundit e liroi nga dyshimet; dolli jashtë dhe, i çkujdesur, shëtitte nëpër skelën e qytetit të bukur që ku me fantazi shikonte Shqipërinë e dashur.

\* \* \*

Kishin shkuar shumë ditë. Blokada ish hequr e Gjoni rronte i çkujdesur, sado që nuk bënte ndonjë punë. Shokët kishin dyshime dhe s'i zinin besë, po atë s'e mundonte asgjë. U mësua, dhe paratë e muajit i merrte gjithë me atë qetësi që i merr punëtori, zyrtari, agjenti... Mirëpo, lajmet që këndonte nëpër gazetat zunë ta turbullojnë pak se, pas syresh, kuptohej që Shqipërisë po i pre-gatitej vdekja. E kuptoi dhe qëllimin që kishte qeveria, nga e cila paguhev dhe ra në mejtime. Zuri t'i shante

shkaktarët, po jo sheshit. Miqtë e kishin kuptuar dhe e kishin lënë vetëm. Ja, pas gjithë këtyre, nisi ta kuptojë se duke mbrojtur një qeveri që preqatit prishjen e Shqipërisë, bën tradhëti. Po një zë e qërtonte duke i thënë: «Mos u nxito se ajo do ta këmbejë taktilën». Në minutat që i mbushej mëndja se bënte tradhëti, ish gati t'i refuzonte paratë, mirëpo i kujtohej qiraja e odës, restoranti, theatrot dhe ja rrëzonin vendimin me qërtimë.

Tirana, Elbasani, Berati dhe shumë vise të tjera kishin rënë në duart e rebelëve. Ushtria e Veriut u çakërdis pa lëftuar se, siç thosh Gjoni, u hyri djalli në mes. Korça dhe viset e tjera të Jugës ranë në duart e kryengritësve epirotë. Këto ngjarje e bënë Gjonin të mejtohet, dyshime më s'i kishin mbetur që dhe ky vetë kish gisht në prishjen e Shqipërisë.

Dita që e merrete rrrogën kish shkuar qëkur. Në xhep s'kishte asnjë metalik. Tani s'mejtonte për urinë, as për qiranë, as për theatrot, po si do ta vinte nderin në vend. Po uria është shumë e fuqishme, ajo ja prishi vendimi e parë dhe e shtyri të vejë të marrë paratë. Atje i zgjatën një dëftesë për të nënshkruar. Gjoni e pa zyrtarin dhe ju duk vetja se mos është Judha. Në sytë e zyrtarit këndoi këto fjalë:

— Ja, dhe ti, si Judha që e shiti Krishtin për para, po e shet atdhenë.

Paratë i mori me mundime të mëdha, po, kur e pa zyrtarin, në sytë e tij këndoi dhe këto fjalë:

— Gjersa të ketë në Shqipëri njerëz që do të ma trokëllasën derën për të lypur të holla, ne do ta mbarojmë qëllimin tënë.

Ju errën sytë, e në veshët ju dëgjua një zë:

— Për ca para të shkreta po më tradhëton! Të zëntë qumështi që ke pirë nga gjiri i nënës!

Ky zë e liroi dhe nga tronditja e fundit. E rrëmbeu dëftesën, e bëri copëra; paratë ja hodhi zyrtarit fytyrës dhe, i lehtësuar e i shkundur nga çdo barrë, dolli jashtë.

\* \* \*

Krisi lufta pranë Vlorës, Patriotët po përpinqeshin ta mbanin të lirë këtë qytet ku valoi flamuri për të parën herë pas skllavërisë. Gjoni kish ardhur vetëdashës dhe suloj në radhën e parë. Shumë herë i theu rebelët dhe u zaptoi pika me rëndësi. Po në një goditje, që ngjau te praku i Vlorës, ra i vdekur për idealin e shenjtë. Dhe rebelët, duke shkelur mbi trupin e Gjonit, hynë në qytet, unjën flamurin e Skënderbeut dhe ngritën të babës.

*Korçë, 1927*

**MARKO MJERI**



Të zbrazurit e pushkëvet më s'dëgjohej. Era zuri të frynte e qetë dhe të shpërndante renë e barutit, që ishte në perëndim.

Marko Mjeri rrinte prapa gurit dhe, me të drojtur, shumë shpesh, e nxirrte kokën që të shihte, se kishte frikë të dilte nga prita.

Kur nisi dyfeku, Markua ish vetë i pesëmbëdhjetë. Kur u përpinqën me armikun, që ish shumicë e madhe, ju përhapën shokët. Mbeti i vetëm dhe zbrazte pushkë pa rreshtrur.

Dielli po i afrohej perëndimit. Gjer në këtë kohë e kishte nxjerrë shumë herë gunën. Asgjë s'i përgjegjej. Hapësira kish rënë në heshtje, qetësia mbretëronte në çdo kënd dhe s'kishte aty afër as shpeshë e as kafshë. Duke ndenjur kështu, e ngriti kokën e tha me vete: «Do të kenë shkuar» dhe mengadalë mori udhën. Diellin pak nga pak e zaptoi ana tjetër e dheut dhe e pushtoi në krahet e tij. Errësira ra në të katër anët... Yjet, e ndritnin qiellin dhe i jepnin malit një pamje të bukur e i tregonin Markos udhën. E ai, pasi bëri ndonja njëqind hapa, qëndroi, numëroi fishekët dhe pas yjeve e mori udhën... Ora shkonte. Yjet çapitnin dhe i ndërronin viset e Markua, pasi bëri mjaft rrugë, ndjeu të lodhur, u shtriq, u zgjat, krisht këmbët e duart dhe nga goja, duke pshëreti-

tur, i dolën këto fjalë: «U lodha shumë, tërë ditën s'kam ngrënë asnje thërrime bukë.» Hapi trastën, ku i kishin mbetur ca kothere dhe pak gjizë. I hëngri. Ky ushqim s'i zuri as dhëmbët... Mori udhën... I ngriti sytë nga qielli, pa yjet dhe murmuriti: «Udhën e kam mbarë, po nuk e di sa larg jam! Kushedi? Atje mund të ketë roje? Dhe, duke u mejtuar, mori udhën në të tatëpjetë... kishte gurre... rrypa... gryka... Këmbët nuk i ndjenin të lodhur. Markua largohej e largohej... Uria e mundonte, po dhe etja nuk e linte të qetë. Pa në të katër anët, vuri veshin të dëgjonte se mos rridhët ujë, po më kot, vetëm një erë frynte, që ja prishtë qetësinë malit.

Pa bukë, pa ujë, pa gjumë, i hodhi sytë larg... Asgjë nuk dukej... Mori udhën e shkoi më tutje. — Mbi veshin i qëndroi kënga e këndesit. I qeshi buza. Ku mbarohej e zbritura e malit, pa një kullë. Me dyfekun në dorë ju afra dhe zuri pritë. Nuk dëgjohej gjë. S'dinte ç'të bënte. Zuri të shkonte drejt... kish frikë mos kishte asqerë... po të mos shkonte, e mundonte uria. Këndesi këndoi disa herë, po nuk ja priti asnje tjetër. E kuptoi që katundi ndodhej larg. Zbrazi dy-tri-herë. priti pak dhe u drejtua te nulla. Pa muret e saj të rrëzuara në shumë vise. Kjo pamje ja pikëlloj zemrën. Muret nuk i kishte prishur koha, po gjylet e atyre që u bënë shkaku i prishjes dhe i urisë. Kulla i solli ndër mend fshatin e tij, gruan, fëmijën, të motrat dhe nënën plakë... I kishte lënë vetëm në fshat. Kish një muaj që kish dalë nga shtëpia dhe s'dinte në i kish të shtëpisë gjallë. Përpara kullës i harroi që të gjitha: urinë, etjen, lodhjen, gjumin, se fantazia e shpuri në fshat ku i pa të shtëpisë të mbledhur tok, me dyert myllur e të verdhur nga frika e nga uria. Që të gjithë i kishin fytyrat si prej të vdekuri dhe, nga sytë, u dilte një shkëndijë e venitur; mbi faqet u dukej një cipëzë e hollë, që ishin lotët e tharë... I dëboi fantazitë dhe u drejtua te nulla. Dyert ishin tytë. Me të hyrë brenda, u drodh e u tmerrua, se në dhomë ishin shtrirë pa shpirt dy gra, që dukej se ishin munduar shumë para se të vdisnin. Ca më tutje pa shpirt ishte shtrirë një plak; këtij i kishin prerë

këmbët dhe duart. Nuk e kishte njërin sy, ja kishin nxjerrë me goditje kame. Ca më tutje ishin ca çiliminj të çarë pér mesi. Në fund të kullës ishte një nuse e re, me barkun të çarë nga ku i kishin nxjerrë një foshnjë të vdekur dhe të bërë copë-copë. Sytë e nuses kishin mbetur të hapur dhe, në to, shquhej përpjekja e madhe, që kishte bërë me egërsirat... Markua u drodh... Nuk duroi dot t'i shih te këto mizori... Duke u larguar nga vendi i tmerrit, i ra dyfeku nga dora dhe me psherëtimi tha: «Egërsira dhe nuk bën aq shumë». E zuri kokën me duar, u shtrua mbi një gur dhera në mejtime: «Vallë kush t'i ketë bërë gjithë këto?» Pa vonesë një zë i brendshëm i tha: «Po kush përveç turqvet?» Ky zë i futi tmerre të mëdha. I shtrëngoi grushtet, ngriti dyfekun dhe mori udhën, se në atë kohë harroi se kish dalë malevet. Mendjen ja kishin pushtuar këto pyetje: «Po të ketë hyrë në katund askeri, vallë, q'do t'u bëjë fëmijëve? Pa dyshim do t'i bëjë copa-copa». Me shpejtësi mori rrugën.

\* \* \*

Kishte shkuar shumë kohë. Dherin e pushtoi një erë e hollë. Yjet e kishin humbur dritën. Agimi i dëfteu sytë. Tani Markua donte të vinte sa më shpejt në fshatin e tij ... donte të mbronte fëmijën nga vdekja... Shtiri sytë dhe tha: «Andej, andej duhet të jetë fshati im!» I munduar siç ish prej mejtimevet të shumta, ndjeu t'i vërvshëllejë një plumb. Hodhi syrin dhe pa dhjetë askerë. Në këtë çast e harroi shtëpinë. U shtri barkazi... S'kishte arritur të zinte vend, kur një batare plumbash i vëshëlleu mbi krye. Krishi lufta. E kishin rrëthuar keq. Markua zbrazi shumë dhe i kishin mbetur vetëm edhe pesë fishekë. Dielli ish ngritur disa hostenë e askeri as ndër mend nuk e kishte të hiqej. Markon e pushtuan prapë mejtimet; pa pikturna të zeza, i luajti zemra, u pikëllua dhe zbrazi andej nga dilte tym. Barku zuri t'i dhembte nga uria. Vë-

shtroi prapë tutje dhe sërish e pushtuan mejtimet: «Çdo të ngjasë, po të hyjë askeri?» Ky mejtim e shtyu të bënte yrysh duke thirrur:

— E dilni, bre qena, dilni të vritemi si burra!

Ushtarët u ngritën në këmbë dhe filloi sërish lufta. Markos i vinin plumbat përmbi kokë e bamb... bamb, dëgjohej parreshtur. Ai largohej e largohej zvarrë.

Një plumb i ra mu në kraharor. U plagos rëndë... U zvarrit... mori dyfekun në dorë dhe e zbrazi dhe një herë. Por plaga zuri t'i ftohej... I ra dyfeku nga dora dhe u shtri i vdekur përdhe. Askeri ju afrua, e pa të vdekur, i mori mauzerin dhe u zhduk.

E sot djemtë e atij rrethi shkojnë te vendi dhe thonë: «Këtu ra dëshmor Marko Mjeri.»

**PLAGËT E KURBETIT**

## CEKU I VONUAR

Në një kafene nga Zalli, rrrotull tryezës, ishin katër punëtorë. Këta bisedonin për qesatllékun, për shtrenjtësirën, për krizën e për të tjera duke i përshkruar me ngjyra të zeza, se kurrë nuk i kishin ngopur fëmijët me bukë. Ca prej tyre i kishin marrë vezët e ca po prisnin se mos nxirrin disa korona që t'i blinin për adetin. Në këto bisedime njëri tha:

— Shumë pashkë të keqe do të bëjmë sivjet. Lëri që fëmijët i kemi të zhveshur e të zbathur, po nuk kemi as bukë mjافت dhe as me se të burbuletemi.

— Siç po venë punët, — tha tjetri — çdo ditë po bëhet keq e më keq. Punë s'ka dhe as që duket të ketë. Shpresën e kishim varur tanë në behar se mos bëheshin ca shtëpi, po dhe kjo s'duket, se shteruan çeqet e Amerikës.

— Mund që të thahet lijeni i Sovjanit — tha i tretri. — Thonë se kjo punë do të ketë nevojë për shumë punëtorë. E, po të hapet kjo punë, do të mundim të hamë nga një copë bukë bashkë me fëmijët.

— Këto që të gjitha janë ëndrra — tha i fundit. — Kemi kaqë vjet që po na taksin dhe nuk na kanë bërë asgjë. A ka ndonjë punë të sallamtë, pa me të tilla jemi ngopur.

Folën dhe shumë e me trutë e tyre të papunuara gërmionin njérën punë pas tjetrës. Më në fund i katërti u tha:

— Që të gjitha këto janë keq e mos më keq, se si ne nuk ka asnjeri tjetër.

Fjalën ja preu i dyti duke i thënë:

— Mos u dëshpëro, se ka edhe më keq. Puna jonë është lule përpara kësaj. Do t'ju tregoj historinë e një plake, e cila sot ndodhet rrugëve. — Dhe filloj:

— Këtu e disa vjet, kjo plaka, për të cilën do t'ju flas, kishte djalin e saj, Taqin, që ishte djalë si drita, i mbarë, i urtë, punëtor dhe i bindur. Ky punonte kundraxhi, por nuk nxirrte mjaft sa t'u bënte ballë gjithë nevojave. Ky, kur shihte amerikanë, që ktheheshin prej kurbetit, ngjallte disa èndrra të bukura, të cilat ja ndiznin zemrën dhe e shtynin të vendoste për të shkuar në Amerikë. Paratë që nxirrte nuk i arrinin as për harxhet e ditës e jo t'i tepëronin për të mbledhur navllon<sup>1)</sup>. U mendua shumë kohë se me ç'mënyrë të gjente paratë e udhës. Më në fund qëndroi te shtëpia. Këta na kishin një shtëpi të mirë, të vetmen pasuri që u kishte mbetur nga i ati. Pasi u mendua dhe shumë ditë të tjera me ç'mënyrë t'ja thesh së ëmës, një ditë mori guxim dhe një të shtunë mbrëma i tha:

— Nëno, njeriu këtu nuk fiton dot para jo për të shtuar, po as për nevojat e rrojtjes. Kam shumë kohë që po mejtohem të shkoj në Amerikë. Sa keq që është të mos kesh nonjë njeri të afërm të të dërgojë navllon! Po, a e di se ç'mejtoj?

— E ç'mejton? — i tha e ëma tërë gaz.

— Mejtoj ta lëmë shtëpinë befa, të marrim para sa për navllon e për ca harxhe për ty. Unë, me të vajtur, të dërgoj çekun dhe i lan që të gjitha.

Plakës, me të dëgjuar këto, i erdhi keq; u turbullua, u helmua dhe u verdh... Ajo e dinte që djali i saj nuk kish ndonjë pasion të keq, e dinte që ishte punëtor i palodhur, po nuk e dinte se si e kish kësметin. Djali nuk i

---

1) Të hollat e nevojshme për biletën e udhëtitimit.

dinte këto, nuk e vinte re hidhërimin, që i hyri plakës në zemër, po parreshtur i thesh:

— E, nëno, pas tre muajsh, si të vete në Amerikë, të dërgoj çekun e parë për të larë befanë; pas tre muajsh të tjerë të dërgoj çekun e dytë për të meremetuar shtëpinë; pastaj të dërgoj të tretin për të shtuar malufatin. Gjithnjë do të të dërgoj. E pas pesë vjetësh, pasi ta bëj qesen kukurec, do të kthehem që të martohem. Po ti, nëno, kije ndër mend të më gjesh një nuse të mirë.

Folën dhe shumë, nënë e bir, duke kurdisur shumë ëndrra për të ardhmen, se ato nuk kushtojnë asgjë dhe vijnë vetë në trutë e njeriut kur ende nuk ka pjekur ndalime në jetë.

Më në fund u kandis plaka. U gjend fajdexhiu, i cili me njëmijë lutje dhe hatër miqësie pranoi t'u jepte pesëdhjetë napolona, duke e bërë shkresën e befasë për tetëdhjetë.

Pas ca ditësh u nis djali dhe shkoi për në Amerikë. Dhe që nga ajo ditë, o të dashur miq, kanë shkuar më shumë se pesë vjet. Plakës jo që nuk i është kthyer djali, po s'ka marrë as çekun e parë për të larë befanë. E akti i befasë është këmbyer nga mot se ka qënë nevoja të futeshe brenda dhe fajdeja. Dhe sot, pas pesë vjetësh, befa ja prej pesëdhjetë napolonash ka arritur katërqind e ca. Prej gruas e mësova se, sot, që është e enjte e madhe, ja sekuestruan shtëpinë dhe plakën e nxorën jashtë pa mbështetje e pa përkrahje. Nuk e di ku do ta futë kryet e shkëreta. Ajo pas hesapit që bënte me djalin, duhej ta kish pranë, ta kish vluar dhe të bënte pashkë të mirë e të lumbtur; po kësметi nuk ishte në një mendje me ta. A e shihni që paska dhe më keq se ne?

## VUAJTJET E KURBETIT

Raqi po bariste i menduar, që nga njëra anë e dhomës te tjetra, dhe shumë shpesh i dilnin nga goja disa fjalë pa kuptim. Ky ishte një djalë gjer më ndonja shtatëmbëdhjetë vjet, mjaft i gjatë pas vjetëve të tijë, i zeshkët, sylarush dhe qimezi. Kishte një vit e gjysmë që e kishte marrë i ati në kurbet me qëllim që ta futte në shkollë. Po, meqë Raqi, si djalë që ishte, xheku lozta me shokët, një ditë i ati ja përzuri mësuesin, që po e pregatitë për të dhënë provime në gjimnaz.

Që nga ajo ditë kishin shkuar shumë muaj. Raqi po-thuaj se u mësua në punë duke i ndihmuar të atit në dy-qan dhe s'e vriste fare mendjen për mësimë. Po një ditë, ky, vajti te sëndyku i vjetër që ishte plot me libra. Zuri të rrëmonte në të, dhe, duke shkuar nëpër duar njërin libër pas tjetrit, zuri një volum të vjetër me kapakë t<sub>w</sub>çjerrë dhe nisi ta këndonte. Dhe lexoi për një djalë, që nuk desh të mësonte dhe si nuk mund të gjente punë të mirë kur u rrit, po punonte qymyrxhi; si një djalë tjetër, që ishte i vëllai i tij, mësonte mirë dhe mbaroi shkollën i pari dhe si, me ndihmën e një mirëbërësi, mbaroi universitetin. Këtë libër e lexoi me një frymë duke ndenjur në anën e sëndukut. Kur u ngrit, ndjeu dhembje, po nuk i kujtonte se trutë e tij i kishte zaptuar dëshira për mësim, se përnjëherësh e krahasoi veten me djalin, që nuk mësoi. Gazi e la dhe u bë shumë i menduar, aq i menduar, sa shumë shpesh nuk shihte se ç'i ngjiste përpara syve.

Që nga kjo ditë kishte shkuar një javë dhe për këtë shkak ky po bariste i menduar. Ai mendoj për mësim, se dëshironte të bëhej njeri i ditur. Këto mendonte Raqi, po ca më shumë mendonte mënyrën se si t'i thoshte e ta kandiste të atin që ta përkrahte për të vazhduar mësimet. Shumë herë e gatitte frazën dhe i afrohej derës së odës së të atit, mirëpo përnjëherësh qëndronte, se i dridheshin mishrat dhe i mbahej goja. Prapë e preqatitte frazën, prapë bëhej gati dhe prapë kthehej. Më në fund morri kurajë, po, duke e përsëritur shumë herë frazën e preqatitur sikur thosh ndonjë mësim, dhe kur ish gati të vinte, i hynë këto mendime: «Po të mos dojë e të më shfryjtë? Po të më thérresë, ahere ç'të bëj»?

Në këto nuk gjente përgjegje dhe përnjëherësh e puhshtoi një e dredhur e fortë.

Raqi nuk kishte asnjeri të afërm, se të vetmit njerëz që pat i kishin vdekur. E ëma, të cilën kur e kujtonte, i pikonis lotët pa pushim, i kishte vdekur kur ai kishte qenë dhjetë vjeç dhe i kish vdekur prej oftike. I vëllai i kishte vdekur në kurbet nga tifoja. Buka nuk i shkonte, sado që nuk kishte ngrënë asgjë. I munduar prej mendimeve po bariste prapë nëpër odë duke pushtuar shumë shpesh kryet, duke kujtuar të ëmën e të vëllain, prej të cilëve sot do të mundte të shihë ndonjë dobi. Ora shkonte dhe nga oda tjetër kishte trokëllitur tri herë.

Raqi e kish vendosur dhe e kish menduar mënyrën si t'i theshte kur trokëlli dera e hyri i ati, që u drejtua nga korniza e me një zë të ashpër pyeti:

— Èshtë gati dreka?

Pas kësaj pyetjeje u dëgjua zëri «gati èshtë». I ati u drejtua në odën e gjumit, nxori pallton, pastaj hyri në sufrari dhe e pyeti Raqin që po rrinte i menduar:

— Pse nuk afrohesh, apo nuk të hahet?

— Jo, po... — dhe ju mbajt goja Raqit.

— C'ke, mos smund?

— Jo, po dua të të them nja dy fjalë — dhe prapë ju mbajt goja, u mbush me të qarë dhe me sytë e përlotur e pa të atin.

— E, thuaj se ç'ke të më thuash? — i tha i ati me zë të fortë.

— Dua të të them... që dua të mësoj... — mirëpo nuk e la i ati ta mbaronte, ja rrëmbeu fjalën, me zemërim e me zë të lartë i tha:

— Si the, more? Të mësosh? Dhe ajo na duhet tani, ja! Kur të thosha unë, ti bridhje e tashti dashke të mësosh. Tashti të mësosh si kofini pas të vjetit! — dhe e vështroi të birin me autoritet. Ky vështrim ja zhduku dhe ja çakërdisi mendimet e pregititura. Desh t'ja tregonte historinë që lexoi, po e harroi fare dhe jo që nuk dinte vazhdimin, po nuk dinte as si fillonte. Shumë herë e hapte gjënjë duke dashur t'i thoshte argumentat, duke dashur t'ja provonte me matematikë dobinë, që sjell mësimi, po nuk mundte, se nuk nxirrte asnjë fjalë.

Shkoi mjafth kohë në heshtje. Raqi e shihte të atin dhe me frikë e me lutje sikur desh t'i thoshte: «Në mos u bëfsha burrë e në mos fitofsha para, pa do të më shohësh se ç'kam pér të bërë!» Ose «Shumë të lutem, lëmë të mësoj, se, po të dal njeri i madh, dhe ty do të të nderoj!» Këtij pushimi i dha fund akçesha, e cila solli supën. Pastaj bai tha: — Léri tashi ato, hajde të hamë bukë!

Raqi u ul pranë tryezës, e thyente bukën, e futte kafshatën në gojë, gëlltitte supë, mbllaçitej duke menduar qëllimin e tij që dështoi.

\* \* \*

Kishte shkuar më shumë se një vit. Ishte ditë verë, nga ato ditë kur dhe më pesimisti ipohondriak gëzohej. Po Raqi jo që nuk u gëzua, po ra ca më shumë në mendime, ngaqë dëshira që i kishte mbirë tanë i kishte lëshuar rrënje. Vazhdonte të punonte në dyqanin e të atit, po me dëshirën e parë. Çdo ditë lexonte libra të shkrimitarëve të mëdhenj. Më shumë lexonte natën, se

ditën, kur e shihte i ati, i shfrynte me fjalë të ashpra. Shumë herë i kishte folur i ati dhe i kishte mposhtur përpëra myshterinje. Po Raqi kujtonte këshillat e filozofëve dhe heshtte. Po, sado që lexonte parreshtur dhe kish bërë një goxha bibliotekë prapë e kishte mendimin për të mësuar dhe po priste nonjë rast të mbarë. Po ky rast s'pritej të vinte. Dhe një ditë, kur po rrinte në dyqan e po lexonte një libër të rrallë, hyri postieri dhe i solli disa letra. Njëra i ishte drejtuar atij, ish me një pliko të gjatë dhe kishte stampa të Amerikës. Raqi u çudit. I ati nuk ishte në dyqan. Raqi, sado që nuk e dinte se nga kush ishte, u gëzua shumë dhe përnjëherësh e grisi zarfin dhe zuri ta lexonte. Në këtë kohë u hap dera dhe hyri i ati, i cili u afrua nga tezga i furosur. Raqi e zhubbaviti përnjëherësh letrën dhe e futi fshehumës në xhep. se e dinte shumë mirë që i ati do ta shante e do t'ja griste. Si ndenji pak, ngaqë kishte kureshtje të madhe, doli jashtë që ta lexonte. Po, pa mbaruar as dy sërë, e ktheu nga ana tjatër që të shihte 'nënshtirimin, po ai ish shkruar aqë shpejt, sa nuk shquhej fare. Dhe, për ta shuar kureshtjen, filloi ta lexonte:

«I dashur mik,

Ka shkuar shumë kohë që nga ditë që u ndamë! Vërtet, ja, po mbarohen tre vjet. Në tërë këtë kohë nuk dinim për njëri-tjetrin; ti shkove më parë kur të shkruante yt atë dhe, siç më theshe, besoj se mëson! Sa i lumbtur që je, o i dashur Raqi! Unë disa muaj pas teje shkova për në Amerikë, se ma dërgoi navllon im vëlla. A e mban mend me sa durim që i prisja të shkretat! Tani pas kaq kohe po të shkruaj, se ty të kam pasur të vetmin shok të besës, po, ca më shumë, se ti, që ahene, kishe ato mejtime, që m'u futën edhe mua sot në kokë. Po, ti kishe mejtime të mësosh dhe besoj të jesh në rreshtat e fundit. Vërtet, Raqi, je i lumbtur, se yt atë përkujdeset për ty...

Nuk mundi ta vazhdonte letrën, se e pushtuan mësimet dhe ju kujtua koha e foshnjërisë, shokët, lodrat, shkolla, mësuesit, librat, fjalët që ishin në letër e që i kishte harruar edhe ai vetë. Përnjëherësh i dhembti zem-

ra, i pikuan lotöt dhe më në fund kuptoi zilinë e mikut, i cili pandehte se mos ishte në rreshtin e fundit. Pësherëtiu disa herë, i fshiu sytë dhe desh ta vazhdonte letrën, po u dëgjua një zë si prej të marri, që e thërriste:

— Ku u trepetase, more përtac! Hajde këtu, se kemi punë!

Raqi, me ta dëgjuar këtë zë, përnjëherësh e palosi letrën dhe kryeunjur si fajtor hyri në dyqan duke parë të atin me frikë dhe duke pritur ta shante. Nuk priti shumë, se ai, me ta parë Raqin, shtrëngoi grushtet, zgurdulloi sytë dhe i tha me zemërim:

— Nga vete ti, more? Apo, një e dy dhe jashtë; ç'është kjo me ty? Për të bredhur kemi ardhur këtu në kurbet, apo pér të fituar?

— Kisha nevojë; pa dola — ju përgjegj Raqi me të drojtur e me zë të ulët, si prej skllavi.

— Njëqind herë në ditë ke nevojë? Ja, kjo është e dhjeta herë sot.

Me të tilla qërtime dhe më të këqija i ngryste ditët Raqi. Atij sot më s'i rrihej në dyqan: mënjanë shtyhej prej kureshtjes që ta lexonte letrën e më anë tjetër mendonte qërtimet e të atit. Dhe kështu u ngrys e erdhi koha që ta mbyllnin dyqanin dhe Raqi ende nuk e kish mbaruar së lexuari letrën. Shumë herë hapte librin duke dashur ta vinte letrën brenda e ta lexonte po atë ditë i ati ishte shumë më i zemëruar se ditët e tjera. Me ta parë që e hapte librin, i thërriste: «Lëri ato budallallëqe. se nuk na japid bukë. E, po ta hapësh dhe një herë, do të ta djeg». Kur e mbylliën dyqanin, shkuan në odë pér të fjetur. Raqit nuk i flíhej, se desh të lexonte letrën, po jo në sytë e të atit. se ai pa dyshim do t'ja griste. U mendua shumë. Pastaj doli në oborr duke marrë me vete një qiri dhe ca shkrepса dhe, si u vendos, zuri ta lexonte letrën që në krye se nuk e mbante mend ku e la.

I dashur mik,

...po, përkujdeset, se ti shumë shpesh më theshe që do të të vërë në shkollë dhe do të të lërë të mësosh ç'të duash. Tani mëso dhe pér mua! Kur arrita në Amerikë, hyra në një fabrikë të pambukut. Po unë e harroj që ti aty je si bej te yt atë e të them kujto punën! Ku do të mundësh ti të gjykosh ç'domethënë punë? Ku e di ti se ç'domethënë të dërsish? Oh, i dashur mik, punojmë që më shtatë të mëngjezit e gjer më dymbëdhjetë, dhe që më një gjer më gjashtë, dhjetë orë parreshtur në një atmosferë prej 25 gradësh të nxehjtë, saqë as djalli nuk duron dot. Shumë pleq, që kemi këtu, na thonë se dhe në skëterrë nuk është kaq nxehjtë. Tani kuptoje se sa dërsijmë. Dita me ditën, të mbytur në djersë, kthehemë nëpër konakët ku duhet të lajmë pjatat, lugët, pirunjtë, thikën që kemi të vetëm dhe me të presim bukën, mishin, dhe shumë prej shokëve tanë presin dhe ndonjë copë shollë të këpucëve ose ndonjë tjetër kur i arnojnë. Kështu më shkoi koha gjer këtu e dy muaj. Tashti më s'jam në atë fabrikë. Një ditë, kur po punonja duke plevatur në djersë në një atmosferë të nxehjtë duke futur pambukun në qynqjet nga ku dilte tërkuzë, nga ana tjetër ku ishin ca maqina me dhëmbë që e krehnin pambukun, u dëgjua një zë që ta skërfitte zemrën. Përnjëherësh ktheva sytë dhe pashë se maqina i kishte pushtuar dorën një shqiptari dhe, pothuajse, ja kishte futur gjer në bërryl. Ai po thërriste. Pas kësaj të thirrure e lashë punën dhe u sula të kërkova bosin. U ngjita lart, zbrita poshtë, prapë u ngjita, po nuk e gjeta asgjékundi. Në katin e sipërm ishin veglat, që bënin pëlhurë ku punonin vajza. Rendja si i lënë dhe thërrisja si i marrë, po, në zërin tim nuk më përgjegjej asnjeri, se s'e linte shamata e veglave. Duke rendur kështu, e pashë bossin, që po fjalosej me një vajzë miaft të bukur, leshgështenjë, meshollë, hundëqiqër dhe gojëvogël. Desha t'i thesha që ta mbante maqinën e ta shpëtonim njeriun. Përnjëherësh ja mbështeta dorën e djathtë mbi supin e trashë dhe, duke përdorur të gjitha fjalët që dija, i thashë:

— Mister, Fallas, Mashina, Gohom — dhe, duke bë-rë më duar, i dëfteja se po kollofitë maqina të ziun njeri. Bossi më pa me çudi, si dukej nuk merrte vesh anglisht; e unë i thashë prapë:

— Mister, Koman, Fallas, Mashina, Go-kom. tubet for, fallas. Mister tumaç plis.

E ai, kur unë i flisja, hapte duart, më shihte me çudi, se ç'i thesh vajzës me zë të lartë dhe me zë të fortë më pyeti:

— Uat? Ç'thua, more, s'të kuptoj. — Po unë nuk e kuptova ç'më thesh dhe, ngaqë desha ta shpëtoja të ziun, e zura pas çipit të setrës dhe e hoqa poshtë. Ai thërriste, po unë nuk e dëgjoja dhe vazhdoja ta hiqja, gjersa e shpura në katin e dytë dhe e drejtova tek ajo maqina, që kishte kollofitur shqiptarin e shkretë. Po, o tmerr! Kur hodha sytë, e pashë që i varfëri shqipo ishte bërë petull, i qenë thyer kockat dhe e kishin nxjerrë të vdekur.

Pas kësaj ngjarjeje e lashë punën dhe vajta në Malbona ku është një kushëriri im. Tashti punoj në fabrikën e këpucëve. Po, se pér pak harrova; që nga ajo ditë m'u kujtovë dhe e vura ndër mend, ta mësoj anglishten. Se, sado që kam aq kohë, nuk dija as aqë sa të shpëtoja njeriun. Që sot fillova të shkoj në shkollën e natës.

Nuk kam ç'të shkruaj tjetër gjë. Pres përgjegjen tën-de dhe të lutem të jetë e shpejtë dhe e plotë. Të më shkruash pér të gjitha. Ja tek e ke dhe drejtimin tim: Shore Maro P.O. Box Nr. 25, Malbora, u.s.a.

Me dashuri miqësore Shore Maro.

P.S.H. Pa dyshim do të çuditesh ku e gjeta drejtimin tënd. Që të ta shuaj kureshtin, po të shkruaj: Këto ditë erdhi prej vilajetit kushtrimi yt Gaqo Maro. Kur e pyesta pér ty, ai ma dha drejtimin.

## M A L L E K I M I

Ish dimër. Disa miq po rrinin pranë zjarrit, rreth e rrrotull vatrës, duke pirë verë e duke ngrënë gështenja të pjekura. Plaku i shtëpisë, me vetullat e dëndura e të thinjura, i ati i Mitit, apo mbaroi së treguari ca kujtime të djalërisë së tij. Në këtë kohë, Stefani, që ish një burri i kërrusur nga mosha, me kupën në dorë e duke u mbllaçitur, tha:

— Do t'ju tregoj për disa gjëra që kanë ngjarë këtu e shumë vjet: këto janë edhe të gjalla në zëmrën time. Unë, ahere, isha trembëdhjetë vjeç djalë. Im atë kish dy vjet që më kish vdekur. Kish shumë vjet në kurbet saqë unë, as që e mbaj mend mirë. E sjell ndër mend vetëm kur më kujtohet ajo dita që shkoi për në kurbet, për hënë e fundit, se më dha pesë grosh dhe më tha: «Hapi sytë, ta dëgjosh nënën e të mësosh në shkollë!»

Ne, ahere, rronim në Drenovë dhe kishim mësonjës një çalaman, e kurrrizdalë. Ngaherë, kur na e kthente kurrrizin, që të dilte nga dera ose të shkruante gjë në dërrassën e zezë, qeshnim me shëmtimet e tij dhe shumë shpesh i nxirrnim dhe gjuhën. . . Në këtë kohë na pushtoi vobekësia. Nëna hoqi një sëmundje të madhe. Pastaj, se ku na u gjend dhe një gjyshe, e cila u çkarkua në shtëpinë tonë. Ishim tre veta që deshnim të hanim. Unë edhe nuk e kisha kuptuar ç'domethënë nevojë se, sa herë që më hahej, kërkonja dhe kurrrë nuk e dëgjonja fjalën «s'kam», po, nga-

herë, më ipte nëna një copë bukë me një copë djathë. E unë e merrnja dhe dilnja jashtë, e hanja mengadalë se, shumë shpesh, kérkonja bukë jo se më hahej, po ngaqë nuk kisha ç'të bënja. Shumë shpesh merrnja tulin e bukës, e dërmonja bashkë me djathin dhe e bënja si top në çipin e këmishës. Herë e haja, po më shumë ua hidhnja pulave ose rabeckave se mblidheshin mi ferrat që ishin jashtë shtëpisë. Dhe kështu më dukej se mos kjo botë ish krijuar për mua. Ngaherë bridhnja më të katër anët e fshatit... Vallë ku e ku nuk vinja bashkë me shokët e mi prej të cilëve sot nuk ka mbetur as ndonjë i gjallë.

Posi sot e mbaj mënd, zotërinj, atë ditë kur i vajta nënës e i kérkova të më blinte opinga prej telatini e me xhufka, se të atilla kish fqinji ynë, i biri i plakut të fshatit. Për herën e parë ma prishi im më, po jo me të keq. Më kujtohen lotët që ja kishin mbushur sytë e saj të kaltër... Ajo më qetonte me sy e më thesh: «Mos kérko gjëra që s'bëhen dot!» Po unë nuk kuptionja asgjë nga vështrimi i saj. Pak më vonë e përsërita kérkimin tim duke përpjekur këmbët, duke thirrur e duke shtrembëruar buzët: «Dua, moj, dua opinga!» dhe ja thirra të qarit. Nëna e gjorë më qetoj me fjalë të buta, duke m'i ngrohur faqet me buzët e saj. Kur i ngrita sytë e përlotur, se sjellja e sim mëje ma dëboi norpranësinë, e pashë dhe më erdhi keq; për të. Im më më pushtoi në krahët e saj dhe më tha:

— Ja, u bënë dy vjet që vdiq yt atë; tani s'ka kush të na dërgojë para. Unë s'kam... se s'më mbeti asgjë.

Gjer më ahene as që e vinja re dhe as që e vrisnja mëndjen që çdo javë kur çdukej pula, kur këndezi, kur lopa, kur kali, kur kau, kur viçi... Fjala e sim mëje m'i shtroi këto pyetje dhe përpara syve të mi qëndroi gjendja e shtëpisë sonë. Pa i thënë as gjysmë fjalë nënës, u ngrita dhe, pasi fshiva sytë me shaminë e madhe që e mbanja lidhur në brez, dolla jashtë i mbushur me mejtime. Tani nuk mejtonja për opinga, po desha të merrja kurbetin, se e kuptova që kishim mbetur të varfër... Në fshat kish ardhur prej kurbeti djali i plakut të fshatit, te i cili vajta dhe fola për punën e kurbetit e i kérkova mej-

tim. Puna pothuajse u mbarua. E binda dhe nënën se ajo nuk desh të më linte. Unë e pandenja se mos Vllahia ishte gjer në Korçë, prandaj dhe nuk e vrava mëndjen për para. E, kur i biri i plakut të fshatit ish gati për t'u nisur, më pyeti:

- E, more, a u bëre gati?
- Po ç'gatira të bëj? — ju përgjegja unë.
- Po paratë e udhës a i ke? — më tha ai.
- Pse duhen shumë a? — i thashë unë.
- Po ndonja katër napolona do të duhen — më tha.

E kisha kuptimin e parave; e dinja ç'domethënë çereke, mexhite, po nuk e dinja ç'domethënë napolona.

E kur i thashë si me të drojtur nënës për paratë e udhës, ajo mënt qau, po i kish bërë gati, se kish thirrur fqinjët, e njërit i shiti kazanin e rakisë për dy napolona, tjatrit lopën prej 150 grosh dhe të tretit cjanin për 50 grosh. Kështu m'i bëri paratë e udhës, të cilat s'm'i dha mua, po djalit të plakut të fshatit... Më në fund arriu dhe dita. Im' më më vuri në një baulle të vjetër, po të shëndoshë që ish prej njeriu që pëlqen plaçkë të vyer, të gjitha gjérat e nevojshme... Mund t'ju betohem, zotërinj, se, që nga ajo ditë e gjer më sot, kanë shkuar shumë — shumë vjet. Para se të ikja, brodha më të katër anët e fshatit; u ngjita në majën e malit... vajta në Shën-Kostandin, ku u fala dhe ju luta zotit të më nxirrte faqebardhë... Kur u kthyesh në shtëpi, dielli kish perënduar dhe bagëtia ishin kthyer prej kullotës. Hyra në katura, ku pasqë vetëm dy dhen e një dhi. Përnjëherë e solla ndër mënd kohën pa vdekur im atë, kur kishjm shumë dhen e dhi, tri lopë, një, me nder jush, gomar... e një kalë... E tani s'na kish mbetur asgjë. Nuk do t'iu tregoj se si më përcuall, se cilido prej jush s'besoj të mos e ketë ngrënë kurbetin. U nisëm me qeraxhini dhe pas njëzet ditësh ardhëm në Bukuresht... Djali i plakut të fshatit ish cirak në një kërçmë<sup>1)</sup>, ku më futi dhe mua... Atje

---

1) Kërçmë-a — pijetore.

punova tre vjet me radhë... po ç't'ju them: kishim aqë punë, sa nuk kishim nge të hanim bukë, po dhe atë e kishim me masë se, siç duket, ustai de të kishte haber nga dituria e shëndetësisë dhe na e kontrollonte bukën që të mos na binte rëndë. Megjithatë, s'mund të qahem: më paguante 120 franga në mot e nga këto të zbriste 60 franga për kupa, pjata e të tjera që thyenja. Paratë, nga mot, ja dërgonja nënës, se për vete nuk kisha nevojë pér asgjë: të gjitha m'i bënte im zot. Një palë këpucë të rënda e të trasha, një palë rroba pa xhep dhe dy këmishë prej ushtari. Dhe, duke punuar nga 19-20 orë ditën, shkuan të tre vjetët. Ngahera e kujtonja nënë dhe nga mot i dërgonja para si dhe letra shumë shpesh... Kur u mbaruan të tre vjetët, do të mund të them se vllaçen e dinja shumë mirë dhe, ngaqë shokët e mi merrnin më shumë rrrogë, një ditë i thashë ustait që të ma shtonte. Po ai m'u përgjegj me grushte në kurriz e më shumë të shara që nuk i zë kalemi. Dhe kështu e lashë punën e me pesë franga në xhep, që kisha mbledhur prej bakshisheve, zura t'i numëroj soka-kët e Bukureshtit. Një ditë, kur s'më kish mbetur asnëjë pesësh, më doli një punë më e mirë nga e para. E quajta veten të lumtur dhe fillova nga puna me zell. Nënën nuk e harronja; i dërgoja ngahera dhe, ngaqë e kisha rrögën më të mirë, i dërgonja çdo muaj nga dhjetë franga. Kish-te shkuar mjaft kohë kur më pushtoi një lakmim pér paranë: nisa të kursenja dhe për nënën. I kisha harruar që të gjitha të shtëpisë dhe as nëna me lottë e saj, as lumi i fshatit, as malin, as koha e foshnjërisë e as katoi nuk pëma largonin maninë që kisha për paranë. U kisha zili të pasurve, dhe desha, medoemos, të bëhesha i pasur.

Kishin shkuar dhe disa vjet. Në këtë kohë munda të vë mënjanë njëmijë franga. Isha mjaft i shkathtë, e dinja ku dilte bakshishi, se e kisha kuptuar të fshehtën e mjeshtërisë. Në këtë kohë e lashë punën dhe hapa në vete një kërcmë të vogël. Puna më vajti mbarë. Që nga dita që u bësh usta, nuk mejtonja asgjë tjetër, po vetëm: para, para. Vjetët shkonin e unë dita-ditës ngrimesha si nga paratë, ashtu dhe nga nderi, se këto të dyja janë lidhur

shumë pisk në mes tyre. Në bangë kisha me mijëra franga, kisha shumë para në befara<sup>1)</sup> e me fajde; kisha pesë fabrika të alkoolit; kisha sjellë nga Korça e nga fshati djem me duzina, që i paguaja nga pesë franga në muaj e që u bënja rroba pa xhepa, se e kisha kuptuar «përsenë». I mundonja, ua zbrisnja jo vetëm gjysmën e rrogës, po të tërë dhe, më në fund, po të më kundërshtohej ndonjë si më i squar, e hidhja jashtë të çveshur e pa pesësh në xhep...

Dhe kështu u bësh milionar... Tani, ata që nuk më flisnin me gojë, kërkonin të më bënin dhëndërr dhe më bënnë. Besoj ta dini. Mora të bijën e Rapi Mburos... Më dha 200.000 franga prikë, se paraja e merr paranë. Puna sa vinte më shtohej. Me gruan rronim të lumtur dhe na dha zoti një vajzë e një djalë. Plakën e kujtova vetëm pas gjashtë vjetsh; në letrat e mia nuk më përgjigjej asnjëri. Më në fund i shkrova priftit, që m'u përgjegj se im më kish katër vjet që kish vdekur. Nuk e vrava dhe shumë mëndjen se tani kisha të tjerë të dashur; përveç parave desha gruan, po ca më shumë fëmijën. Para kisha shumë, po kurseja ca më shumë dhe tani e kuptoj se paraja qënka po si ujët e kripur, prej të cilit sa më shumë të pish, aqë më shumë të shtohet etja. Po, në këtë botë, asgjë nuk mbetet pa ndryshime; m'u sëmur djali prej ethesh, pastaj prej tifoje, dhe, sado që rrëth e rrrotull tij bëra fortesa prej floriri, prapë nuk e shpëtova dot nga kosa e vdekjes... E desha pa masë... Po shkoi dhe kjo. Pas kësaj plage, në një behar, m'u mbyt vajza kur lahej në Tunë. Që të mos e zgjat, pas ca vjetësh puna m'u shtua ca më shumë. Ime shoqe, nga meraku që humbi fëmijën, u sëmur dhe ju çpif oftikë. U mundua, u dergj shumë e më në fund vdiq. Kishin shkuar dhe shumë vjet. M'u duk sikur u qetuash: vallë ç'gjë nuk harron njeriu i mjerë? Punërat i kisha shittur dhe rronja i çkujdesur me disa milionë kapital duke u zhgrryer nëpër qarqet e qejfit. Edhe isha i ri, mund të them, isha edhe dhëndërr, se nuk i kisha mbushur të pe-

---

1) në befara — hua me hipotekë.

sëdhjeta. Kisha shumë propozime për martesë. Po unë as që i shkoja ndër mend këto propozime, se e kuptoja që një mallëkim i bashkuar me një uratë më ndiqte pas, pa mos më lënë vetëm asnjë minutë. E kuptova se këto ishin të nënës. Urata m'u dha kur ajo shiti kazanin e rakisë, lopën, cjanin, kur m'i dha të katër napolonat duke më puthur, duke më thënë: «Hapi sytë!» Sytë i hapa, u bëra i zoti, fitova shumë para, po nuk i hapa dot sytë që të mos harrojnë nënën, e cila shkoi jetën në nevojë dhe fundin e saj në uri... Shkuan dhe shumë vjet që i kalova duke shetitur botën. Vallë ku s'vajta? Në Paris, në Romë, në Milano, në Lago Mazhore, në Londër, në Berlin, në Svicë, dhe në Monte-Karlo ku, unë desha t'i hidhja mbi një kartë të gjitha paratë që kisha fituar. Po, për të fituar para, kisha uratën e nënës dhe ngahera fitonja, po nuk gjenja qetësinë e prehjen e shpirtit. Bukuritë e Parosit, operat e rralla, romansat e pëlqyera, orkestrat melodike, shantanët pa cenzurë dhe gjithë zbavitjet, ku tymosen të pasuritë e dheut, më dukeshin të mërzitshme. Asgjekundi nuk më rrihej dhe vinja, si nonjë kurbat, që nga njëri qytet te tjetri. Ky ish mallëkimi i nënës që ma dërgoi që nga fshati në orën e vdekjes, kur nuk kish ç'të hante; kur nuk kish se kush t'ja shuanë etjen. Më në fund, pasi u mejtuash, e gjeta për të mirë dhe erdha këtu ku jam, pranë fshatit; pranë vëndit ku çlodhen eshrat e asaj që më dha uratën, kur më nisi pér në kurbet, po të cilën unë e harrova. E ajo nga vuajtjet e pësimet që hoqi, në orën e fundit, mië dërgoi mallëkimin. Mos pandehni se nuk kam vajtur në fshat. U poqa me priftin, e pyeta, e kërkova varrin e saj, po nuk e di asnjeri. Dhe prifti nuk është i pari. Koha i ka ndryshuar që të gjitha.

Me të mbaruar tregimin, Stefani rrëmbeu pallton, shkopin dhe shkoi. Miqtë ja thirrë këngës dhe pinë verë, se ky tregim i futi në mbretërinë e pikëllimit.

Odesë, 1912

## DJALI DHE BABAI

2

Koci, u kthye nga gjimnazi dhe hyri në dyqan të të atit. Atje ishin mbledhur disa zotërinj që po bisedonin për politikë duke shfaqur mendime të kundërta për çlirimin e Shqipërisë. Kocit nuk ju mbajt, po mori pjesë në bisedime dhe me argumenta të fortë, ua rrëzoi mendimet biseduesve. Pas kësaj që të gjithë e lanë dyqanin dhe mbeti vetëm Koci me të atin. I ati u zemërua pa masë për sjelljen e djalit dhe i tha me zë të fortë:

— Unë po të vesh, po të mbath, po të ushqej e po të mësoj e ti kërkon të më urdhërosh t'u bindem mejtimeve të tua. Jo, kurrë nuk do të heq dorë nga mejtimet e mia dhe nuk do ta shpie veten, gjer në atë pikë, sa të më urdhërojë djali.

— Po kjo është një marrëzi! — i tha i biri.

— Si the, more! Marrëzi! Shko, more, më paske ardhur si ndonjë bumbashir dhe po përpjek këmbët që të heq dorë nga mejtimet e mia... Nuk më qérrohesh që këtu!

Koci, duke parë që i ati, në vend që ta kuptonte të vërtetën, po egërsohej më shumë, u ngrit dhe, pa i thënë as gjysmë fjale, doli nga dyqani.

\* \* \*

Kur hyri në odën e tij, Koci ra në mendime të thella. Pas grindjes që pat desh ta linte shtëpinë e t'et dhe, pasi

u mendua dhe pak, e vendosi. Bëri gati plaçkat dhe shkoi, pa i thënë të atit as gjysmë fjale. I la një letër, me anën e së cilës njoffonte shkakun e ikjes. Kur kali e hoqi arabanë, 1) hodhi sytë nga shtëpia dhe ju mbushën sytë me lot, se kujtoi gjykimin e marrë të të atit dhe pëlqimin e tij: të mbetej pa djalë, po me ndjenjën e kalbur.

Koci, me anën e miqvet, gjeti ca mësimë private me një pagë të mirë. E mbaroi gjimnazin dhe hyri në universitet, të cilin e mbaroi me nishan të artë. Pas kësaj hyri profesor në një gjimnaz të vendit.

I ati i Kocit kurrë nuk pyeti për të birin dhe, sado që me zemër e donte, nuk u mejtua ndonjëherë ta ndreqte fajin, ta linte idenë e marrë e të bashkohej me të birin.

\* \* \*

Koha shkonte me shpejtësinë e ujit. Kishin shkuar më shumë se dhjetë vjet që nga dita që ishin ndarë. Koci rronte më vete. Që prej tre vjetësh ishte martuar me një vajzë shqiptare dhe kishte një djalë si drita. Dhe, meqë kjo botë është si rrota dhe vërtitet, i ati i Kocit, me mendimet e tij dhe me miqtë që kishte e që ja hëngrenë tërë pasurinë, kishte mbetur pa gjë. Në këtë gjendje miqtë e lanë vetëm. Koci nuk dinte gjë për këtë punë. Për të atin ca i thoshin se kishte shkuar në atdhe, ca të tjerë se e kishte shitur mallin dhe kishte vajtur në një qytet tjeter. Një ditë, kur ishte i ngeshëm dhe po shëtiste nëpër udhët e bukura të qytetit, e pa të atin të zhveshur, të zbatthur dhe të uritur. E kishin lënë miqtë. Plaku e dinte që i biri ishte mirë, po nuk donte të përulej. Ai e kishte kuptuar gabimin dhe shpesh thoshte me vete: «Nuk e meritoj të jem babai i Kocit». Dhe s'priste ndihmë nga asnjëri. Koci, me ta parë të atin, ju afroa përnjëherësh, e pushtoi për qa-

---

1) karrocë.

fe i foli me fjalë të ëmbla. Nuk i duroi dot vuajtjet të hiqte i ati, po e hipi në një araba. Nga të pangrënët e gjatë. Me të arritur në shtëpi, babait i ra alivan. Koci përnjëherësh thirri shéronjésin, i cili mezi e solli në vete. Kur Koci e pyeti, se nga se i kishte ardhur e gjithë kjo, ai i tha:

— Nga të pangrënët. I janë tharë zorrët.

Kur erdhi në vete, baba i vështroi rrëth e rrotull, tërë çudi dhe i tha djalit: — Vërtet, ke pasur të drejtë përsa më the atë ditë. Ti u dëfteve zemërgjerë dhe shpirtmadh. Po të isha unë, në vendin tënd, dhe të më kishin dëbuar nga streha prindërore pér idenë kombëtare, kurrë nuk do të kisha mëshirë. Më ndje pér sa të bëra. Ndjenja shqiptare qenka e vërtetë dhe e shenjtë, se ajo predikuaka dashurinë e jo urrejtjen. Dhëntë zoti e përparoftë kjo ndjenjë e shenjtë shqiptare, që sot po më shtie ballsan mbi zemrën time të plagosur e të dërmuar. Ajo po m'i shëron plagët e trupit dhe të shpirtit. Sot ajo po më jep prehje, shpresë dhe po më bashkon me djalin tim, me gjakun tim.

Pas këtyre fjalëve vështroi edhe njëherë rrëth e rrotull, desh ta pyeste të birin si e kishte shkuar kohën e ndarjes, po e kuptoi që nuk kishte të drejtë ta pyeste. U ngrit më këmbë, e pushtoi të birin, pshëretiu, hapi gojën dhe i doli shpirti.

## MIRËMËNGJEZ ME INTERES

Ish vjeshtë. Koha edhe nuk ish aq e mërzitur se era kish disa ditë që kish pushuar. Deti ish i qetë... qelli i kthjellët dhe, në atmosferën e natës, ndihej një e ftohtë e hollë që t'i thante duart.

Ora kish vajtur më shumë se dhjetë. Po rrnim të çkujdesur dhe po trazonim fletët e politikës, gjithsecili, me duart e lara ose të palara, duke bërë planin e mbarimit të luftës.

Në këtë hop njëri prej miqve na tha:

— Shiko, sa botë e keqe! Tërë bota përpinqet dhe rreh për paranë! Janë gati të gënjejnë... të bëjnë lajka, të therin, të vrasin, të bëjnë qindra poshtërsira vetëm për të nxjerrë paranë, prej së cilës kanë lindur zënkat, luftërat, armiqtë e gjithë të këqijat e kësaj bote.

— Nuk ka as ndonjë dyshim — tha i dyti — se lidhja dhe zgjidhja e kësaj jete qëndrojnë te paraja. Nuk dua t'ju kujtoj Judhën dhe Efialtët, se këto janë gjëra të vjetra e mund të thoni që u ndryshua njerëzia, po do t'ju sjell si shembëll luftën e sotme.

— Kjo gjë është shumë e rëndë për mendjet tonë — tha i treti. — Këto çështje le t'i zgjidhin njerëzit e mëdhenj. Unë megjithë budallallëkun tím ju them këshfu: Ke në xhep? Ke miq, ke soj, ke dhe njerëz që të të falen

ë të të nderojnë. Nuk të ka xhepi? Të gjithë të bëhen të huaj.

— Jo, nuk është ashtu, — tha i pari — se ka njerëz që të duan dhe pa interes, sado që këta janë shumë të pak-të. Do t'ju sjell një shembell: Kur mbeta pa punë, Zigoja sapo më poqi, më mori në shtëpinë e vet, më dha të ha e të pi, më dha disa mijë franga për të bërë nonjë punë, kurse miqtë e të njojurit bënин sikur s'më njihni.

— Që kur e kishe të njojur? — e pyeti i dyti.

— Që kur ish nxënës. I ndihnya ngahera, kur me pësë e kur me dhjetë franga. Më vinte në dyqan dhe e ndjen-te veten si në shtëpinë e tij. E kam dashur si vëlla.

— Tani po e kuptoj se ç'gjë e bëri të të kujtojë. Tek ai dhe në mos ish interes, ish detyra e shpërbimit të së mirës që i kishe bërë. Ne këtu bisedojmë e kërkojmë një «mirëmëngjez pa interes».

— Të tillë njerëz nuk ka në shekullin tonë — tha i treti. Tani padashur m'u kujtuan fjalët e një plaku që i tha kur i kërkuan para hua: «Jo, unë s'kam as soj e as fis. Ja tek është nëna ime!» dhe goditi njërin xhep. «Ja tek është im atë», dhe goditi tjatrin xhep. «Ja tek është soji e fis», dhe goditi tjetrit xhep.

— Po pse largohemi, — tha i pari — fjala shqipe thotë: «Miq për fiq». Më mirë dëgjoni t'ju tregoj se ç'kam pësuar këtu e mjaft vjet. Tamam ahere isha djalë i ri plot shpresë dhe i fryrë me patriotizëm të jashtëm, ku hyjnë zëra të larta e asnjë çikë punë. Gjer më atë kohë kisha shkelur në disa shtete duke kërkuar fatin. Po më kot... se, që ta gjesh fatin, duhet të kesh energji: Ajo mua më mungonte. Dhe kështu, me ca para të paka që munda të gjej, i hipë vaporit dhe u shkarkuash në Stamboll ku pandehnja se, me të më parë, do të më rrëmbenin. Program «ç'do të bëj në Stamboll» nuk kisha shtruar dhe as q'e kisha vrarë ndonjëherë mendjen se duhet të kesh program. Edhe isha i ri, isha, si thonë pleqtë, nga ata që pandehin se «çdo gjë që fluturon hahet». Kur zbrita në Stamboll, qëndrova në hotel; atje, pasi u mejtuash pak, vendosa të bëhem bashkëpunëtor i gazetës «Besa». E

pandehnja veten zheni dhe isha i sigurt që do të më rrëmbenin. Me shumë mundime e gjeta zyrën e gazetës. Me të hyrë brenda, më dolli një djalë i vogël, i bukur, shumë i shkathët po, për fat të keq nuk dinte shqip. Pandeha se mos kisha bërë gabim. Po na, më dolli një burrë i veshur shumë ligsht, i parrojtur e i palarë, që më foli me një shqipe të bukur. Që të mos zgjatem, nga ai e kup-tova që nuk kish shpresa. Paratë m'u mbaruan. Kisha dy ditë pa e vënë erën e bukës në gojë. Pasi e vrava shumë mendjen, shita sahatin e florinjtë, pagova borxhet dhe, me kusurin që më mbeti, vendosa të kthehem në atdhe. Prapë pa ndonjë qëllim e pa ndonjë program u nisa, se më shtynte, siç ju thashë, patriotizmi i marrë e i jash-tëm që ish me zë të fortë për bujë e jo për punë. Dhe vajta në shtëpi... më priten si jo më mirë... më puthën me mall dhe ishin shumë të gëzuar që më panë. Po, kur çkar-konin plaçkat dhe e vunë re që kisha vetëm një baulle të vogël, e pashë që ju pakësua gazi. E unë u kthyesh zotni me 22 grosh në xhep. Këpucët i kisha të grisura dhe kishin nevojë për gjysma. U vura gjysma këpucëve, vura festën në kallëp, hekuropa rrobat dhe dolla në treg për të shëtitur. Kisha mjaft që s'kisha qënë në atdhe, I kisha harruar pagoditjet e jetës, se u dhashë i téri në kujtimet e foshnjërisë, me të cilat ishte lidhur ky qytet. E kisha të humbur... shëtitnja si i lënë dhe, duke shkuar si automat, një zë që më thërriste me emër, m'i largoi që të gjitha.

— Mirë se ardhe bre, Kostë — dhe një djalë në vërsën time më përqafoi vëllazërisht.

Nuk e njoha. Duke e parë, në sy m'u kujtua që ish një bashkënxënësi im. E njoha, ish Jorgua i Petit.

— Eja, eja, more, në dyqan — vazhdoi miku dhe më hoqi në dyqan. — Po si je, si ke shkuar? Sa kohë që s'jemi parë?.. Qënke bërë burrë, more?! Për të martuar ke ardhur? Pa na thuaj ndonjë të re që andej. Sa të lumtur që jeni ju të kurbetit! Ja, ne këtu, po kalbemi me këto... — dhe më dëfteu çipat e dollomasë që i kish të lyera me

vaj duke i hedhur sytë mbi pantallonat e mia të heku-  
rosura.

Më gostiti me gjithë të mirat: me konjak, me meze,  
me kafe e me shumë të tjera. Kur ngjitesha për në shtë-  
pi, çuditesha me sjelljen e Jorgos, se nuk e kisha nga  
shokët e mirë. Vallë pse më priti kaq mirë? Ahere thashë  
pushtuar prej këtij mejtimi ja tregova që të gjitha nënës.  
E ajo i dëgjoi me kujdes, e shpuri buzën në gaz, dhe më  
tha:

— Cili, biro? Jorgua i Petit? Po unë atje marr vere-  
sie me tefter!

## **DJALI I PAPROKOPSUR**

Bitri që prej kohe ndodhej në kurbet. E kishte lënë atdheun që në vogëli, se e kishte shtyrë nevoja. I ati i kish vdekur dhe kishin mbetur jetimë: ky, pér të cilin do të shkruaj, që ish më i madhi i fëmijëve, një djalë tjetër, më i vogli i fëmijëve dhe dy vajza njëra pas tjetrës. Në shtëpinë e tyre ishin ende të gjallë gjyshja dhe i gjyshi, që të dy kërrusur dhe të drobitur. Sado që nuk luanin, që nga këndi deshën të hanin e të pinin. Me një fjalë që të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, deshën të visheshin, të mbathezin dhe të hanin. Pasja e vogël që u la i ati i Bitrit, u mbarua pa mbushur vitin. Ja, nga këto u detyrua dhe shkoi në kurbet.

Pér të vajtur në kurbet, Bitrit nuk i tha asnje nga të afërmit. Ky, kur e kuptoi vobekësinë që e kishte pushtuar shtëpinë e vet, u mendua pér kurbetin. Ju forcua mendimi edhe nga tregimet e shokëve pér të vëllezërit, që i kishin në kurbet e ku fitonin shumë para. Këto ja shtuan guximin Bitrit.

E ëma nuk desh të pranonte dëshirën e të birit, se asaj i ishte zhuritur zemra nga kurbeti: atje i kishte vde rinjtë e saj. Me një fjalë ajo kishte marrë lebetinë nga kurbeti. Po ca më shumë, të këqijat e kurbetit, ja kujtonte Cokja, fqinja e saj, me të qarat. Ajo e kishte djalin në

kurbet. Ai e kishte harruar dhe nuk i dërgonte as para dhe as letra.

Që të gjitha këto ja skërfitnin zemrën së mjerës Rinë, nënës së Bitrit.

Me njëmijë e një belara u bind Rina. Bitri i bënte be që shkonie në kurbet vetëm për të mirën e shtëpisë dhe për nderin e saj. I bënte be që do të mos shikonte dëfrimet, po vetëm punën dhe gjithnjë do ta kujtonte shtëpinë.

Rina u bind. Vuri qilimin penk për katërqind grosh dhe ja dha paratë Bitrit për udhës. Bitri u gjëzua shumë, i puthi së ëmës dorën dhe qau. Ngaqë nuk desh ta shihte e ëma, u kthyte mënjanë dhe i fshiu lotët.

E ëma e pa. E kupto se atij i dhembte zemra të ndahej nga ajo dhe i tha:

— Po të lëshoj që nga shtëpia edhe të parritur mirë. Do të vesh, o shpresë ime, në kurbet, do ta nxjerrësh bukën me mundime. Do të më jesh larg, do të mos më kesh pranë në kurbanin e flamosur. — Dhe me zë ja thirri të qarit.

I biri ja zuri duart, me të cilat po fërkonte sytë, dhe i tha:

— Mos qaj, nëno! Pas tre vjetësh, ose të shumtën katër, unë jam këtu dhe besoj me shumë para. Ahere i mbulojmë hallet tona. Hesht, mos qaj!

Sado që Rina bëri sikur nuk qau, po i ndiheshin të nemitorat nga të qarët e mbajtur.

Bitri më nuk e shihte të ëmën. Ai ra në mendime. I kaptoi meteoret, se e shkreta fantazi e shpuri në kurbet dhe e sheshoi në pasurira dhe në lumtërirë. Në këtë kohë, Bitri, as vështronë dhe as dëgjonte, po vetëm mendonte paratë e shuma, që do të fitonte; si do të kthejë në atdhe i pasur, si do ta gjëzonte të ëmën, të vëllain, të motrat; si do t'i ndihte sojtit dhe si desh të bënte ndonjë spital.

Bitri, sado që ishte i vogël, se nuk kishte mbushur të 16 vjetët, e kishte fantazinë të gjerë se dhe këto mendime ja shtuan dëshirën për të ikur në kurbet.

Kurbanin, sado që nuk e kishte parë, përpara fanta-

zisë së tij, e shihte me komfort të madh dhe i dukej se mos atje i gërryerenin paratë me lopata. Këto ju rrënjosën kur erdhën ca nga Manastiri dhe bënë shumë mirëbërje në Korçë. Këta i kish në gojë tërë qyteti.

As ai nuk e vuri re kur ju afrua e ëma, e puthi dhe ja largoi mendimet. I ndjeu shumë mirë buzet e ngrohfa të saj.

Bitri nuk qante dhe ata lot, që lëshoi më parë, ju thanë fare. Duke parë tëmën, që qante, desh dhe ai, po s'mundte, se e kishin pushtuar ëndërrimet dhe shpresat. Mendimet e tij ja tha së emës. Ajo e dëgjoi më vërejtje dhe i tha:

— Nuk më duhen shumë, o biro. Vetëm shiko mos më lësh pa dërguar, se ne dhe me një copë bukë do të jemi të lumtur.

U puthën dhe Bitri i hipi arabasë dhe arriti në Manastir. Që andej në Selanik, dhe që andej në Kostancë. Në Selanik priti një javë vaporin, që shkonte drejt për në Kostancë. Atje ishte një shoku i tij, i cili s'kish as gjashtë muaj që kishte ikur.

Dhe kështu me pak mundime, me ca dallgë të këqija, nga të cilat për pak u mbyt vaporit, me ca të vjella, ngaqë e zuri deti, arriti në Kostancë dhe shkoi drejt e te miku. Ai e priti shumë mirë, e nderoi për së tepërmë dhe me anën e të atit i gjeti punë në një pijetore.

\* \* \*

Kurbeti nuk i doli ashtu si e ëndërronte. Ai ishte me mundime të mëdha dhe me vuajtje. Paratë nuk gërryeshin me lopatë, si i dukej atij, po dilnin me mundime dhe me të dirsur shumë. Bitri tre muajt e parë nuk mori fare para. Pastaj mezi ja bëri i zoti 15 franga në muaj.

Kështu shkuan dy vjet. Në këtë kohë Bitri e kishte mësuar gjuhën e vendit sa për t'u marrë vesh. Ishte djali shembull, se kurrë nuk dilte për të dëfryer, kurrë nuk

pinte dhe, sa para që i tepronin, ja dërgonte sëmës. Shkoi dhe një vit. I zoti e desh shumë dhe ja kishte shtuar hakun. Po Bitrit ju mërzit kjo punë, se, kur ju kujtua fantazia uehë tëndërrimet që qëndroi ne lëndina e lotëvet kur u nda nga e ëma, dhe e la se tëndërrimet dhe shpresat e mundonin. Zuri të mos e shihte punën, se e dinte që me punën e tij, i zoti fitonte mijëra. Kur do të ikte, i fliste ustait shumë ashpër.

— Ç'kërkoni ju, more? Dhe kështu me gjakun tonë po fitoni mijëra dhe na paguani ca dyshka!

Bitri kishte ca të holla mënjanë dhe mundi të shkornte katër muaj pa punë. Prapë me anën e mikut u fut në një punë tjetër. Tashti ishte pa hakë, po me bakshishe. Kjo punë i erdhi pas zemrës Bitrit, se ju duk se mos me të do të mundte t'i mbaronte qëllimet. Tashti nxirrte shumë para, po zuri të prishte dhe shumë. Nuk shpëtoi dot as nga shtizat e amurit që ka shumë shumë fëmijë në Vllahi.

Duke dërguar shumë të holla në shtëpi dhe duke bërrë qejfe, ca nga ca shkoi dhe një vit. Më në fund zuri e bënte qejfe shpesh e më shpesh po dhe tashti nuk i kishte këputur marrëdhënjet me shtëpinë, se përpara dy të kremteve të mëdha të vitit, dërgonte nga pesë napolona.

Kishin shkuar dhjetë viet. Dhe Bitri jo që nuk kishte vajtur në atdhe, siç i kishte premtuar sëmës, po as ndër mend nuk e kishte. E la punën dhe zuri një vend më të mirë ku nxirrte më shumë para. Tashti zuri të ndiqte restorantet e mëdha dhe shantanet, qilaret ku pinte verë dhe birraritë. Tërë shenjtërirat e para ju shkulën, se vendin e tyre ja zunë të rejat...

Tashti Bitri nuk shkruante as letra dhe as dërgonte para. Nuk ja kujtonte asgjë tëmën, të vëllain dhe të motrat, që do të ishin ndryshuar nga koha. Tashti ai asgjë të Shqipërisë nuk kujtonte dhe as veten nuk desh ta quante shqiptar. Më lart se çfarëdo për të qëndronin gratë e këqija, pas të cilave i prishte që të gjitha sa fitonte.

Ky ish kelner në një restorant dhe nxirrte nga 20-30 franga në ditë, po nuk linte mënjanë asnjë qindarkë, se që të gjitha treteshin me ato zonjëzat, që i pëlqente ta shkonte kohën.

me këmbë, e vështroi edhe një herë mikun, bëri ta hap-te gojën, po përnjëherësh e mbylli. Siç duket u men-dua se ç'duhej të fliste. Lithka desh të mësonte a do të dërgonte dot gjë dhe i tha:

— Ja, këto ditë dërgo ndonja 5-10 napolona në shtëpi. E sheh se kanë nevojë të madhe.

— Unë s'kam shtëpi — ju përgjegj Bitri.

— Si nuk ke shtëpi? Po nënën, motrat kush do t'i ushqejë?

— Ajo nuk është puna ime — tha me zemërim Bitri.

— Si e ke hallë, more, ti u prishe nga kondaku! Shtëpinë të harrosh? Për zdëret të punosh ti, more? E jötëmë, tët motra duhet të vuajnë. Nuk ke një çikë turp.

— Jo, nuk kam turp.

— Me botën të prishësh qindra franga dhe të mos kujtosh shtëpinë. Kjo nuk është e drejtë.

— Ajo është puna ime.

— Po ty nuk të paska mbetur asgjë e shenjtë përsipër. A s'më thua të lutem, e vetmja shenjtërirë për ty janë zdëret dhe qejfet?

Bitri u nxeh shumë nga fjalët e mikut. Ai ja pri-si mikut dhe i tha:

— Të lutem mos ma çaj kokën, se ty nuk të kam vënë qehaja në punët e mia.

Pas kësaj fjalë Lithka s'u mbajt dot më. I harroi sjelljet e mira dhe e shau si më i poshtri njeri me të atilla fjalë, që i përdorte për herën e parë.

Bitri u ngrit dhe deshi ta godiste, po, ngaqë ishte shumë më i dobët nga Lithka, mblodhi bishtin ndër shalë, e la mikun duke u vështruar me zemërim dhe u bashkua me detanikët.

— Jo, nuk bëhet njeri ky — tha Lithka kur u kthye.

\* \* \*

Krishtlindjet kishin shkuar. Bitri tërë kohën e shkonte me detanikët dhe me zdëret pa vrarë fare mendjen për të shtëpisë.

Që nga shtëpia mori dhe shumë letra të tiera, po të tëra i hidhte të palexuara në zjarr. Ishte i pamë-shirshëm, si gur.

Tamam si një vit më parë dhe këtë vit Lithkës i erdhi një letër, po kjo ishte në pliko të zezë. U tremb shumë se për një sekondë mijëra mendime ja pushtuan trutë. Mendohej për të shoqen, për témën, për gjyshen, po ca më shumë mendohej për të birin, për të cilin i shkruanin, javën e parë, se ishte i sëmurë nga tifoja. Po, kur e vuri re shkrimin, ju zhdukën dyshimet, se ai shkrim nuk i ishte i njohur. Duke e värtitur në dorë, ju kujtua letra e vjetme, e cila kishte po atë shkrim. Ju kujtua e tërë ngjarja me Bitrin. E grisi plikon dhe lexoi një letër që ishte me dhjetë radhë, me anën e të cilave lajmëronin vdekjen e sëmës së Bitrit. Lithkës ju mbushët sytë me lot. Mori kapelën dhe doli jashtë. E ndali i ati dhe i tha:

— Që nga është ajo letër?

— Që nga do të jetë, — ju përgjegji diali duke fshirë lotët — nga shtëpia e Bitrit. I paska vdekur e éma. Dua të vete t'ja them që të mos e mësojë nga të tjerët.

— E ndjeftë perëndia të mjerën, që nuk pa as ndonjë ditë të bardhë!

— Shtëpinë ja paskan zaptuar borxhlinjtë dhe vajzat paskan mbetur udhëve.

— Sikur të dojë zoti, ta ndritnjë për të mirë Bitrin — tha plaku i pikëlluar. Atij i vinte shumë keq për vajzat, se ja dinte kokën Bitrit. Atij ju kujtuan ditët e fundit kur, këtu e dy vjet, u kthyte nga Korça për në kurbet, e éma e Bitrit, ju lut me lotët ndër sy, që ta bindte djalin t'i dërgonte të paktën një copëzë letër.

Lithka kishte dalë dhe po kërkonte Bitrin. të cilin me shumë mundime, dhe pas shumë të pyeturash, e gjeti. Pérnjéheresh e hoqi mënjanë dhe i tha:

— Vetë shëndoshë, se të la nëna! Hap sytë tashti, përpiku për tët motra që t'i martosh, se ato nuk kanë njeri tjetër...

Po Lithka u çudit kur Bitrit nuk ju këmbye as ngjyra e fytvrës. Nuk i erdhi keq dhe as qau. Vetëm nuk dinte ç'të fliste që ta goditte Likthën. Ish njësoj sikur ato fjalë ju folën murit se ai kur dëgjonte fjalët e Lithkës mendonte për zdëret. E kuptoi që e mundonte me fjalët e tij dhe u ngrit duke thënë:

— E mbarova borxhin tim, pa ti bëj ç'të duash — dhe shkoi.

Bitri psherëtiti që mbeti vetëm, veshi pallton dhe me hapa të shpejtë, duke vërvshëlyer një avaz gazmor, shkoi. Lithka i ra prapa dhe, pasi shkoi një dhjetë minuta, e pa që Bitri hyri në një restorant. Lithka u pezmatua dhe vajti dhe ky brenda. Pa portierin dhe, pasi i lëshoi në dorë që t'ja zgjidhte gojën, e pyeti:

— Të lutem, a s'më thua, cili është ky zotni, që hyri tashti?

— Ky është një djalë i një tregëtar shumë të dëgjuar — ju përgjegj shërbëtori. — Këtë e kemi një nga myshterinjtë më të mirë.

— Ju vjen shpesh?

— Shumë shpesh. Ja dhe tashti po e presin shokët dhe shoqet në një dhomë të veçantë. O, ky është shumë ovardha (gallantom).

Lithka për pak ja thirri së qeshurës në sytë e shërbëtorit. Pa thënë asnjë fjalë tjetër u largua. Shërbëtori po e përcillte me çudi.

\*  
\*      \*

Kishin shkuar shumë vjet. Një ditë Lithka mori gazeten dhe në ngjarjet e ditës lexoi këto: «Bitri Gjoka që zuri me pahir X... u dënu me 15 vjet burg».

**THE END**



## PA STREHË

— E ç'bëre, a gjete shtëpi? — e pyeti Dila Lecin, që ish i veshur me brekushe, i parrojtur e që dukej si hija e tet të Hamletit.

Ai e pa të shoqen, mori frymë me të shpejtë, e gëlltiti pështymën, e pa dhe një herë në sy dhe i tha:

— Eh, moj grua! Gjërat e lira shkuan e vanë; tani, bashkë me lirinë na erdhi dhe shtrenjtësira. I thashë Gjon Conit për atë shtëpinë që ka me një odë përdhese e pa tavan e me një kuzinë si haur. Më kërkoi një napolonë e gjysmë. Mirë është ta marëm, po ku t'i gjejmë paret për ta paguar. Pastaj lyp për dy muaj në dorë.

Dhe, duke e mbështetur kryet mbi duart, ra në mejtime të thella. Dila e shikonte të shoqin në fytyrë, ku i ish vënë vula e kujdesjes, dhe i tha:

— Alla hile ç'do të bëjmë? Sot ish gjysh Cani dhe më tha që të mbaremi nga shtëpia, se dhe këtu afati ka dy muaj që ka kaluar. Qysh do ta bëjmë? Qiratë aqë shumë u shtrenjtuan, sa nuk jetohet dot. Ndue Gjyshi mori çadrën dhe shkoi e u vendos në zallin e Kirit. A vemi dhe ne: ka një çadër që nga koha e turkut...

— Mirë, mirë thua, moj grua, mirëpo ne jemi me fëmijë; atje ka lagështi e mund të na plevitosen fëmija.

Kërkuan dhe shumë kohë e shumë herë, po asgjë-kundi nuk gjetën dot shtëpi: ku gjemin ndonjë si të

lirë ua lypnin qiranë për dy muaj peshim<sup>1)</sup> dhe, kështu, u shtrënguan të vendosen nën çadër në Zallin e Kirit, të larguar nga qyteti si të dënuar nga gjyqi i parasë.

\*

\* \* \*

Çeli agimi. Dielli, që prapa maleve që tregonin krenarinë e Shkodrës, e zbardhëlloi qytetin, kishat, xhamitë, pallatet, kasollet, si dhe çadrat e fukarasë, se ai është i begenisur për të gjithë. Marku me Prenkën, djemtë e Lecit, duallën nga birat e çadrave, dhe të çkujdesur, filluan të losnin, meqë ata edhe nuk kishin arrirë të hynin në fshehtësitë e kësaj jete, që është mbështetur mbi paranë. Dielli po çapitte, mengadalë dhe i çkujdesur, në qiellin pa fund, kur pa ndalim e kur f penguar prej ndonjë reje. Leci kish shkuar me kohë në qytet, kish pritur te zyra e punës e kish punuar gjithë ditën për shtatë grosh. Mbrëmave u kthye në shtëpi me bukë kallamoqi e kos. Pasi e lanë gjysmën e bukës për të nesërmet, gjysmë të ngopur ranë të flenë. Kështu shkoi një muaj e një tjeter. Po një ditë ra një shi që zgjati shumë kohë. U bënë pellgje dhe u fut shumë ujë në çadrat. Leci bashkë me robërit e tij u ftoh dhe ju sëmurën rëndë që të dy djemtë: kishin zjarrmi të madhe. Leci shkoi te mjeku, mirëpo ai, duke i parë të veshur keq, ja lypi paret në dorë. Kish vetëm dy çerekë; këto pas hesapit të mjekut nuk i arrinin as për karrocë. Dhe, kur dolli rrugës për të gjetur nonjë rrugëdalje, padashur ju kujtua lufta, vuajtjet, koha kur hanin mish kali e këlkëzë<sup>2)</sup>; ju kujtuan florinjtë e

---

1) paradhënje.

2) këlkazë — bar' i keq.

gruas, që i shiti për një qese kallamboqi, i erdhi për të qarë dhe e zuri kryet me dorë. Pas kësaj ju kujtua ko-ha kur kërciste topi, kur vërvitte gjylet që pëlcisnin e sillnin shkatërrime. Kur pa të shoqen, e pyeti:

— E, moj, si janë?

Ajo nuk ju përgjegj, po vetëm qante e derdhët lot. E mori vesh që do të ishin më keq.

«Eh, more!» tha me vete dhe doli jashtë e mori rrugën për në pazar, ku shpresonte të takonte ndonjë mik e t'i merrte hua ose të gjente ndonjë punë.

\* \* \*

Ora ishte më shumë se dy allafranga. Qielli ish kthjelluar dhe dielli po e ngrohte dheun, po e avullonte ujet; po e thante baltën dhe po e zbutte airin. Leci, me të arrirë në gjymbryk<sup>1)</sup>, pa që po çkarkonin një arkë të madhe të një tregëtarit. Sado që rrrotull saj ishin mbledhur më shumë se pesë hamej, nuk po i gjenin vlinë se si ta merrnin. Leci e kuptoi që këtu do të mund të merrte ndonjë çereke ose dhe më shumë bakshishi dhe, pasi të nxirrte dhe shumë arka të tjera, do të mundte të fitonte mjaft para që të merrte miekun e t'i shëronte djemtë.

Hamajtë, me ta parë Lecin me sytë e zgurdulluar e me ftyra të egërsuara, u prapsën dhe e lanë ta merrte arkën. Me një vrull e kërceu arkën mbi shpinë. Po nuk bëri dot as pesë çapa dhe arka e përkuli, i ra përsipër dhe nuk mundi të thotë dot as gjysmë fjalë, po vetëm thirri: «Oh»!

U sulën hamajtë e njerëzia dhe e liruan nga barra. Me të shpejtë erdhi mjeku i gjymbrykut dhe kuptoi se i qenë shtypur mushkëritë e i qenë thyer disa bri-një. E spërkatën me ujë dhe mjeku i vuri një bar në

---

1) Doganë.

ħundë. Pas ketyre i hapi sytë, pa diellin, qiellin, rreth e rrotull dhe, me zë tē ulët e me fjalë tē prera, tha: «Në shtëpi... në shtëpi!» \*

Me shumë mundime e pas shumë tē pyeturash, mezi e gjetën ku banonte. Kur ju afroan çadrave, ai me gisht tregonte çadrën e tij, banesën pér tē cilën nuk paguante qira. Kur e pa e shoqja, i mbushi sytë me lot, po nuk luajti nga vëndi. Kur e lëshuan mbi shtratin e hollë, meqë i qe prerë goja, shikoi fytyrat e zbeta tē fëmijëve dhe me vështrim e pyeti: «Si janë?» Ajo nuk ju përgjegji, po i zuri fëmijën me dorë, i lëshoi dhe, kur ranë si kërcunj, ja thirri ulërimës.

Tani e kuptoi c'kish ngjarë, po nuk fliste dot; i hodhi sytë nga e shoqja që qante, pa fëmijën tē vdekur, i vagulloi sytë, i zgjati këmbët dhe e dha frymën në shtëpinë e tij që nuk paguante qira.

E shoqja ja thirri tē qarit me më shumë forcë, duke çjerrë fytyrën, duke kafshuar llérët dhe pastaj ngritisht duart në qiell duke kérkuar hakmarrje mbi shkaktarët e tē këqijave që pësoi, se mbeti pa burrë, pa fëmijë, pa bukë dhe pa strehë.

*Shkodër, 25.V.1914*

## K O L E N D R A T

Në katavaroshin e Korçës, andej nga shkon lumi, kundrejt kishës së shën Mërisë. ishte një shtëpi, e ndër-tuar me plitharë, e mbuluar me qiramidhe të vjetra e të thyera prej gurëve, që hidhnin djemkat, që ku, kur binte shi ose tretej dëbora, pikonte në odën e vetme e pa tavan, ku, përveç magjes së vogël në të cilën, ngaqë s'kishin miell, kishin shumë kohë që nuk kishin gatuar, shtresës bashkë me prokovaçin e trashë dhe konizmës së vjetër, pranë së cilës duke u gdhirë e diel ose e krem-te ndizej kandili, nuk kishte asgjë tjatër... Po, se për pak harrova, mbi murin e nxirë nga tymi, që përhapej kur nuk hiqte oxhaku, ishte varur një fotografi, që tregonte një burrë të hijshëm, të cilin, siç theshte Rina kur e pyesnin, e kish burrë. Ky nuk dukej të ish më shumë se 30 vjec, po kishte plot dhjetë vjet që nuk kish dhënë as ndonjë shenjë gjallërimi që nga kurbeti. Më parë ai dërgonte letra dhe para... E tani, kur e pyes-nin fqinjët për të, ajo u thoshte :

— Do të ketë vdekur në kurbet.

Rinës i kish mbetur një djalë i mbarë, që e quanin Pilo dhe që ecte të dhjetin mot. Rina e donte shumë Pi-lon, vdiste për të dhe rronte vetëm për të, se desh ta rritte e ta martonte duke shpresuar se atëhere do të rronte e lumtur. Dhe kështu Rina, duke larë rrrobat, portë më portë ku kish të njohur, paguhej njëqind pa-

ra, një çyrek me bukë dhe një misur me gjellë. Këto i hante bashkë me djalin, me shpresën e saj.

Kështu e kish shkuar këtë kohë të gjatë që nuk i dërgonte i shoqi. Po më parë ajo rronte e lumtur, se i shoqi i dërgonte mjaft para. Siç thoshin fqinjët, ai e donte shumë Rinën. I shoqi i saj ish një i ardhur nga Vakëfet dhe kish bërë mjaft kurbet në Ianaros ku kish vajtur që i vogël. Kish sjellë para, që i kish fituar duke punuar me mushka. Kur u kthyesh, ish 30 vjeç. Bleu një shtëpi në qendrën e qytetit. Solli të ëmën nga fshati. E mbushi shtëpinë me gjithë të mirat. U martua me Rinën, që e pëlqeu kur e pa një ditë që zgjati kokën nga porta, që ishte përgjysmë e hapur. Ndejnji gjashtë muaj sa porositi Pilon, mori hua katër lira, prej të cilave një ja la së shoqes dhe shkoi në kurbet.

Po dhe prindërit e Rinës rronin mirë. Ata kishin mjaft gjë dhe një dyqan. Me këto fitime e rritën Rinën, e martuan dhe mundën t'i jepnin njëqind napollona prikë e t'ja bënин pajën si më së mirës. Si e martuan vajzën, ju prish puna dhe humbnin për ditë sa kishin hyrë në fajde. Kur vdiqën i lanë Rinës shumë borxhe, të cilat ajo, pak nga pak, i paguante, se nuk desh t'u lintë më qafë prindërvë.

Lumturi për Rinën ishin vetëm vjetët e parë të martesës, po dhe në atë kohë ajo kurdoherë ndodhej në zi, se i vdiq i vjehrri, e vjehrra, i ati, e ëma. Po të paktën nuk kishte nevojë, se kish me se të blinte ushqim, të vishej e të mbathej. E kur i shoqi më nuk i dërgonte, zuri të futej në borxh dhe, pak nga pak, aq ju shtuan borxhet, sa u shtrëngua ta vinte shtëpinë penk. Pastaj shiti dengun e tërë, që e kish gjer në tavanc dhe më në fund, nga që ju shtua shumë fajdea, ja shiten shtëpinë. Që atëhere u mbajt në katavarosh, në atë shtëpinë e vogël, për të cilën paguante dyqind grosh qira në mot. «Kështu qenka thënë për „nua“ thesh gjithnjë Rina dhe, sado që dëshpërohej për fatin e saj të keq. kishte një shpresë të fshehtë: «Ja, sa të më rritet djali, pa...»

\* \* \*

Ora kishte vajtur pesë. Qielli ish mbushur me re dhe po binte një dëborë e hollë. Nuk ishte dhe aqë ftohtë. Rina nuk ish në shtëpi e djalit sepse nuk i rrjhej brenda. Të nesërmen ishte dita e kolendrave. Piloja i kish baritur që të gjitha udhët. Kish lozur nga sheshi i çesmave të arave. Kudo që shkonte, shihte djem në vërsën e tij, më të mëdhenj e më të vegjël me çomage në dorë. Ata ishin veshur me rroba të reja, me breza të bukur, me feste të vëna në kallëp dhe ca ishin me kapele. Që të gjithë mbanin fort çomaget në dorë dhe dukeshin shumë të gëzuar në fytyrë, e cila u ish skuqur prej thëllimit.

Piloja, pasi shëtiti mjaft, u kthyte në shtëpi. Rëmoi më të katër anët duke kërkuar ndonjë çomage, po nuk gjeti dot dhe doli sërisht jashtë. Te çipi i udhës i hodhi sytë duke dashur të shihte të ëmën, së cilës do t'i lutetj t'i blinte çomage. Po ajo nuk dukej. Fytyra i ishte skuqur aqë shumë, sa nuk i shquhej vula e pikëllimit. Pa dhe një herë se mos e shihte të ëmën dhe mori udhën për nga Mitropolia. Hyri në oborrin e kishës dhe nga sytë e tij dukej sikur dikë kërkonte. Po ai nuk kërkonte asnjeri, se shokët i kish në katavarosh dhe e ëma ish në shtëpinë e Zagros ku bënte punët nga muaj. Piloja e dinte që nuk kish as ndonjë fis se, sa herë që e kishte pyetur të ëmën për të atin, ajo i kish thënë se ai kish vdekur në kurbet. Dhe ky u kish zili atyre që kishin baba, se ata, pas mendjes së tij, i kishin të gjitha të mirat.

Plot mejtime për varfërinë e tij u fut në hajatin e kishës dhe ndenji mbi sofatin e gurtë, mbi të cilin kishin bërë një vç e një damë. Ra në mendime që nuk bëri as dolloma e as këpucë të reja. Në këtë çast përparrë tij shkoi një djali i veshur me dolloma të re prej basmeje me via të mëndafshta. Ishte ngjeshur me një brez të bukur, xhufkat e të cilat valonin kur bariste.

Festen e kishte vénë mënjanë. Ajo i rrinte pak si e madhe, sado që e kishte vénë atë ditë në kallëp. Pallton e kish prej coheje dhe me jakë me qime. Këpucët i kish prej kundraxhiu e me llastika anës e në dorë kish një çomage nga ato të tavanxhinjve, që janë të lyera me dy ngjyra e që duken si ngjyrat kombëtare. Piloja, me ta parë djalin, u ngrit në këmbë, ju afrua, se u kujtua që s'kish çomage, dhe si me turp, po përnjëherësh i tha duke vështruar çomagen me lakmi:

— Nëma mua këtë çomage, — dhe e zuri me dorë — ti mund të kesh tjetër në shtëpi.

Djali i veshur mirë e pa Pilon me sv të keq, ja hoqi çomagen nga dora dhe, ngaqë ish i veshur me një dolloma të grisur e i ngjeshur me një rrip pëlhure, me këpucë të grisura e më të mëdha nga këmba, u tremb e i erdhë ndoht, se ju duk sikur e shtiu poshtë mburësinë e të pasurit. U sul me vrap që të mos ja rrëmbente çomagen Piloja. Po, kur e pa se ky nuk luajti nga vendi, u kthye dhe i tha:

— Në pazar ka shumë çomage, ka sa të duash. — E shtrëngoi çomagen më fort dhe shkoi me sulm duke kthyer kokën se kishte frikë mos e ndiqte. Kur arriti te porta e kishës, e pa Pilon dhe zuri të priste të ëmën që të dilte nga esperinoja që t'i blinte vula dhe simite.

Piloja, me të dëgjuar fjalët e djalit të pasur, u pikellua shumë dhe u pendua që e lëshoi veten aq poshtë përpara atij «afendikoçkës». Doli nga hajati, e la oborrin e kishës dhe mori udhën nga shën Thanasi. Shkonte si i lënë me duart në xhepat, që i kishte copë e kothe-re. Në këtë çast i ra erë bukë të ngrohtë dhe qahi. Kjo erë e bëri të ndalej përpara furrës së Tondonozit ku pa plakun e zeshkë e të thinjur, që ishte ende mjaft i mbajtur, që po çfurniste bukët me qiqra dhe teptsitë me qahi. Era e bukës ja shtoi urinë dhe zunë t'i binin jargët... Piloja i nguli këmbët, i hodhi sytë në furre dhe, ngaqë kishte tërë ditën pa bukë, desh t'i kërkonte një copëzë një gruaje që ish e veshur me sako me millo të ngrënë e me dy shami. Siç dukej kësaj do t'i kishte

vdekur i shoqi, ose i biri, ose i vëllai dhe do ta kishte marrë mandatën nga kurheti e do të kish shumë vjet që s'do ta kishte parë. Kështu u mejtua Piloja pér gruan. Po, kur u lirua prej mejtimeve e ju afrua gruas që t'i kërkonte, përnjëherësh ju kujtua «afendikoçka», e pa dhe një herë qahitë dhe shkoi, duke rendur, pér në shtëpi pa vënë re as djemkat me fytyra gazmore, as gratë me qahi e me kuleçë, as cirakët me trastat plot, as dëborën, që zuri të binte përsëri e as të ftohtët, që i futej që nga këpucët e mëdha e që i përhapej në tërë trupin e tij. I pikëlluar dhe me zemërim i ra me këmbë derës së vjetër të shtëpisë ku rronin, e cila u hap pasi hoqi gjalmin, me të cilin ish lidhur rrezja. Hyri brenda dhe u shtri te këndi mbi shtresën e nxituar dhe. ngaqë nuk kish as çomage, as qahi, as kulaç e as bukë, zuri të qante.

Kështu shkoi shumë kohë. Ky po priste të kthehej e ëma, së cilës do t'ja thesh që të gjitha dhe do t'i lutetj t'i blinte një çomage se dhe ai desh të vinte portë më portë ditën e kolendrave.

\* \* \*

Dëbora s'kish të pushuar. Dheun e kishte pushtuar një çarçaf i bardhë e i trashë gjer më ndonja katër gishtërinj, ish mjaft ftohtë dhe nuk frynte erë. Rina i kish mbaruar gjithë punët dhe, kur u err fare, me fenerin në dorë u kthye në shtëpi. Kur hyri, e gjeti derën hapur dhe Pilon që po flinte. Ajo, pér hatrin e ditës së nesërme, përveç çyrekut me bukë dhe misurit me gjellë, kishte sjellë dhe një qahi, të cilën u mendua ta linte pér ditën e kërshëndelleve. Ajo ishte lodhur dhe e këputur. Shtëpia ish e pa rregulluar. Asaj i pëlqente paqllëku dhe nuk e duronte çrrëgullimin. Kur mbaroi së rregulluari, e ndezi ziarrin e me kotheret e copërat, që kishin mbetur, bëri një përshest me fasule. E zgjoi dja-

lin, i cili mezi u ngrit dhe hëngrën bukë. Eëma e kuptoi që ai kish qarë dhe e pyeti:

— Pse ke qarë, o biro?

— Se nuk kam çomage, moj nënë, — dhe ja tregoi që të gjitha së ëmës.

Ajo i dha durim duke i thënë se do të kishte vitin tjetër. I dhembte zemra që nuk mundte t'i blinte, se e kuptoi se sa e shtrenjtë ishte për Pilon çomagja. E din-te ajo që dhe ai duhej të gëzohej, të dilte portave me shokët që të kërkonin kolendra e të këndonin këngën e kolendrave. Me gjithë dëshirën e madhe që kishte nuk mundte t'ja plotësote, se nuk kish me se t'ja blinte. Ajo nuk kish me se të burbuletej ditën e shënuar e jo të blinte çomage. Përnjëherësh ju kujtua dita kur i kish blerë çomage, po ahere Piloja ish aq i vogël, sa nuk kuptonte asgjë. E për fatin e saj, nga Zagroja, ku punoi katër ditë, nuk ja paguan. Ajo me ato do të mundte të mbaronte njëmijë halle. I bënин për të marrë dhjetë grosh. Ata ja lanë t'ja paguanin herë tjetër. Atyre u dukej sikur tërë bota kishin si ata. Nuk e dinin se Rina nuk kish me se të burbuletej, se nuk e kishin njohur varfërinë. Dhe qahinë s'do t'ja kishin dhënë, po ja dhanë se u ndodh në ashef kur i sollën nga furra dhe u erdhi turp.

Rina, pasi dëgjoi historinë e Pilos, ra në mejtime, e pushtoi të birin në krahët e saj, e puthi dhe, duke u falur, i tha:

— Falu, biro, falu, se perëndia është e madhe dhe do të na ndihmojë. — Dhe ranë të flinin. Rina u mejtua dhe shumë, se ju kujtua koha e shkuar kur ishte po e mundi lodhja dhe e zuri gjumi. Piloja ra pranë së ëmës. Kur i hapte e kur i myllte sytë. Shihte të ëmën që ishte e mejtuar, nuk i fliste, por mejtohej për qahitë, për «afendikoçkën» që s'ja dha çomagen, prapë shihte të ëmën, që e kishte zënë gjumi e po grindej. Me shumë mundime mezi e zuri gjumi dhe pa èndërr sikur një plak i thinjur i solli mish të pjekur, qahi, kulaçe dhe një

çomage të bukur. Në këtë çast u zgjua e ëma. Piloja po thërriste nga gazi. Ajo i tha:

— Ç'ke, shpreso, gjëzimo, ç'ke që thërret?

— Nëno, pashë, pashë shumë gjëra, shumë... po ku janë? — dhe i mbylli prapë sytë.

\*

\*

\*

Këtë ditë nuk kishte punë jashtë shtëpisë. E zgjoi Pilon. I veshi një dolloma tjetër, sado të vjetër e të ar-nuar, po të pastër. I mbathi një palë çorape të reja, që ja kishte bërë me tepricat e kohës së lumtur. I mbathi një palë këpucë të tjera, që ja kishte falur një zonjë e mirë, e që ishin pak të vogla. Kësaj zonje i vinte shumë keq pér Rinën e pér Pilon, se dhe ajo kish mbetur pa baba e kishte hequr shumë sa kishte genë e vogël. Rina vetë veshi fustanin e dytë, që e kishte fare të ri, se e kursente, sakon<sup>1)</sup> me nafe të krojtur prapa dhe mbathi këpucët më të mira që kish të çpuara në shollë nga ku i futej dëbora dhe të ftotët.

Kur u vesh, vajti te polica, mbi të cilën ish konizma, mori dhjetëshen e fundit, që e kish mbluar, mori Pilon pasdore dhe u nis pér në kishë. Kur hyri, bleu një pesësh qirinj; ndezi njérin sapo hyri, me evllave të madhe duke bërë kryq. Pastaj u afrua në mes të kishës të grave, ndezi qiririn e fundit dhe ju afrua kafazeve. Që atje me kujdes e me besim të madh dëgjonte zërat, të priftit e të dhjakut, që këndonin meshën, të psalltërve që këndonin njëri pas tjetrit, psallmat. Sado që nuk kuptonte gjë, sytë dhe veshët i kishte drejtuar nga jodhima ku shërbehej mesha. Sa herë që e shihte priftin me dhjakun që bënin kryq, dhe ajo e bënte tri herë e,

---

1) xhaketë.

kur mbaronte, e vinte dorën në zemër duke thënë: «Shpëtona, o zot!» Piloja rrinte pranë së emës dhe e shihte me çudi fytyrën e saj të verdhë. Ngjyra i kishët humbur fare dhe dukej sikur bëhej gati të qante. Dhe ai, sa herë që e shihte të emën që bënte kryq, bënte dhe ai kryqe të mëdha, duke thënë: «O zot, o zot!» Me këto fjalë ai i kërkonte ndihmën zotit.

E zeza Rinë falej, lutej; bënte kryqe; vështronët priftin e dhjakun, dëgjonte psalltërit, vështronët konizmat, kandilët e fytyrat e grave të gjëzuara, që i kishtë pranë. Ato shumë shpesh harronin të faleshin, se bisedonin në mes të tyre. Gjithsecila tregonte për letrën, që kishtë marrë nga kurbeti prej djalit ose burrit; tjetra tregonte për qahitë e për kuleçët që i dolën shumë të goditur; tjetra tregonte për qigrën, që nuk i kishtë ardhur mirë e që nuk ju goditën qahitë dhe shumë biseda të tjera. Këto e pikëllonin pa masë Rinën se ja lëndonin plagët. Prifti vazhdonte këndimin e dhjakut, duke lidhur e duke zgjidhur brezin. Me zërin e tij të fortë ua shkëputte bisedën grave për ca kohë. Rina vështronët fqinjët dhe mejtonte fatkeqësinë e varfërinë, që e rrëthonë; mejtohej që nuk kish me se të burbulej, se në shtëpi kishtë vetëm një gjysmë çyrekur bukë dhe një qahi e një misur me groshë pa vaj e asnë copë mish.

Po kush e kujton mishin, kur nuk ka bukë sa të ngopet?

Mejtohej që nuk i kish mbetur asnë pesësh që t'i blinte, të paktën, një simite djalit, se atë që ja dhanë kusur prej qirinjeve, e hodhi në dhisk kur doli epitropi. Mejtonte dhe shumë të tjera e shkreta sa zgjati mesha. Kur u mbarua, mori naforë dhe doli.

\*  
\* \* \*

Njerëzia po dilnin me tërbim dhe po e shtynin Rinën e mjerë. Ata shtyheshin pa mëshirë sikur i kishin

futur me zor dhe me padurim prisnin fundin. Rina pris-te radhën dhe me Pilon për dore doli në oborrin e ki-shës ku, djemkat tregëtarë, thërrisnin me zë të lartë: «Vula, mende dhjetë në pesësh!... portokalle... por-tokalle... e mollë të mira!... gjevreçka... gjevreçka!...» thërriste Tafili me perustinë e tij të bukur në dorë. Pi-llos i kullonin jargët nga gjithë këto të mira që shihte te porta e kishës. Ai me zë të ëmbël i thesh së ëmës t'i blinte, po ajo nuk e dëgjonte se dhe ajo mejtonte po për ato, dëshironte t'i blinte, po nuk kishte me se. Zem-rën e kish të skërfitur e mendjen si të lënë.

— Blimë, nëno, blimë simite... gjevreçka... — i thesh Piloja. Ajo shkonte pa guxuar t'i hidhte sytë mbi sepetet e tregëtarëve, që përpinqeshin kush të shis-te më shumë. Më në fund doli në xhade. Piloja, i pikëlluar e duke murmurisur, e zuri të ëmën pas çipit të sakos dhe bashkë me të u drejtua në shtëpi.

## HAPI I PARË

— Të më zgjosh, nëno, të më zgjosh — i tha Kola së ëmës, pasi puthi dorën e saj të fishkur e të rrudhur, kur ra të flinte,

E ëma, pasi e puthi, e shtrëngoi në krahët e saj, e mbuloi, nisi të punonte çorapen, që e kishte nisur prej dy ditësh e prej të cilit do të merrte pesë grosh.

\* \* \*

Kola ish një djalë gjë më nonja 13 vjeç, i bardhë, i bukur, me sy të shkruar dhe shumë i mbarë. Kurre nuk ja kish bërë fjalën dy së ëmës. Sytë i kish plot me magnit dhe me to fitonte simpatinë e të gjithëve. E Cokja, e ëma e Kolës, kishte disa vjet që nuk merrte nga i shoqi letra me rregull; ky tërë jetën e tij e kish shkuar në kurbet dhe, sado që kish 28 vjet që ishin martuar, po t'ja bëje mirë hesap, nuk kishte shkuar pranë saj as dy vjet. Ajo kish lindur dhe fëmijë të tjera, po ja kish rrëmbyer vdekja. I kish mbetur vetëm Kola, djali i pleqërisë, mbi të cilin e kish vënë tërë kujdesjen e saj. Dhe, sado që i shoqi kishtë kaq vjet që

nuk po i dërgonte, Cokja u kish bërë ballë gjithë nevojave, duke punuar çorape e punëra të tjera të dorës. Kështu e rriti Kolën. Gjer në këtë kohë Kola shkonte në shkollë. Mësoi mjaft se e mbaroi rreshtin e pestë të fillores. Po, kur u fut në myshteret e harxheve të shtëpisë, ku e futën fjalët e së ëmës. «Unë e zeza, me se do të marr bereqet»... «Unë e zeza, me se do të marr bulmet» para kohe e futën djalin në mejtime. Kur mbaroi rreshtin e pestë, i coi së ëmës notat e shkollës dhe, duke e vështruar të ëmën nér sy, me lutje i tha:

— Nëno, nuk dua të mësoj më. Dua të hyj çirak e të fitoj para, se... — dhe ju derdh së ëmës, e pushtoi pas qafe, me kryet futur në kraharorin e saj... — se dua të fitoj para... se u bëra burrë.

Eëma, duke ja pilluar flokët, e puthte dhe i thesh:

— Do të fitosh, biro, do të fitosh!



Ish dimër. Mesi i natës. Cokja, pasi e mbaroi njëren grykë të çorapes, shoi gaznikun, mbuloi zjarrin dhe u fut në rrobat ku, qëkur, po flinte Kola. Ky kishte dy muaj që kish hyrë çirak dhe, përnatë, i lutej së ëmës ta zgjonte që në mëngjez, se kish frikë mos vonohej. Jastë era frynte si e marrë dhe e ngrinte dëborën, që kishte rënë tri ditë me radhë. Ora shkonte. Furfurina dëgjohej duke vërvhellyer. Kola flinte si shqerrë, se ish i lodhur... Ora shkonte... Cokja zgjohet dhe i hidhte sytë nga i biri, ja ndreqte kryet, që i varej, e mbulonte dhe prapë tulitej. Nga mëngjezi dëgjonte zërat e këndesave që ishin si zinxhir. Pa rreshthur njëri, ja thërriste tjetri. Nga këto e kuptonte që arriti koha

për ta zgjuar Kolën. Ajo e shihte të birin si flinteëmbël, i vinte keq ta zgjonte, se kujtonte lumturinë e të tjerëve. I largoit mendimet, i hodhi mbulesat prej vetes, u ngrit më këmbë dhe, duke dëgjuar zérat e punëtorëve, që shkonin rrugës, ndezi zjarrin. I vinte keq ta zgjonte, po asaj i dukej sikur i thosh zéri i kendesit:

— Zgjoje, zgjoje... shkoi koha!

Ajo ju afrua djalit dhe desh të largohej. po përnjëherë ju kujtua «detyra qëndron më lart nga dashuria»; me përkëdhelime, me fjalë të ëmbla i thesh:

— Ngrehu, bir, ngrehu, ngrehu, shpresë, ngrehu... ngrehu, t'u bëfsha kurban, ngrehu... ngrehu, se u gdhi... ngrehu de... — dhe shumë përkëdhelime e fjalë të ëmbla, që dinë t'i gjejnë vetëm nënët e që dinë t'i flasin vetëm buzët e tyre.

E Kola symbyllur i thosh:

— Eshtë shpejt, moj nëno, eshtë shpejt... ja dhe një çikëzë... eshtë shpejt, ja u ngrita... — dhe, duke u kthyer nga ana tjetër, e zinte gjumi.

\*  
\* \* \*

— Pse nuk më zgjove më shpejt, moj nënoçkë? — i tha Kola së ëmës kur u ngrit duke shtrembëuar buzët e duke përpjekur këmbët. Si u la e u vesh, u shtrua pranë vatrës ku digjeshin dy dru, që lëshonin më shumë tym se sa flakë. E éma ja kish bërë gati kafenë, të cilën po e hante me bukë të zezë, duke e ngjyer me ryke të mëdha. E, kur e kish gojën pa bukë, kthehet nga e éma, e i thosh:

— Të thashë, moj nëno, të më zgjove shpejt, pse nuk më zgjove?

Prapë e mbushte gojën me bukë të ngjyer. E e éma, duke vështruar të birin me mall, i thesh:

— Je shpejt... je shpejt... s'ka shumë që ra toka e mëngjerezit.

Kola as që i dëgjoi fjalët e së emës. Duke u mbilla-çitur, veshi pallton e trashë e të arnuar, mbathi këpu-çët e rënda, lidhi shaminë qafës, i puthi dorën së emës dhe doli me shpejtësi nga shtëpia.

\* \* \*

Udha ishte e hapur. Kola shkonte me nxitim pa-vënë re gazin, qejfet e nxënësve dhe arriti te porta e dyqanit. Me ta parë që dyqani ishte i mbyllur, mori frymë, shkundi dëborën dhe po priste duke mos i he-qur sytë prej dëborës, që ishte mbledhur te dera. Kur ktheu sytë, pa ustain, që ish i veshur me qyrk, që kish-te dorashka, shoshone dhe një shall të trashë qafës. Kola mezi e hapi dyqanin, pasi e hoqi dëborën me duar. Kur ja ktheu çelësat ustait ai i tha:

— Hajde, djalë... ndize mangallin, po mos para-vërë shumë qymyr.

Kola e ndizte mangallin dhe e vinte pranë ustait. E ai, me ta parë që rrinte pa punë, i thosh:

— Hajde, djalë... fshije dyqanin dhe çap mbush-ujë!

Kola e fshin dyqanin, merr bucelen e shkon pér-ujë. Kur kthehet në dyqan ka mardhur, është bërë-koçan. Po ustai i thotë:

— Hajde, djalë... ndreqi topat.

Kola nis e ndreq topat, i vë në raftet, i zbret dhe prapë i vë e prapë i zbrit, se ua tregon myshterinje, u lëvdon mallin. u bën be që e shesin në serme... E, pasi bie kambana, i thotë ustai:

— Hajde, djalë, shko, çap në shtëpi e na sill dre-kën. — E prej kësaj dreke Kola ha të mbeturat e ustait... Dhe pasdreke prapë fshin dyqanin, mbush ujë, tregon mallin, e shpie në shtëpi e të tjera. Këto zgjatin

gjersa cipa e zezë e mbulon dheun dhe e mbyllin dy-qanin. Atëhere Kola merr frymë, sulet me të katra, vete në shtëpi, ngrohet pranë vatrës e krahëve të së-ëmës dhe thurrëndrrat e jetës.

## FAMILISTI

Në qytetin e bukur Korçë, pasi ikën firarët malevet, fliteshin shumë fjalë: kush thoshte se vajtën në Shqipërinë e sipërme, kush që janë në qarkun e Korçës... kush që shkuan në Gjirokastër dhe shumë fjalë të tjera si këto.

Ikja e banditëvet malevet e ngriti më këmbë gjithë ushtrinë, që kishte qëndruar në Korçë prej xhemietit. U zunë pas punës oficerët, se ata, sapo e mësuan, përnjëherësh bastisën shumë shtëpi shqiptarësh duke dashur të gjenin letra nga komiteti. Sado që nuk gjetën asgjë, futën shumë atdhetarë në burg. Kjo gjë i turbulloi pak shqiptarët, ua pakësoi forcën dhe i mbushi me tmerr.

— Nuk di ç'të bëj unë i ziu — i tha zoti Leci shokut, që e kishte aty pranë duke shkuar udhëvet të ngushta e të qelbura të tregut, nëpër të cilat vozitnin shumë njerëz, po ca më shumë gomerë të ngarkuar me dru, qymyr, qepë, presh, hudhra e me shumë gjëra të tjera, të cilat i këmbejnë me para për të blerë ç'u duhen. Në mes të gomerëvet xheku kishte ndonjë kalë ose mushkë të ngarkuar me drithë. Zilja e mushkavet tingëllonte shumë bukur dhe të kujtonte karvanët, që çanin malet e larta e të mbushura me dëborë.

— Ja, tashi po i bastisnin që të gjithë dhe po i futnin në burg pa faj. Mund të më bastisin dhe mua, se

e dinë që jam shqiptar. Cili nuk më di? Më marrin dhe më përplasin brenda. Prandaj duhet të iki nga ky vend një orë e më parë, se, po të mbetem këtu, e mora veten në qafë... E fika gruan... nënën... i mora më qafë... vetëm nga ajo ndjenjë — dhe pshëretiti disa herë. Miku nuk ju përgjegj dhe shkoi për të blerë ndonjë kilo grurë, se e kishte shtëpinë pa bukë.

Zoti Leci ishte burrë dyzet vjeç. Ishte i zeshkët në fytyrë dhe ngjiste si evgjit. Fytyrën e kishte mjافت të shëmtuar, dhe një mjekër bullanzhe. Që djalë kishte vajtur në mërgim dhe kishte zgjedhur Rusinë, ku i ndihu fati dhe fitoi shumë para. Ngaqë kishte lidhur kokën, u sheshua në Korçë. Zuri të përzihej me qarkun e shqiptarësisë, se i pëlqente që Shqipëria të bëhej më vete. Për veten e tij kishte ide të madhe dhe përpiquej të bëhej kryetar i klubit. Për këtë ofiq, nuk duhen vendosni paratë dhe mendja, po, ca më shumë, titulli i beut dhe disa të tjera, që i shkelnin patriotizmin, zotësinë e të tjerat. Meqë nuk u bë dot as sekretar i këshillit, vajtur dyqan më dyqan, pa e marrë parasysh se ç'ndjenjë kishin. I pëlqente të shiste mendje dhe të përralloste për çudirat e Evropës. Po as që e kuptonte që dobiçët e Korçës talleshin me të.

Dhe, në këtë kohë, Lecit i dukej se mos ja sot, ja nesër, do ta zinin edhe atë. E kishte vendosur të shkon te natën dhe u ngjit për në shtëpi. Kur e pa të shoqen, ja tha mendimin dhe, si i tërbuar, e urdhëroi të bënte plaçkat gati... Kishte ndër mend të kthehej në Rusi, gjersa të kulloheshin punët. Nuk e dinte se si do të mundte të kalonte kufirin. Dridhej i téri, se kishte fri-kë mos e kthenin prapë. Më në fund mori guxim pajtoi arabanë që të nisej natën, e porositi të ëmën, që e la në shtëpi, që të mos i thoshte asnjeriu për ku shkoi.

Pa pashaportë, duke ndarë bakshishe më të djaththë e më të mëngjér, arriti gjer në Stamboll. Atje, me anën e miqvet, mundi të nxirrte pashaportë dhe u nis për në Odesë.

\*  
\* \*  
\*

Ora ishte dhjetë e mëngjezit kur, që nga skela, po ngjitej një karrocë e vjetër, e ndryshkur dhe me rrota të hekurta. Në të ishte mprehur një kalë i dobët dhe si i ngordhur. E kishte kaluar pjesën e vështirë dhe po shkonte nëpër rrugët e drejta. Në këtë karrocë ishte zoti Leci bashkë me të shoqen, që po drejtoheshin për në hotel. Dhe, të shkujdesur që shpëtuan nga vendi i lig i Turqisë e që shkelën në tokë të lirë, shkonin më tutje. Karroca shkonte duke u tronditur e zoti Leci i tha së shoqes:

— Lëre, moj Ksenë, se shpëtuam! — dhe mori frymë lirisht. — Vërtet shpëtuam se, ata të komitetit parndehën se mos i gjerryejmë paratë dhe, pa e vrarë mendjen, më kërkuan 150 lira. Eh! Ç'e ngjet që... Bëmë shumë mirë që ikëm... po të mos kishim ikur, do të shkonim për dhjamë qeni. — E shtrëngoi të shoqen pas mesit, e pa në sy dhe dëgjoi zërin e saj:

— Léri këto më mirë, se mos na dëgjojë njeri. Mirë thonë se dhe muri ka veshë — dhe me buzëqeshje e pa të shoqin.

Zotit Leci nuk i pushonte goja. Gjithë kohën fliste për Shqipërinë, për komitetin, që e shante, për Turqinë, së cilës nuk i la fjalë pa i thënë, për xhonturqit, nga të cilët kishte frikë se mos e futnin në të trallos. Ishte plot gaz që shkeli, më në fund, në atë vend ku kishte jetuar shumë vjet e ku kishte fituar shumë para. Dhe, duke menduar kështu, u zemërua me karrocierin që e ngiste kalin shumë ngadalë. Në këtë kohë qelli ishte i mbushur me re dhe po mblidhej një shtërgatë e keqe. Nga perëndimi po vetëtinte e po gjëmonte dhe dukej që perëndia e reve ishte zemëruar aq shumë, sa ç'ishte zemëruar edhe perëndia e patriotizmit kundër Lecit. Nisi të vesonte, dhe pas ca, ra një shi i tërbuar që e mbyti dheun dhe e bëri qull zotin Leci me të shoqen.

Sado që karrocieri plak, i fislikur dhe i thinjur, pas

të sharave të Lecit, i binte kalit me kamxhik, ai nuk luante më shpejt, po vazhdonte të shkonte me hapa plegërishte. Kur arritën pranë hotelit, me njëmijë mundime Leci ja pagoi paratë, pasi i mbajti një pjesë. Në hotel, pasi i pa të gjithë dhomat, zgjodhi më të lirën dhe u vendos bashkë me të shoqen. Kur pushoi shiu, u vesh, doli në qytet dhe bleu djathë e bukë që të hanin, se në restorant pas mendjes së tij ishte shumë shtrenjtë.

\* - \* \*

Në qarqet e shqiptarëvet të Palmirës së Jugut<sup>1)</sup> u përhap fjala që erdhi nga vilajeti atdhetari zoti Leci. Shumë fjalë fliteshin për të. Cilido desh ta piqte që të mësonte «ç'bënин njerëzit e tij në vilajet». E në jugë të vendit ishin tre djem shqiptarë me ndjenja shumë të zjarrrta. Bisedonin për punën e kryengritjes dhe deshën të formonin një tog prej ndonja 20-25 vetash që të shkonin vetëdashës. Kur e mësuin që erdhi zoti Leci, deshën t'i vinin e t'i kërkonin mendim, se këta e dinin për shqiptar të mirë. Në këtë çast u hap dera dhe hyri një plak, u drejtua nga ana e djemet e zuri vend pranë tyre. Bisëdimi po zgjatej. Plaku, duke pirë kafenë dhe duke hequr cibukun, me rrëmbim u tha djemet:

- Me kë doni të këshilloheni?
- Me zotin Leci, që ka ardhur nga Shqipëria; ai i di shumë mirë punët si qëndrojnë.
- Léreni më mirë. Ai sheh interesin e tij.
- Kush t'i paska futur këto mendime? — e pyetën plakun miqtë.
- Se zoti Leci nuk është patriot, po tradhëtar.
- Kush t'i tha këto, more xhaxho? Mos e gjyko njeriun kaq shpejt!

---

1) Odesa — ku kishte edhe shqiptarë.

— Po të mos e kisha dëgjuar me veshët e mi, as unë nuk do ta besoja. Ju e dini që mjeshteria ime më ka bërë dëshmitar të shumë mistereve politike, dashurie e kusarie. Sot më bëri dëshmitar të zotit Leci. Se, kur ngjitej që nga skela, goditi në arabanë time. Ai ishte i gëzuar që shpëtoi nga komiteti, që i kërkonte 150 lira.

— E dëgjove mirë? — e pyetën miqtë me habi.

— Mirë dhe shumë. Lavdi zotit nuk më kanë lënë veshët. E nga ana ime gëzohem që komiteti ynë nisi të punojë me mend.

— Kështu ë, paska ikur, se i kérkuaka komiteti 150 lira — thanë djemtë duke i dërguar të shara Lecit e duke lavdëruar komitetin.

\*

\* \* \*

Plaku, që e quanin Gjini, ishte nga më të mirët shqiptarë të vërsës së tij. Ishte që nga koha e Vretos dhe kishte ardhur në këtë koloni për të predikuar shqiptarizmin. Ishte prej Kolonje dhe kishte ikur që andej qysh në vogëli. Kishte bërë punëra të ndryshme në Stamboll dhe, shpeshherë, për ndjenjat e tij shqiptare, kishte rënë në burg. Herën e fundit do ta kishin dënuar shumë rëndë, se i gjetën «Historinë e Skënderbeut», po u ndodhën ca miq që e shpëtuan. E hipën në një vapor, që shkonte për në Palmirën e Jugut dhe e porositën që ta përhapte ndjenjën e shqiptarizmës në shqiptarët e asaj kolonie. Këtu me mundime të mëdha e nxirrte bukën e përditshme. Malli për në atdhe e hante, po nuk mundte të shkonte, se nuk kishte para. Në fshat s'i kishte mbeetur asnjeri. Nga letra e fundit, që kishte marrë prej një fshatari, mësoi që i vdiq i vëllai, i cili nuk kishte fëmijë. Këta të tre djemtë, që i gjeti në kafe xhako Gjini, e nderonin plakun, e deshën shumë dhe i kishin blerë kalin me gjithë karrocë që të mundtë të nxirrte bukën e përditshme.

Biseduan gjatë se plaku u tregonte shumë historira. Kur u err fare. Gjini u ngrit dhe shkoi në shtëpi ku e priste kali që t'i vinte tagjinë e t'i jepte ujë. Djemtë dolën në bulevard për të shëtitur pak e për t'u qetësuar nga turbullimi për ato që mësuan rrëth zotit Leci. Dhe, duke e ndarë fjalën të piqeshin të nesërmen në kafe, u larguan.

\*

\* \* \*

Shumë nga atdhetarët kishin vajtur ta vizitonin zotin Leci. Që të gjithë i priste me nderime. Bisedonte gjerë e gjatë, për çështjen kombëtare, u tregonte për shëndetin e miqve e të sojit të tyre, dhe, kur shkonin, i përcillte gjer te dera.

Që kishte ardhur zoti Leci, e kishte mësuar dhe një djalë idealist shqiptar. Ngaqë desh ta mësonte nga goja e tij se ç'ngjiste në Shqipëri, vajti ta vizitonte. I shkoi në hotel, e gjeti, trokëlliti dhe u gjend në odën e zotit Leci. Ja shtrëngoi dorën dhe e pyeti për shëndetin e tij si dhe për të shoqen. Kur mbaroi, e vështroi Lecin drejt në sy dhe e pyeti:

— Ju lutem të më thoni se si venë punët tona andej nga Shqipëria.

Shumë mirë, — ju përgjegj dhe filloi t'ja shkoqitte punërat e malësisë, të cilat ai i dinte shumë më mirë se nuk kishte lënë gazetë pa kënduar dhe e kishte ndjekur politikën me kujdes.

Fjala e zotit Leci e kënaqi dhe, ngaqë pandehu se nuk e kuptoi pyetjen, i tha:

— Ju pyes për punët e Shqipërisë së Jugut.

Me të mbaruar atdhetari, e mori fjalën e, duke e vënë re në sy, se të tjera mendonte e të tjera thoshte, i tha:

— Punërat janë shumë keq. Turqit i zunë gjithë patriotët dhe i futën në burg.

— Po të kishin lidhje, nuk do të ishin kaq keq punët; se, si ç'duket, i zënë frika shqiptarët... — i tha atdhetari.

Zotit Leci ju duk sikur me këtë fjalë desh ta goditte. E mori përsipër dhe, i zemëruar e i nervozuar, ju përgjegj:

— Të jeni afër, pa do t'ju shohim sa para bëni. Që për së largu mund të flisni shumë. Me të vërtetë që shumë nga të jashtmit thérresin, shajnë dhe kritikojnë, po nuk e dinë se atje është puna më e zorshme.

— Keni pak të drejtë, me të vërtet flasin shumë shpenguar... Pastaj propaganda që jashtë është më e iirë dhe që andej është përhapur. Paratë që jashtë kanë hyrë. Ja, nesër-pasnesër, dhe ne do të shkojmë. Po mbledhemi nga një grup i madh, se po na thërrët detyra. Po ju, zoti Leci, si kështu? Sot, në një ditë kaq të nevojshme e latë Shqipërinë? Pse nuk ndenjët? Duhej të kishit mbetur, të ishit atje dhe t'u ndihmonit me para e me çdo send tjetër që do të kishim nevojë. Ju, lavdi zotit, keni, se ju ka ndihmuar zoti. Pastaj, do të mundnit të bënët disa qendra nëpër fshatrat nga ku t'i mbushnit kryengritësit me bukë, opinga, xhupanë dhe me çfarë do të kishin nevojë. Po ju nuk bëtë asgjë. Me ta parë që po turbullohej puna, u ngritët dhe më ardhët këtu ku nuk arrin dora e armikut dhe as të qarat e shqiptarëve. Jo, nuk bëtë mirë; pas mendjes sime ju i sillni shumë dëme kombësisë.

Fjalën e atdhetarit zoti Leci e dëgjoi pa vëmendje, se në këtë kohë mendohej: «Le të mbarojë dhe të qërohet, se shumë po na çan kokën». Shpesh bëhej gati t'ja priste, po e dinte se ashtu do ta zgjatte ca më shumë. Fjalën djali e mbylli me këto fjalë:

— E, tashti ç'keni të thoni?

Zoti Leci u mejtua, kroi kokën, drodhi mustaqet, nxori krehërin kreku mustaqet e mjekrën, që e kishte pak të thinjur. U mejtua dhe një herë t'i fliste apo jo dhe më në fund i tha:

— Hë, more, dhe ti! Të thashë de! Ti po më flet kështu se je larg Turqisë, në vend të lirë; po të ishe atje, pa llafoleshim bashkë. Po unë në erdha këtu, erdha se jam i sëmurë dhe mjekët më këshilluan të bëj banja. Erdha të shërohem dhe jo nga frika dhe as për qejf.

Fjalët e fundit zoti Leci i tha me zë të ulur, se desh t'i jepte fund fjalimit. Atdhetarët këto fjalë e zemëruan dhe i tha:

— Sa bukur, sa bukur! Plagët dhe sëmundjet e trupit tënd dhe të sat shoqeje erdhe këtu t'i shërosh me banja e me mjekë të mirë. Po plagët dhe sëmundjet e Shqipërisë pse nuk mejtohesh që t'i shërosh? Përse nuk e vret mendjen për të aq sa e vret dhe për trupin tënd dhe të thuash: «Si do t'ja shëroj plagët së ngratës Shqipëri!» Sa më vjen keq që u gënjeva, se të kisha pandehur për atdhetar të mirë. Sot Shqipëria ka nevojë për njerëz me pushkë, për njerëz me fjalë e për njerëz me para e ju ngriheni, në këtë kohë, e vini këtu që të shëroni sëmundjet, që nuk i keni.

Zotin Leci nuk e mundonte ndërgjegjja se nuk ndjen te as ndonjë faj. I dukej se i kishte mbaruar të gjitha detyrat. Fjalët e atdhetarit e zemëruan për së tepërmë dhe i tha me zë të lartë e me zemërim:

— Unë e kam mbaruar detyrën time; kam dhënë për komitetin e për shumë gjëra të tjera.

— Po, shumë do të keni dhënë!

— Nuk është puna juaj sa kam dhënë. Po, meqë doni ta dini, mësojeni se kam dhënë shtatë lira të pathyera!

Në këtë çast, kur ende zoti Leci nuk i kishte mbaruar fjalët, u hap dera dhe hynë të tre shqiptarët, që ishin në kafe. I dëgjuan fjalët e tij dhe panë njëri-tjetrin.

Këta, para se të vinin, e menjuan shumë punën e Lecit. Pandehën se mos plaku nuk i kishte dëgjuar mirë fjalët, se këta kurrë nuk e besonin që të mos i jepte komitetit. Pa tashti, që e dëgjuan me veshët e tyre se sa i kishte dhënë komitetit, u siguruan që ashtu ishte puna. Këta dinin shumë mirë që kish gjer më dhjetëmijë napolona. Pa e pyetur për shëndetin e për të rejt nga Shqip-

përia — se e kuptuan që do të mos u thoshte asgjë më rëndësi, ju afroan dhe me zë të lartë dhe me qeshje, i thanë:

— Bravo, zoti Leci, se e paske nxjerrë gomarin nga balta. Besojmë se Shqipëria ka mbetur e kënaqur nga ndihma juaj.

— Me shtatë lira më mburresh, more? — i tha më i riu.

— Pa le, na përzihet kudo dhe do ta nderojnë e ta mbajnë për më të madh — i tha i treti, që ishte pak nervoz.

— Nuk e sheh, more, paska ikur, se i kërkonte komiteti para — tha i pari.

— Po ky as skuqet dhe as verdhet dhe ka sy e faqe të na dalë përpara e të na tregohet shqiptar — tha më i riu.

Zoti Leci desh të fliste, po nuk e linim, se, pa mbaruar njëri, ja rrëmbente tjetri. Nga fjalët e tyre e kuptoi se kush do t'uas kishte thënë. U nevrikos dhe desh ta gjente se nga e kishin marrë vesh. Pasi u mejtua dhe pak, i zemëruar, u tha:

— Më ngadalë, ju lutem, se nuk jemi në mejhane.

Atdhetarët ishin pakësuar aq shumë, sa nga sytë u dilnin shkëndija dhe u dridheshin këmbët e duart. Me të mbaruar Leci, i thanë me zë të lartë:

— Që sot e tutje, dije, se nuk je më shqiptar dhe as do të të njohim për të tillë; ti kurrë nuk e ke vrarë mendjen për kombin.

— Si ke durim të bisedosh me një të tillë — i thanë atdhetarët, i cili nuk kuptonte dot asgjë nga sa flisnin. — Eja të shkojmë, pa jashtë t'i tregojmë që të gjitha.

Pas kësaj zotit Leci ju lëshua goja dhe filloi të shante me fjalë mejhaneje duke u treguar derën dhe, kur mbeti vetëm, shtrëngoi grushtet. Pastaj solli ndër mend të shoqen, së cilës i kishte rënë alivan nga turbullimi, që i erdhë prej fjalëvet, që dëgjoi. Kur i hapi sytë, e pa të shoqin, desh të fliste, po, duke e parë që ishte si i xhindosur, i tha me vështrimin e saj të ëmbël:

— Kur të thashë që dhe muri ka veshë.

Në këtë kohë zoti Leci e mori veten. Erdhi rrotull nëpër dhomë dhe i tha së shoqes:  
— Ç'do t'u bësh që, kur janë të marrë!

\*

\* \* \*

Kishte shkuar më shumë se dy muaj që zoti Leci ndodhej në Palmirën e Jugut. Asnjë shqiptar nuk e vizitonte; në sytë e të gjithëvet ishte tradhëtar. Ky shërohej nëpër limane e nëpër banja. Po ta hasnin gjëkundi, bënин sikur nuk e shihnin. Këto sjellje e pëlcisnin zotin Leci, se brengosej shumë. E kish sëmundje të bënte vizita. Kudo e prisnin ftohtë. Kështu ai e kuptoi që ishte i përbuzur prej të gjithëve.

Në këtë kohë u trash e u bë si ndonjë derr i mbyllur. Ky dhe e shoqja. Për t'u kthyer në atdhe, as ndër mend nuk e shkonte, se edhe nuk ishin kulluar punët. Po më shumë kishte frikën e komitetit, që kish nisur nga vepimi.

Ishte ditë e diel. Këtë ditë gazetat kishin një shënim në rubrikën e ngjarjeve të ditës për një vrasje misterioze. I vrari ishte zoti Leci, siç duket e kish vrarë komiteti. Kjo gjë u mor vesh se mbi trupin e tij gjetën këtë shënim, të cilin po e kuptojmë: «Kishim shumë kohë që i kërkuam 150 lira turku. Këto nuk na i dha. Pritëm shumë kohë me shpresë se do të na i jepte. I dérguam rishtas njoftim, po nuk e gjetëm. Kishte ikur natën, fshehurazi, me shpresë që të shpëtonte. Më në fund e gjetëm në Palmirën e Jugut ku ja kërkuam përsëri. Na i refuzoi me të shara. Nuk na mbetej tjetër rrugë. Ne përpinqemi për gjallërimin e një kombi, kemi dhënë fjalën e nderit dhe jemi betuar që do ta mbarojmë çdo punë, që do të na urdhërojë komiteti. Na erdhi urdhëri që ta vra sim dhe e vramë. Kjo le t'u bëhet mësim të tjerëve, që do

të duan t'i kursejnë të hollat. Ata do të humbin jetën». Poshtë ishte vula e komitetit.

Në varrimin e tij nuk mori pjesë asnjë shqiptar. E përçolli vetëm e shoqja, prifti, dhiakoja, psalltrit dhe ca kureshtarë.

## DASHURIA E MATILDËS

Më në fund na u hoq dhe ngrica... Dëbora u tret, mirëpo na u shtua balta; udhët u bënë të pakalueshme. Kur dola për t'u freskuar pak, qelli ishte fare pa re.

Njerëzit, në të katër anët, ecnin me shpejtësi e gjithsecili shkonte në punën e vet. Unë shkoja me hapa të ngadaltë e të rregullt e plot përtim, se kështu gjeja zbatuje. Pas pak kohe arrita në rrugën kryesore të qytetit ku e kisha bërë fjalë që të takohesha me mikun tim. Arrita më parë e, duke ecur, ëndërroja bukuritë e qytetit të huaj duke i krahasuar me bukuritë e qyteteve të vogla të Shqipërisë. Ky ishte një qytet me bukuri të rrallë: rrugët i kishte të gjera, të gjata e të shtruara me granitë katorë; shtëpitë i kishte të mëdha e me arkitekturë të rrallë dhe... q'ta zgjat se, kushdo që ka parë ndonjë kryeqytet ose qytet të madh, e kupton vetë. Po, me gjithë këto bukuri, një zë i fshehtë ma shfaqte Shqipërinë e më shpinte atje që t'i shihja bukuritë e atjeshme. Dhe përnjëherësh thashë me vete: ... Jo, jo... kurrë nuk do t'i këmbej gurët e Shqipërisë së shtrenjtë me parajsën e çdo qyteti të botës së madhe...

Shkova më tej. Tani isha i çliruar prej mendimeve, se i kisha dhënë fund që Shqipëria është shumë më e bukur, prandaj, sytë e mi, me lakmi kullosnin më të djathhtë e më të mëngjer dhe panë... panë... panë

vajza tē bukura, shumë tē bukura... flokëmëndafshëta, fytyrëmbla, mesholla, gojëvogla, hundëqiriçka, vetull-gajtanka dhe... dhe... se pse përnjëherësh... u drodha prej një ndjenje tē panjohur gjer më atë ditë. U drodha dhe, si automat, i fola një vajze. Përnjëherësh i kërkova ndjesë e, me sytë e mi, i lutesha tē më hidhte një sy... Desha t'i flisja e t'i thosha që zemra ime m'u bë skllave prej bukurisë së saj, që e desha pa masë. Duke ecur e duke menduar kështu, e arrita po, përnjëherësh qëndrova, meqë e cura e saj më pikoi në zemër. I vura re dorën, që e kishte tē bardhë. Edhe gishtërinjtë i kishte si tē skalitur.

E mblodha veten dhe ju sula pas. Ju afrova... ajo nga ana e saj, sikur desh tē ma thyente kurajën, ngriti fustanin sikur desh tē kapërcente ndonjë pellg me baltë. Ja pashë dhe këmbën e saj tē vogël, tē bardhë e tē bukur, e cila, kur ecte, sikur më ndillte pas. Shkova më tej dhe, kur arrita te çipi i rrugës, ajo u kthye. Duke u kthyer, më hodhi një sy, mirëpo unë nuk e kapa dot dhe sérish i rashë prapa duke u sulur. E arrita... po, vetëm ai që ka qëndruar përpëra ndonjë vajze, vetëm ai mund ta kuptojë gjendjen time, se, me t'u afuar, u shtanga, nuk dija ç'të flisja dhe i thashë: «Zojushë! Zojushë!...» Ajo filloi tē më shihte me habi. Shkoi mjaft kohë gjersa e mblodha veten. Në këtë kohë, paditur ç'po bëja, shkoja baras me tē. Më në fund, kur m'u zgjidh gjuha, i thashë.

— Zojushë! Bukuria juaj më bëri t'ju ndjek pas dhe ajo më dha zemër t'ju flas. Më ndjeni se, vërtet, sjellja ime nuk është e pëlqyer, po, nga zjarri i dashurisë njeriu nuk ditka se ç'është sjellja e mirë, nuk ditka fisnikëri, nuk ditka rregulla shoqërie... E kuptoj shumë mirë që sjellja ime është fare e keqe... po... në këto raste njeriu nuk ditka turp, sepse i janë errur sytë e gjykimit. Zojushë, prapë, ju kërkoi ndjesë, po dëgjomëni... dëgjomëni... — Mirëpo ajo nuk desh tē më dëgjonte e, që tē gjitha këto, ja thashë duke shkuar pranë saj.

Po ajo shkontakte shumë shpejt. Kur e arrita prapë, i thashë.

— Zojushë, dëgjomëni... po ju flet një zemër e përlyeme... — S'munda të flisja dhe më, se para syve të mi më qëndroi një hije. Fërkova sytë po, prapë, para meje ishte një grua e gjatë flokëlëshuar dhe e veshur me rroba të zeza; sytë i kishte të zes, ballin të gjërë, hundën të drejtë, gojën mesatare, faqet të rrumbullakëta e të zbeta, mjekrën të plotë dhe vetullat të zeza e të shpeشتë. Në krye thashë se mos ishte po ajo vajza, që e ndiqja pas, po jo... kjo ishte një hije... një hije si e gjallë.

Duke parë këtë çudi, nuk e humba, po vazhdova të sullesha pasë assaj që m'i futi në zemër shtizat e dashurisë, që nuk ishte dhe aq larg. Me ta bërë hapin e parë, gruaja më pushtoi pas krahut dhe më tha:

— O bir! Ku kérkon të mbetesh dhe pas cilës po sullesh kështu? Nuk më sheh që nuk i këmbej dot këto rrobat e zeza, që kam kaq kohë që i kam veshur e që po i mbaj kaq shekuj? Pse nuk po përpinqesh të m'i këmbesh e të më veshësh në të bardha, po vetëm po e shkon kohën duke ndjekur, ja, të tillë si ajo! O bir, o bir! Ju këtu po i harxhon fuqitë në vend të huaj! Eh, unë e mjera! Ende nuk po më njeh? Nuk do të ta them, se dua të më njobësh vetë, dua të pëndohesh, se, po të të heq unë nga kjo rrugë, nuk do të quhet pendim. Vërtet, more djalë, dhe ti ke zemër të nxeh të, vërtet... e kuuptoj shumë bukur, se edhe unë kam qenë njëherë e re po, a do të mund të ta fal këtë punë që të zësh vajzat e një kombi të huaj e të harrosh vajzat e vendit tënd! O fat, o fat, sa keq që na ke ndarë, sa keq që na ke shpërndarë, sa ndyrë që na ke hedhur në vise të huaja! O fat... o fat!

Këto i tha me vajtim, pastaj më shtrëngoi me të dy duart dhe shtoi:

— Mallëkimin tim do ta kesh kurdoherë, more djalë, po të vazhdosh së adhuruari e së dashuri vajza të huaja! Tani do të largohem... mirëpo... po të jetë nevoja, do të vij prapë. — Dhe gruaja e veshur në të zeza u zhduk pa thënë se cila ishte.

E vrava mendjen shumë kohë, po nuk dija se cila ish. Vetëm një gjë më shqetësonte: më kujtonte vendin ku u linda. Në këtë çast thashë me vete: «Ç'e ha tmallë këtë për vendin tim?» e me sy kërkoja vajzën, e cila nuk dukej... Si i xhindosur i rashë gjithë rrugës gjer në fund... e pashë dhe desha t'i afrohesha, mirëpo m'u kujtuan fjalët e zonjës së veshur në të zeza dhe nuk guxova. Kështu shkoi shumë kohë dhe, kur po kthenim çipin, na u bashkuam sytë e buza e saj vajti në gaz. Ju afrova... nuk më kundërshtoi... kështu u njohëm dhe filluam bisedimin për kohën, për theatrot, për modën, për muzikën, për literaturën e për shumë të tjera. Isha i lumtur dhe nuk mendoja asgjë se më dha lejë që ta përcillja gjer afër shtëpisë së saj. Me t'u kthyer në odën time, u shtriva mbi krevat dhe po ëndërrroja për atë që e kisha në zemër e që e quanin Matildë. Më dilte përrpara me buzëqeshjen e saj të émbël, më dukej e bukur si perëndeshë e mbi veshët e mi dégjohej zëri i saj i hollë, që më thosh: «Të dua, pa ty jetën nuk e dua!...»

E ndjeja veten krejt të lumtur dhe thashë: «Fleta e parë e dashurisë është dita e sotme, se fitova gjithësinë!» E, kur rrija kështu, duke ëndërruar, padashur e solla ndër mend atë gruan e veshur në të zeza dhe, padashur, m'u kujtuan fjalët e saj të fundit.

«O fat, o fat, sa keq që na ke ndarë, sa keq që na ke shpérndarë, sa ndyrë që na ke hedhur në vise të huaja, o fat, o fat!..»

Ky kujtim ma ktheu gazon në pikëllim e fillova ta vrisja mendjen që ta gjeja se cila do të ishte ajo zonja e veshur në të zeza.

## II

Kishin shkuar më shumë se dy muaj... Përditë takohesha me Matildën. Bukuria e saj përditë po i shtohej e, fjalët e saj të émpla, më dehnin. E quaja veten të lumtur e më dukej se kjo lumturi do të mos kishte

të sosur. Mbrëmjeve, për herë, takoheshim në parkun e madh, nën drurët e dendur ku nuk hynte as drita e elektrikut. E kisha dëgjuar prej gojës së saj fjalën e ëmbël «të dua» dhe isha i sigurt se ishte e gjitha imja.

Këto takime i mbanim të fshehta, se as ajo nuk u kishte thënë prindërve e as unë nuk u kisha thënë miqve; po, as që kishim biseduar për martesë gjer në këtë ditë. E kjo ishte një e diel pasdreke. Ish ditë vere nga ato me të cilat mund të mburret Palmira e Jugut. Këtë ditë ma kishte ndarë takimin me letër të veçantë dhe unë nuk dija ç'të thesha se, në të shtatëdhjetë e pesë ditët që ishim të njojur, nuk kishim nxjerrë asnë psherëtimë. Në vendin e takimit shkova i pari dhen denja mbi froni, që e kishim quajtur tonin. Zogjtë po këndonin, mirëpo kënga e tyre ish pak e dredhur e me pikëllim. Nuk i dhashë ndonjë rëndësi dhe fillova të shihja qiellin, i cili shkëlgente, po, me të kthyer nga ana tjetër, pashë që në të po ngrihej një re e zezë sterrë; me një fjalë po afrohej shtërgata, se reja po zmadhohej e po zmadhohej. Era e hollë, që frynte mengadalë, i luante fletët dhe e prishte qetësinë. U lodha së prituri dhe, si automat, nxora sahatin dhe e pashë që ish plot ora e takimit. U ngrita në këmbë dhe, pa arritur të bëj as pesë hapa, e pashë që po vinte duke nxittuar. Ju sula dhe e arrita në gjysmën e rrugës. Kur ma zgjati dorën, e shpuri buzën më gaz dhe më pyeti.

— Ke kohë që po pret?

Sikur dëgjova zërin e bilbilit, kur dëgjova fjalët e saj dhe e pashë drejt në sytë e saj larushë, nga të cilat buronte dashuri për mua.

Biseduam mjaft kohë dhe e pyesnim njëri-tjetrin për gjëra të kota. Pastaj ramë në heshtje, të cilën e prisha unë, se i thashë duke qeshur:

— Mos u mundo me mendime të kota, moj e shtrenja ime dhe mos u mërzit, po gëzohu bashkë me mua, se dashuria jonë lyp vetëm gëzime, dëfrime, lodra, kërcime, këngë e kremitme... Po, lyp kremitme se, si të shkojë vera e jetës sonë, do të vijë vjeshta dhe atëhere

do të mos shohim asgjë tjetër po vetëm rënjen e gje-theve.

Matilda heshti dhe pak, më pa drejt në sy, më mori dorën në të sajën, ma shtrëngoi me sa fuqi që kishte e më tha:

— Vërtet ashtu është, more Kolë; vërtet duhet të gëzohemi dhe ta shkojmë kohën me kretime, se kemi verën e jetës sonë. Mirë, shumë mirë... dhe unë jam në një mendje me ty. Po, a do ta shkojmë dot tërë kohën në gjëzime e në kretime, po të vazhdojmë të jemi kështu të ndarë e duke u takuar vetëm nga dy orë ditën? Jo, më duket se kështu nuk plotësohen fjalët e tua, prandaj eja sonte tek im atë që të më kërkosh dorën.

Unë, sado që u turbullova pak, me t'i parë sytë e Matildës, që m'i drejtoi si shkëndija të zjarrta, e mblo-dha veten dhe, pa u menduar shumë i thashë:

— Sonte do të mos mund të vij, se kam shumë punë në zyrë; nesër të më presësh se do të vij të të kérkoj prej prindërve.

Shtatëdhjetë e pesë ditë ndodhesha në një kopshë plot me trëndafilë, me manushaqe, karafilë e me gjithë lulet e bukura të dheut. E në zgjatjen e gjithë kësaj kohe nuk kisha këputur asnjë lule. Matilda desh të ngrihej, mirëpo unë e mbajta duke ju lutur të rrinte dhe pak. Pranoi... Ndenji... më pa drejt në sy... Unë mendohesha: «T'i them apo të mos i them?» dhe vendosa t'i thosha duke u dredhur i téri, e hapa dy-tri herë gojën pa nxjerrë as gjysmë fjale. Më në fund, pasi më dha kurajë me fjalën «folë de, ç'do të më thuash?» i thashë:

— Matildë, dëgjomë se do të tē tregoj një ëndërr që e pashë sonte.

Më pa me habi dhe më tha me pak zemërim:

— Unë po të them folë, ç'do të më thuash, e ti do të më tregosh ëndrra.

— Dëgjomë më parë të lutem, e shtrenjta ime, pastaj thuamë ç'do të më thuash. — Ajo më foli, po unë vazhdova. — Pashë në ëndërr sikur isha në një kopshë

ku ti po rrive mbi një froni tē zbukuruar me turli lule. Me tē tē parë, u drejtova nga ana jote. Nuk kishte asnjeri tjetër. Rreth meje ishin me mijëra rrënjet e trëndafilëve tē thatë. Me t'u afruar, tē pushtova dhe fillova tē tē puthja. Po sa ish çudia ime kur pashë se pas së puthurës gjelbëruan trëndafilët dhe lulëzuan që tē gjithë.

Me t'i thënë këto fjalë, nuk e mbajta dot veten dhe e putha ëmbël. Thashë se do tē më zemërohej, mirëpo jo, se dhe ajo, nga ana e saj mori shembull prej meje... Më në fund e lamë parkun dhe e përcolla gjer në shtëpi. Kur u ndava pér t'u kthyer në odën time, solla ndër mend nënën plakë, që e kisha lënë këtu e dhjetë vjet, babanë tē plakur, që me fuqitë e tij tē dobëta po e mbante jetën me dhëmbë duke pritur me padurim tē më martonte e ta gëzonte pak zemrën e shkretë. Kujtova motrat, vëllain, që mezi i mbaja mend. Që tē gjitha këto më shkuan para syve tē mi... po u zhdukën përnjëherësh, meqë mendimi im më i fortë ishte pér Matildën, prej së cilës sot mora dhuratën e madhe që më ftonte në shtëpi që ta kërkonja pér grua prej prindërve tē saj. Mirëpo unë nuk e dija cili ishte i ati i saj, në ç'shtëpi do tē hyja fis. Dhe kështu, duke menduar, arrita në shtëpi. Nuk më flihej... mora një libër dhe këndova historinë e një djali që harroi nënë e babë e mbeati në vend tē huaj ku u martua. I lodhur nga këndimi, kur mbi xhamet e drithares po trokisin pikat e shiut, më zuri një gjumë i ëmbël.

### III

Tërë natën fjeta me turbullime, se më mundonte një hije. Po... më mundonte... Dhe, pér ta lehtësuar veten, do ta tregoj ëndrrën me gjithë hollësirat e saj. Tani që po e kujtoj, më ngjethen mishrat. Po më mirë le t'juat tregoj:

— Shkoja pranë një shtëpize tē bukur dhe qeshë

dhënë i téri pas mendimeve... këto nuk m'i prishte as trokitja e karrocave, as era e fortë, as shtërgata, që po mblidhej, as të thirrurat e çifutëve, as të sharat e punëtorëve dhe asgjë prej gjëje. Mendohesha pér Matilda dën dhe vetëm pér të... dhe mendoja se si do ta merrja prej krahu që të vinim kurorë... a do të deshnin prindërit e saj të ma jepnin... Pas kësaj solla ndër mend Shqipërinë, nënën, babain, motrat vëllain. Këto më do-lën shpejt prej mejtimit, se vendin e tyre e zuri Matilda dhe më dukej sikur atdheu im, babai im, nëna ime, motrat e mia dhe vëllai i im, ishte ajo dhe vendi ku jetoja. Duke menduar këto, takova udhës një shqiptar, një shokun tim, që ishte martuar me një vendëse. Ky i dinte që të gjitha, po nuk më ra në sy. Vetëm më tha:

— Bëre shumë mirë... Ne tani shyqyr zotit nuk mund të ndjekim zakonet tonë, që janë barbare, ato zakone që stigmatizojnë dhe dënojnë dy zemra, që bashkohen me lidhjen e dashurisë. Më tha dhe shumë gjera të tjera. E unë, si ç'isha i dehur, e dëgjova me kujdes dhe e falënderova pér urimet, që më bëri. Miku, me tu larguar, qeshi me sarkazmë... unë shkova më tutje. Jo... të them të vërtetën... nuk e kisha mendjen në kokë dhe padashur u gjenda para shtëpisë së Matildës... Si pér çudi u hap dera, prej së cilës doli engjëllushja ime... Nuk më tha as gjysmë fjale, po më rrëmbeu prej krahu e më shpuri në shtëpinë e saj. Dhomat ishin të ndriçuara... tryezat të shtruara.... ishin shumë të ftuar. Matilda më shpuri para një burri ndonja 50-55 vjeç, i cili më rrroku pas dore dhe më dha uratën. Pas kësaj më shpuri para një gruaje të thyer, edhe ajo më dha uratën... më në fund më lëshoi në mes të zonjave e të zotërinje. Që të gjitha këto ngjanë shpejt. Unë nuk folla asnjë fjalë, se më qe lidhur goja, ngaqë nuk më hahëj as muhabeti me ata njerëz, që nuk bashkoheshin me karakterin e me natyrën time. Duke heshtur kështu, m'u afroa Matilda. Tani ishte e veshur me rroba të bardha. Ardhja e saj m'i largoi mendimet. Ajo më dha një pako e më tha:

— Na merri... shko në odën tjetër e vishu, se duhet të shkojmë në kishë. Po na presin qëkur... — Shkova në odën tjetër dhe dola i veshur dhëndërr. Me të dalë, nuk më lanë të mejtohem, po më rrëmbyen prej krahu dhe më hipën në një karrocë me kuaj të bardhë e më shpunë në kishë ku ishin gati që të gjithë të kurorës. Qirinjtë ishin ndezur, lustrat që të gjitha shkëlqenin e qelqet e tyre lëshonin që të shtatë ngjyrat e ylberit. Priftërinjtë ishin të veshur me rrobat e shtrenjta e po na prisnin. Me të hyrë, ju afroan babait të Matildës dhe i thanë: «Shumë u vonuat»? Ai nuk u përgjegj. Një prift plak po i thërriste shërbëtorit të kishës. Kur na vunë para konizmës, prifti filloi të këndonte të kurorës e kori që sipër përgjegjej. E ktheva kokën, po nuk pashë asgjë e zérat dilnin shumë të bukur. Kori pushoi, prifti vazhdoi këndimin e tij, e nuni mori kurorat që të na i vinte mbi krye. Në këtë çast u dëgjua një zhurmë, fryu një erë e fortë, që shoi një pjesë të qirinjve edhe pranë meje qëndroi ajo gruaje e veshur në të zeza. Që të gjithë u ngurosëm e ajo na tha:

— Zotërinj e zonja! Ky djalë është imi; ju ma rrëmbyet; nuk do ta lë që të mbetet këtu, në këtë vend të huaj për të. Ka dhe ky atdhe, ka dhe ky nënë, ka dhe ky babë, vëllezër, motra e farë e fis... Që të gjithë ata, si do zot unë, janë të veshur në zi e buza nuk u qesh kurë. E kanë djalë të vetëm dhe dita-ditës po e presin t'u kthehet e t'i gézojë... Po ky?... Ky ç'ka të mbetet këtu... E ju?.. U gézuat, fituat një djalë të tillë... Gjer më sot më keni marrë shumë djem se i gënjeni me lajkat e ndërtitë të vajzave tuaja e m'i shkalloni nga të... — E, duke thënë këto fjalë, më pushtoi nga krahu e fluturoi bashkë me mua. «Matilda», thirra dhe u zgjova.

Kaq ishte ëndrra ime. Kur u zgjova, isha qull prej djersës dhe krejt i rraskapitur. Kur hapa sytë, pashë se në to ishin lot të tharë, të cilët si duket u derdhën nga pikëllimi që më ndanë prej Matildës.

Punë?!. A mund të bësh dot punë kur dëgjohen në zemër trokëllima? A je i zoti ta bësh punën dhe a mund ta mbarosh për të qenë?

A mund ta kesh mendjen në kokë dhe a ke se ç'bën?. Jo... jo... nuk bën dot asgjë me mend; nuk e sheh dot punën; harron atdhe, harron prind... Në zyrë, ku punoja hasësha me pendën në dorë mbi tryezën e madhe dhe në vend të pesës, kruaja treshin; në vend të mbledhjes, bëja zbritje... dhe të gjitha këto ngjisnin, se para syve të mi gjithnjë ishte Matilda... Im zot e kishte vë-në re prej kohësh që bënja shumë gabime, po, meqë kisha kohë që punoja atje, ma falte e nuk më binte në sy, se e kishte kuptuar nga më vinin të gjitha këto. Kur mbarova punën, u bëra gati për të vajtur në shtëpinë e Matildës. Më pushtoi një e dredhur... hapat m'u vogëluan... Duke shkuar kështu për te Matilda, takova rrugës postierin, i cili më dha një letër. Qëndrova para një kopshti publik e ndenja mbi një fron me mendim që ta këndoja letrën. Grisa zarfin, nxora një fije letër dhe fillova ta këndoja. Ishte prej babait; shkruante për mallin, që kishin e që ndjenin për mua. Në letër kishte si me skërfitje të zemrës po ca më shumë u helmova se më shkruante që im më kishte dy javë e sëmurë. Në këtë kohë i gjithë mendimi im u drejtua në shtëpi dhe para syve të mi të gjallë m'u kujtuan shumë gjëra të Shqipërisë: koha e foshnjërisë, sheshet e luadhet ku bridhni, harboheshim e ku ziheshim me gurë; kroi ku mbushnim ujë; vreshtat ku vinim e vidhним rrush. M'u kujtuan lotët e nënës, që i derdhi kur u ndamë... m'u kujtua tanë e shtrirë në rrobat... m'u kujtua qyteti, farë e fisi, malet... të gjitha... Psherëtiva dhe thashë me zë:

— Kam shumë kohë që jam larg teje, atdhe, o në-në!.. — Kopshti ishte plot me drurë... zogjtë po këndonin këngën e vajtimit; siç dukej një djalë sherret do

t'u kishte marrë zogjtë e vegjël... e me gjithë këto menjn e kisha më shumë te Matilda... Tani prapë më kapën të ngjethura... këmbët më qenë rënduar dhe, duke shkuar. ashtu u ndodha pranë shtëpisë së Matildës. E mbloida veten e i rashë ziles... Shërbëtori më shpuri në sallon ku po më prisnin. Dielli po i futte shkëndijat e tij dhe po e zbardhëllonte odën. Me të më parë, u ngritën në këmbët dhe erdhën drejt meje. Unë e humba... u ngurosa e do të isha turpëruar, po të mos më kishte shpëtar Matilda. Ajo më shpuri tek i ati, tek e ëma dhe më njohu me disa miq. Po unë ende nuk kisha ardhur në vete... Bisedimi ish i gjallë; më shumë fliste vjehrri. Unë fola vetëm ndonja dy herë. Kur ora vajti dymbëdhjetë e natës, u drejtova nga vjehrri dhe, duke u dredhur e me mundime, i thashë:

— Zotni, më falni, unë sot kam ardhur në shtëpinë tuaj dhe marr guximin t'ju kërkoj dorën e Matildës, bijës suaj...

Ai më pa drejt në sy e më tha:

— Më dukesh djalë i mirë e i shtruar, paç uratën ime! — Pasi thirri dhe Matildën, na tha: — U trashëgofshi me një jetë të lumtur!

Ishim të lumtur dhe, pasi caktuam edhe ditën e dasmës, u ndamë. Duke u kthyer për në shtëpi, në zemër ndjeja një zë: «Kështu a, gjithnjë kundra do të më vesh... mirë... s'ka gjë... do të vijë dita që do të pendoresh, po do të jetë vonë». Ky zë më shtyu t'i sillja ndërmend njerëzit e shtëpisë.

## V

Kur u ngrita, nuk mendoja asgjë tjetër, vetëm Matildën... I preqatita të gjitha sa duheshin për dasmë...

Paratë që i kisha fituar me aq mundime, nuk i kurseja fare... Njeriu i derdhka që të gjitha për ndjenjën e dashurisë dhe për të qenka gati ta shesë tapinë

e shtëpisë dhe qimet e kresë! Vallë kush nuk ka dë-gjuar për atë që, meqë i kanë marrë dashurinë, është bërë egërsirë me fuqi të rrallë, ka vrarë, ka zhdukur... dhe të gjitha këto, për dashurinë. Kush nuk i mbani menjë prej historisë rolet e mëdha, që ka luajtur gruaja apo më mirë ta themi ajo ndjenja e pagaratshme e dashurisë? Cili nuk e di Dalilën, që e lidhi Samsonin me rripa? Dhe cili prapë nuk e di që, sado që Samsoni kishte njëmijë e një prova që do ta dhunonte, ja tregoi ku i fshihej fuqia, sepse ishte nën urdhërin e dashurisë! Pastaj kush nuk di njëmijë e një që janë prishur mendsh, që janë vrarë e kanë bërë rezillëqe të panumërtë, vetëm e vetëm se kanë qenë nën urdhërin e dashurisë. Miliarda njerëz vuajnë prej kësaj ndjenje, se Venera ka besnikë më të shumtë në botë.

Këtu do të më pyesni, pse na i thua të gjitha këto dhe pse nuk bëre dhe ti ndryshe duke marrë mësim prej tyre? Vërtet, të dashur zotërinj e zonja... kam frikë se do të më gjykon shumë rëndë, prandaj jua them këto, që të ma lehtësoni fajin... Dhe ju do të çuditeni, po duhet ta dini se këto po i shkruaj pasi mbaroi dhe muaji i mjaltit e prej syve më ra perdja, që më kishte veshur dashuria; tani dhe asaj që nuk i gjeja të meta, po i gjej shumë. E çdo ditë po them: «Ah, i ziu unë, ah, unë i mjeri! Ah, ç'bëra që u martova në vend të huaj!» Për dashurinë i harrova që të gjitha: Atdheun, nënën, babain, dhe shokët shqiptarë. Po, dhe ata, meqë më kë-shillonin të mos e bëja këtë punë, u zemëruan e bëjnë sikur nuk më njohin. E unë i harrova që të gjitha për atë, vesën. Shumë veta do të thonë: Ç'gjë quan vesë».

— Vesë quaj dashurinë, se, siç e thanë atë dielli i mëngjezit, ashtu dhe koha e than dashurinë. E në atë kohe, kur nuk desha ta kuptoja që jeta e dashurisë është vetëm një ëndërr, dola një mëngjez dhe e pyeta diellin: «—O diell i bukur, a s'më thuaj, mos ma more ti atë të bukurën e dheut që ma dhe dje duke përenduar?

E ai me një buzëqeshje më përgjegjet: — Do të më

pyesësh se pse po qesh? Pse po qesh? Pse të shoh me habi? Eh, more djalë, ti qenke fare naiv... Qesha me ty, o naivi im, se po kérkon atë që do të mos e gjesh dot kurrë më. Nuk më beson? Nuk më beson?...

Atëhere shiko lëndinën, që është e njomë. A pe të binte shi natën?... Jo... shi nuk ra... këto janë lotët e asaj që të shkoi... Dhe unë do të mos kisha dalë, po më urdhëroi ajo të dal e të mbledh lotët e saj. Dije pra, o djalë, se dashuria mban aq sa do të më duhet t'i mbledn lotët e saj.»

Nuk më foli më, po mori udhën dhe, sa më lart që ngjitej, aq më shumë thahej lëndina. Kur u tha fare, mbi veshin tim u dëgjuan këto fjalë: «Kaq zgjat dhe dashuria».

Më ndjeni... po le ta tregoj punën me radhë. Nuk hasëm asnjë ndalim. Të ftuar kishim shumë. Muzika lozta e ne kërcenim. Kur po vazhdonte ziafeti, më kapi pyetja: «Qindra shqiptarë ndodhen këtu... kam miq... kam soj... kam shokë... Ndava përmi njëqind ftesa e me-gjithatë, nuk ka ardhur asnjë. «Pse të mos kenë ardhur?» M'u hap në zemër një plagë, që më mundonte shumë. Do të mejtohesha dhe shumë, po të mos kishte ardhur Matilda, e cila më pushtoi prej krahu e më shpuri pranë tryezës së shtruar. Që këtu filloj nisja e fundit. Kur ndjenja, më pyeti:

— Pse po rri i brengosur? — Meqë nuk i dhashë përgjegje, vazhdoi: — Unë e di pse? Ti, këtu, po sheh vetém miqtë e mi dhe nuk po sheh asnjë nga të tutë. A duhet të brengosesh për një gjë të tillë, kur më ke mua pranë? Apo, për ty, janë, më të shtrenjtë bashkajetës sate?

Nuk dija ç't'i thosha. Kishte të drejtë, se ja kisha thënë të gjitha që më parë. Po dhe unë kisha të drejtë. Ja që e bëra pa u menduar mirë. Kur u shtruam prasjellje të mirë. E mbajta veten, sado që bisedimi i tyre nuk më pëlqente e fjalët e tyre më dukeshin fare pa

kripë. Me një fjalë që nga dita që hyra në këtë çerdhe, fillova të brengosesha. Kur u ndamë e mbetëm të dy, mora frymë lirisht.

## VI

Jo sikur ishte nata e parë që ishim martuar, po si-kur kishim disa vjet... Po, me të hyrë në shtëpi, prapë u deha prej dashurisë, sepse nuk ishte më ajo atmosfera e sallonit. Fillova ta ndjeja veten të lumtur.

.....

Në mëngjez, kur u ngrita, dielli ishte ngjitur disa hostenë në qiell. Pëllumbesha ende nuk ish ngritur; shërbëtorja na solli kafenë. Rrinim të dy të lumtur edhe asgjë nuk na e prishte qetësinë. Ajo fliste, unë dëgjoja; flisja unë, më dëgjonte ajo. Të gjitha ishin të pëlqyera. Kështu shkoi një javë e tërë. Dhe, si shkoi java, prapë e shkonim kohën me dashuri. Prapë e harrova atdheun, atdhetarët dhe të gjitha. Kështu shkoi tërë muaji i mjal-tit. E pas këtij, mund të them, java e parë shkoi mirë, po të mos i vë në hesap nja dy fjalë të ashpra, që më tha Matilda. E, pas pak kohe, kur një mbrëmje u kthe-va nga puna, asaj ju duk sikur isha vonuar dhe zuri të më shfrynte. Në zemrën time ende ishin ndjenjat e pa-ra, prandaj u përpoqa ta bindja me logjikë. Me shumë mundime e qetësova për gjysmë; por ç'e do, ende ishte buzëleshuar. Nuk i fola më, po, duke heshtur, u largova në odën time. Në këtë çast më pushtuan mendimet. Solla në mend nënën, e cila m'u duk sikur ishte përpara meje e ligur, e verdhur e më shihte më të émbël; m'u dëftyte ftyra e babait, që më shihte me të egër dhe m'u dëgjua një zë: «Prandaj të rrita a?» Pastaj më doli para sysh ftyra e vëllait që ish e pikëlluar e që më tha: «Të

tillë shembuj po më jep, o vëllaçko i dashur?» Pastaj fytyra e sime motre, që ishte plot pikëllim e zëri i saj i hollë më tha: «Qenka thënë që të mos gëzohem unë, po të huajt!» Më në fund më doli fytyra e Shqipërisë bashkë me një vajzë të bukur e zëri i saj më tha: «Nuk ta mbushim syrin ne, po ta mbushën syrin ato që dinë të të grindin». Në këtë çast hyri shërbëtorja, se e kish dërguar Matilda të më thërriste. Vajta. Ajo, me të më parë të brengosur, desh të më bënte skena. Më tha që nuk e desha... që nuk kisha dashurinë e pare që... Më në fund u pajtuam. E, kur rashë të flija, thashë me vete: «Mesi i fundit». Nuk vonoi të vinte dhe fundi i fundit, se, një ditë kur u ktheva vonë, se kishim shumë punë në zyrë, na u ngrit një shtërgatë, prej së cilës dhe erdhi prishja. Këtë radhë m'u zgjua damari i shqiptarit, se, kur fliste, duke bërtitur, unë i bërtisja ca më shumë. Kjo u bë shkak që erdhi fundi i fundit, se shkova nga shtëpia e Matildës dhe tani po rroj vetëm.

## VII

Pas një mot e gjysmë mora ndarjen se, duke e parë që më s'desha të pajtohesha, e kërkoi dhe ajo vëtë. Tani jam i lirë dhe po pres ditën e mirë që të kthhem në Shqipëri ku do të mund ta gjej shokun e jetës sime për tërë jetën.

## **SHPRESA E THYER**

Dielli kish perënduar. Treni shkonte me shpejtim. Bisedimet s'kishin ndonjë temë tjetër, përveç luftës. I lodhur dhe i mërzitur vajta në vagonrestorantin me që-llim ta lakja fytin e thatë. Vagonrestoranti ishte plot me njerëz, po vërejtjen time ma tërroqë një grua e lartë, e bukur, me ngjyrën e fytyrës të zeshkët dhe e veshur me shik parizianeje. Kjo zonjë i hodhi sytë më të kagust e shik parizianeje. Kjo zonjë i hodhi sytë më të kater anët dhe zuri vënd pranë derës. Se kë kërkonte: Zura ta studjoj dhe do të mund të them, pa u 'gabuar, që bashkë me të 30 vjetët të dukej si 20 vjeç dhe kish më të mirat mënyra të shekullit të 20-të. Desha t'ja ktheja vërejtjen, po vështrimi i saj kish punë, se po bise-shihte një djale gjer më ndonja 30 vjeç. i cili po bise-donte me një vajzë. Vajza ish mjaft e bukur, sadoqë e kish hundën pak si të madhe; sytë e saj të zeshkët dhe tē vllagshim<sup>1)</sup> ishin plot më shpirt; vetullat e dëndura dhe të zeza sterri; flokët e zes e të krebur bukur dhe gusha e gjatë të bashkuara me buzëqeshjen e émbël, ja mbulonin 'kusurin e vogël. Mbi veshin tim arrinin ca fjalë, nga të cilat e kuptova që ishin rumunë dhe shkoni-n për në Bukuresht. Bisedimi i tyre përbëlidhej mbi

---

1) vllagshim — me vllagë.

premtime dhe iluzione të jetës së pritme. Ishin të vluar dhe pas ca javësh do të martoheshin.

Gruaja që rrinte pranë derës nuk ja hiqte sytë djalit; po dhe djali e vuri re sapo hyri, e njohu dhe përparrë syve të tij i erdhi tërë koha e shkuar. Ju kujtua ajo dita kur ish edhe nxënës dhe u njoh, tek e motra e martuar, me atë vajzën e turpshme, e cila, tanë, qënka zbukuruar dhe përmirësuar. Ju kujtua koha e gjatë e dashurisë dhe dita fatale kur ja theu jetën. Pastaj ju kujtua si zuri t'i ftohej ndjenja. S'priste ta shihte dhe as që desh se, që nga dita e fundit që e kish parë Dragë, kishin shkuar më shumë se pesë vjet. E unji kokën se kish frikë se mos e njihte dhe ja prishtë tërë punën. Ky u njoh me të bijën e Joneskut, e pëlqeu më shumë për paratë, se sa për bukurinë, se ish bërë njeri me hesap. Koha e intrigave të dashurisë i kish shkuar. Zuri flasë me të vluarën po, mjerisht, mejtimi i kulloste në kohërat e shkuara kur e priste të vinte. Ju kujtua ajo dita kur ju premtua me betime që do ta dojë gjer në ditën e fundit dhe u drodh i téri.

Desh t'i dëbonte këto mejtime dhe porositi garsonin t'i sjellë një shishe me verë, me alkoolin e së cilës desh t'i largonte kujtimet e largme që e mundonin. Në këtë hop syri i tij u bashkua me të Dragës, u skuq... s'mundi ta mbajë veten... e pëershëndoshi, ja zuri dorën dhe, si automat, ja puthi. Draga e hante me sy dhe me dritën e tyre po e qërtonte. Ay e humbi, duke qëndruar si i ngrirë.

Draga i tha:

— Urdhëroni, rrini! Sapo ju pashë, ju njoha, sado që kanë shkuar kaqë shumë vjet.

— Keni ndryshuar shumë... Mezi ju njoha... pastaj, s'e besoja kurrë t'ju shihja në vagonrestorantin e Hungarisë — i tha Taqua me zë të unjtër.

Draga edhe kish dashuri më Taqon. Ajo e kish dashur të tërë kohën dhe tanë, zilia ja ndezi sytë e rrembat dhe e zuri ndër mënd ta çkëputte nga krahët e

asaj hundëmadhes. Nuk dinte si t'i çfaqte të drejtat e saj. Kish pesë vjet që s'e kish parë... nuk ja kish dëgjuar zërin e tij... nuk ja kish ndjerë firomën... Më parë, ay ish i rrëmbyer. Fliste ç'i vinte në majën e gjuhës, kurse tani e peshonte çdo fjalë. Ajo desh ta kish përngaherë, desh ta merrte burrë, se e kuptoi nga fjalët e tij dhe më shumë nga sytë, që martohej përinteres e jo për dashuri, andaj e pyeti:

— Cila është ajo vajzë, me të cilën udhëton?...

Taqua u ndodh në një gjendje të keqe. Desh ta gënjente. S'mundte ta thesh të drejtën, se fjalën që i dha hundëmadhes ja kish dhënë më parë Dragës. Kjo i tha:

— Ki guxim, Taqo! Thuajma të drejtën... S'kërkoj asgjë prej teje... koha të liroi nga betë dhe premtimet. Dua të flas me ty si me mikun e vjetër dhe, që të ta zgjith gojën, do të flas për veten time — dhe, me mjeshtëri artisteje, zuri të lozë rolë:

— Gjashtë muaj pas pjekjes së fundit, të cilën ti duhet ta mbash mënt, më vdiq një ungji im, i cili më la ca miliune. Koha ma shëroi plagën, se ti e di shumë mirë sa kam vuar nga d... Më humbe nga sytë dhe koha më dha të drejtë t'i shkel premtimet që i dhamë shoqi-shoqit te froni i luleve dhe u vluash me një knjaz rus. Tani kthehem në Bukuresht për të rregulluar punët dhe, pas ca muaj, do të shkoj për në Petersburg, ku do të martohemi.

Vajza, me hundën e madhe, tërë kohë vështronte nga ana e Dragës dhe po përgjonte. Bisedimi i tyre ja zbuloi të shkuarën e të vluarit. Duke parë bukurinë dhe elegantësinë e Dragës, kish frikë mos ja merrte të vluarin, fjalët e fundme të tij e qetuan dhe e bënë ta shohë Dragën me sy të ëmbël.

Taqon e zuri të dredhurit. I kujtoi ditët e bardha që kish shkuar me Dragën dhe zuri ta fajtonte veten që sillej aq i ashpër dhe i ftohtë me të. Tani filloi ta dojë përsëri, se dëgjoi që ka shumë para. Ai e dinte që kish influencë të madhe mi të dhe i dukej se, me një

fjalë, do ta bënte të tijnë. E ajo, duke kuptuar ç'mejtonte Taqua, u ngrit, i zgjati dorën dhe, duke mbajtur zemërimin, që i dilte nga ay vënd ku e kish dhe dashurinë i tha:

— Rri me shëndet! U trashëgofsh... gjithkush prej nesh e gjeti fatin — dhe shkoi.

Taqua u kthyte në tryezën e së vluarës si ndonjë zog i plagosur. S'gjente dot fjalë ç'të fliste, se mëndja e tij e tëra ish te Draga dhe ca më shumë te miliunet e saj. Paratë ja këmbyen mejtimet. E vluara e vuri re ndryshimin dhe e pyeste me fjalë të émbla. Ajo s'merrte asndonjë përgjegje, se ay ja priste fjalën duke thënë:

— Lërmë, për kokën tënde, lërmë të qetë, se jam i sëmurë.

— Ç'ke, ç'të dhemb? — e pyeste ajo e turbulluar. Ajo e desh Taqon, se ai ish dashuria e saj e parë. Me ta njohur në shtëpinë e ungjit të saj, pa dëgjuar edhe nga ndonjë tjetër fjalë të mfryta që ta dredhin kokën. e pël-queu dhe e desh, se, pas mëndjes së saj, ky ish i dërguari i fatit. Ai vishej bukur dhe kish gusto në çdo gjë. Kur ja kërkoi dorën, nuk ja kundërshtuan, se zemra e saj ish mbushur me dashuri naive, me të tillë dashuri që do njeriu vetëm herën e parë. Njëmend ajo e njoh dhe me ndjenjën e zilisë. E desh Taqon dhe s'mundte ta linte që t'i shkonte. Ajo e kish dëgjuar që çdo burrë ka një të shkuar, po nuk e dinte se e shkuara nuk shuhet lehtë. I ati i saj po pinte puron i qetë dhe sytë e tij s'panë asgjë. Ai zuri të tregonte rekëza, me të cilat, në vënd që t'i bënte të qeshnin, i malconte që të dy. Taqua ish gati t'ja ipte shkelmin vlesës. Çdo fjalë e saj e zemëronte. E treni shkontakte si vetëtima. Në stacionet, kur qëndron-te, shihje ushtarë, që vinin në kasapanën e botës së madhe, dhe dëgjonje këngët e tyre, me anën e të cilave i lagonin brengat e fshehta.

— Folë-de, ç'pate që rri i mejtar? — e pyeti e vluara Taqon.

— Ja, po mejtoj për punërat që i paralizoi lufta —

ju përgjegj, pasi u mejtua pak. — Tregëtia vdiq, punë-  
ra më s'ka... kapitali po më tretet; si të mos mejtohet  
njeriu.

— Ç'të ardhë njëmend në kokë këto mejtime? —  
ju përgjegj ajo, duke pandehur se mos me të vërtet ato-  
mejtime e mundonin. — Mos u mejto, se ja, pas dy ja-  
vë martohemi dhe do të mundësh t'i ndreqësh punët  
me paratë e mia. — Dhe e shihte veten të lumtur, se  
zilia i kish ikur.

— Mirë thua — i tha Taqua me të ftohtë dhe në-  
trutë e tij i qëndruan këto mejtime: «Me njëzetmijë  
franga kërkon të m'i ndreqë hallet». E në vesh edhe i  
bëhej zëri i Dragës: «Në Petersburg më vdiq një ungji  
im dhe më la ca miliune». Treni arriti në Bukuresht.

\* \* \*

Taqua çdo sekundë e kujtonte Dragën. I dukej  
sikur e desh pa masë dhe tërë ditët i humbiste nëpër  
kafene, restorante dhe hotelet, ku e kërkonte. Kish vë-  
në njerëz më të katër anët, që t'ja kërkonin drejtimin.  
Asandonjë rezultat. Përpara së vluarës përpinqej ta mban-  
te veten të gëzuar. Nuk desh ta humbiste dhe këtë, se  
ay e shihte që, njëmend, Draga ish bërë me karakter të  
fortë dhe s'mundte t'i diktonte. Më parë, dëshirat e tij  
ajo ja mbaronte verbërisht, kurse tanë as që e dëgjon-  
te. Këto i kuptoi ngaqë ky priste ndonjë posulle nga  
dora e saj. «Vallë mos është martuar dhe rron me emrin  
e burrit?» i hynë dyshimet.

Kishin shkuar shumë ditë. Draga, nga ditë, mej-  
tohej për Taqon, mirëpo krenaria me vetëdashjen nuk  
e linin t'i bindej zërit të zemrës, e cila i ish mbushur  
plot me dashuri.

— Sonte do të lozin Evgjeni Oneginin — i tha e  
vluara Taqos. — Babai mori një llozhë. Do të vish me  
ne sonte?

Taqua pranoi, se një zë i brëndshëm i thesh: «Atje do ta gjesh Dragën.»

Kur hynë, në theatro ishin shuar dritat dhe orkestrina po lozta uvertyrrën. Në sallë mbretëronte një heshtje... U hap perdja.... U lojt akti i parë. Në antrakt, Taqua e drejtoi dylbinë më të katër anët. Në llozhën e tretë të radhës së parë e pa Dragën. Ish me ca zonja dhe me ca zotérinj. U verdh në fytyrë dhe e pushtoi të dredhurit. I kërkoi leje së vluarës dhe doli nga llozha. E kish shpresën ta shihte. Desh t'i fliste nga zemra dhe desh t'i kërkonte ndjesë për tërë fajet. Ish gati të bëhej robi i saj. S'dinte ç'të bënte, se ajo s'kish të dilte.

Shëtiti si i lënë në tërë kohën e pushimit. Kur hyri në llozhën me dritë, e vluara i dha dylbinë duke thënë:

— Shiko, atje në llozhë është ajo e njobura jonë. Në zërin e saj çquhej zilia dhe me sy po ja vinte re lëvizjet e fytyrës.

— Çudi si qënka këtu, — i tha Taqua — ajo më tha se shkoi për në Petersburg, dhe, përnjëherë, e këmbeu bisedimin se i dhembte zemra. Në trutë rotullonte platanet që desh t'i bënte në praktikë me miliunet e Dragës. Folën dhe shumë për atë «zonjën me brilante», siç e quante e vluara e tij.

U mbarua akti i fundit dhe njerëzia u ndanë. Taqua i kish dërguar një posullë dhe i lutej të piqeshin në restorant «Kontinental». I dukej se mos e kish punën më vijë. Kur hyri në restorant, e gjeti Dragën që e priste. Ja pushtoi dorën dhe ja puthi me zjarr. Me shenjën e saj ndenji dhe rrinte si i lënë. Nuk dinte si ta niste bisedimin. Draga rrinte e mburrur dhe, me një zë njeriu që e ndjen veten më të lartë nga tjatri, i tha:

— Ç'kishit të më thoshit?

— Desha... T'ju shoh... Ju e dini që dashuria e patë nuk humbet... nuk duhet... Ju, ju kam dashur...

— Më tutje, më tutje, ç'doni të mos thoni? — ja preu ajo.

— Dua... dua të vazhdojmë dashurinë e parë...

— Po e vluara juaj? — i tha ajo.

— Nuk e dua... jo... njëmend u kujtova... Vetëm se nuk e dini ku ndodhi... po... prandaj u vluash me të... Tani e shoh që do të mos jem i lumtur me tjatër.

Në këtë hop hyri në restorant hundëmadhja me t'anë. Ajo e pa Taqon pranë Dragës. I dëgjoi fjalët e tij të fundit dhe i tha t'et:

— Eja të shkojmë që këtu. Më s'mund ta shoh dot me sy... Ai s'është për mua.

Draga s'pa asnjeri. Vojtjet e gjata, që ju kujtuan posa zinxhir, i muar përsipër. Ajo e ksh dashur Taqon shumë... me gjithë zemër... Desh ta lidhte jetën me të, po, megjithato, e urrente se nuk ish i qëndrueshëm. Ju kujtuan fjalët e tij të ftrohta, qërtimet, këshillat dhe ajo dita që i kish thënë drejt në sy: «S'të dua». S'u mbajt dot dhe me zemërim i tha:

— Dije që jam e lirë dhe që do të të dua tërë jetën, po do të përpinqem të mos të dua.

U ngrit duke thënë:

— Rri me shëndet përngaherë, mos u përpinq të më shohësh, — dhe e la Taqon vetëm.

\*

\* \* \*

Më të nesërmen, Taqua po pinte duhan dhe po i sillte ndër mend të gjitha sa ngjanë. E mori dhe një herë letrën që i kish sjellë postieri dhe e këndoi: «Zemra juaj është tepër e gjérë. Më s'jam e vluara juaj. Maria».

*Krime, 1915*

## VASKA, HYSENI E TOLSTOI

Ngaqë së ndënjuri në shtëpi u mërzita, andaj u vesha dhe mora udhën për ne miku im, Hyseni, të cilin e gjeta në shtëpi. Miku posa më pa, u gëzua dhe, duke e lënë letrën që po shkruante, më pyeti:

— As më thuaj si vete nga shëndeti që ishe i sëmu-rë? Je mirë tan? Pastaj nuk bëre mirë që dolle, se kjo mjegulla dhe notia<sup>1)</sup> e sotme, mundin të ta kthejnë sëmundjen, po e pëson ligsht.

E kisha kuptuar, që prej kohe, se miku më do me gjithë zemër dhe kurdoherë kujdesej për shëndetin tim. Mirëpo, unë isha mërzitur duke ndënjur tri javë në shtëpi, pa dalë as nga dera. Po ca më shumë më shtyri të dilja lajmi që këndova në gazetat e fundit që më ardhën nga Rusia: kish vdekur i madhi dhe famëshumi plak Leon Tolstoi. Ky lajm më pikëlloi shumë, andaj duke dashur të lehtësohesha, dolla me mejtim që të vija në miku dhe t'i thosha për humbjen që pësoi bota. Kur pushoi miku, i thashë:

— Vërtet ke të drejtë, Hysen, mirëpo ky lajm më hidhëroi shumë, andaj ardha te ty, qe, duke ta thënë dhe ty, të lehtësohem.

— C'është, — m'u përgjegj me rrëmbim miku — mos na bënë dhe nonjë tjatër gjë xhonërit?<sup>2)</sup> Mos i

1) notia — lagëشتia

2) xhonërit — xhonturqit, turqit e rinj

zunë që të gjithë atdhetarët dhe i dërguan në Jemen ose gjetkë syrgjyn? Oh, ne të mjerët, njëmijë e një pë-suam nga ky i vetëdhënë hyrijet! Thuajma de të shkretën ç'ngjau, se unë nuk jam në vete. Thuajma, të lutem, ç'është, që të dimë ç'të bëjmë; të shkojmë a? Të fshihe-mi gjékundi në ardhka gjer më kaqë? Ose më mirë të marrim armët dhe t'i biem atij më të madhit.

Miku u turbullua shumë; u skuq, u bë i kaltër në fytyrë; fjalët i dilnin me rrëmbim dhe ish gati të vris-te shumë armiq. Unë qëndrova duke thënë:

— Mos u nxeh, të lutem, pa mësuar si qëndron puna, po dëgjomë me gjakftohtësi.

— Si the, more, — ma preu fjalën miku — me gjakftohtësi? Vallë ç'të dëgjoj me gjakftohtësi? Mbyll-jen e shkollave? Konfiskatën e shtypshkronjave? Vras-jet në Shqipëri? Zinë që u suallën ndënjosve apo të burgosurit e atdhetarëve? Pastaj, më thua të të dëgjoj me gjakftohtësi, vallë ç'mbeti pa bërë? Të na marrin që të gjithëve dhe të na pjekin në hell, kjo vetëm mbeti?

Duke i thënë këto, miku u ngrit më këmbë dhe bariste i furosur këtej-andej. Unë e ndjeja veten shumë të dobët dhe padurimi i mikut më dobësoi fare. U ngri-ta më këmbë e zura mikun prej dore dhe i thashë:

— Shumë të lutem, të më dëgjosh dhe të mos ma preç fjalën, se unë dua të të them gjëra të ndryshme dhe jo nga ato që pandeh ti. Puna është se vdiq një shkrimitar i madh i Rusisë. Tolstoin e ke dëgjuar?

— E, e kam dëgjuar, — m'u përgjegj miku me qe-tësi, duke më shikuar mua me çudi, ngaqë ai ish i si-gurt se do t'i flisja për ngjarjet e Shqipërisë. — E ç'ke me të? Vdiq, vdiq, perëndia e ndjeftë!

— Ja, s'më kupton — i thashë mikut dhe e pashë me habitje se nuk e besoja kurrë që do ta dëgjonte vdekjen e famëmadhit shkrimitar me kaqë qetësi dhe pa ndjerë pikëllim. — Unë të them që vdiq më i madhi bu-rrë i botës, e ti më përgjigjesh «ç'ke me të»? Nuk e di ti

që janë të rrallë shkrimtarët si ai? Nuk e di ti që ai  
nuk kishte kundërshtar?

— Mirë the, — m'u përgjigj me zemërim mikë  
dhe më pa me një vështrim të keq, nga i cili kuptova  
që fjalët e mia e mundonin miknë dhe le që nuk gjente  
kënaqësi me të, po edhe shumë mërzitez: — Le të  
qe i math saqë të desh. Kur nuk ish shqiptar, ç'ke me  
të që ish i madh.

Miku edhe pasonte të bariste nëpër dhomë, ngaqë  
ky bisedim, i cili i dukej shumë i mërzitshëm, e lodhi,  
dhe ai ndenji me anën tjatër të dhomës.

Unë u ngritshë nga vendi, i vajta pranë mikut, nde-  
nja më një fron dhe i thashë:

— Si nuk e ke kënduar Tolstoin ti, a? O more,  
dhe ti! Ti paske humbur gjysmën e jetës. — Pasi i tha-  
shë këto, nxora nga xhepi gazetën, e hapa në faqen që  
shkruante për vdekjen e Tolstoit dhe nisa të këndoja  
duke thënë:

— Dëgjomë, të lutem, që të dish dhe ti ku vdiq i  
rralli plak.

— Po, mirë dhe këndo — më tha me mërzitje miku.  
Unë nisa këndimin: «Sot në mëngjez, i rralli dhe i  
pashokëti<sup>1)</sup> plak vdiq në stacionin Astapovo».

— Për perëndi, nuk kuptoj dot asgjë me ty, Vas-  
kë — nisi të më fliste me zemërim Hyseni. — Ngrihesh  
nga shtëpia, në të këtillë kohë, kur shpesh do mundësh  
të marrësh plevitën, dhe më vjen këtu se paska vdekur  
një plak. Po, vdiq dhe vdiq, nuk do bëheshe shkabonjë  
që? Plak ish.

Nisa ta zbutnja mikun dhe me njëmijë e njëqind  
belara mezi e binda. Kur u fut pak brenda në çeshtjen,  
miku më tha:

— A, i këtillë ish ay plaku që vdiq në Astapovo?  
Desh njerëzinë? Predikonte dashurinë, vëllazérinë? Kë-

---

1) i pashokëti — i pashogj.

shtu më thuaj de të shkretën? Ti e ke fajnë, Vaskë, se nuk më the më parë ç'ish, po më the drejtpërdrejt që vdiq një plak.

— Pas mendjes sate kam faj unë, — ja rrëmbeva fjalën mikut — mirëpo, pas mendjes sime, nuk kam faj ngaqë nuk e besoja kurrë që të mos e dije atë famëmadh burrë, që e dinë dhe të egërët e Afrikës.

— A, more dhe ti, Vaskë, se gjer ku vete! Sikur ne kemi shkuar më larg se të Afrikës! Po, ne do kishim shkuar shumë më larg, mirëpo nuk na lanë ata... nu... ç'të ta them që... ata, pa ti e kupton...

— Ata, me të cilët na ka lidhur fati këtu e 450 vjet, kërkon të thuash, Hysen?

— Po ata — ma rrëmbeu fjalën Hyseni. — Ata që thonë se do na i çkulin gjuhën dhe të cilët, pasi e shtroi Shqipërinë Turgut Pasha, e vunë festen mënjanë se e pandehën se mos i mori armët pashai. Po, ata... ata që mos qofshin më mirë!... — dhe heshti miku pak e tha:

— Pa t'i lëmë ata, që m'i lëntë perëndia pa kokë dhe le të vimë ne plaku Tolstoi. Po kështu ë, plaku që vdiq ishte njeri i madh dhe shkrimet e tij janë të rralla.

— Po, i dashur Hysen, shumë më vjen keq që nuk paske kënduar asgjë nga veprat e Tolstoit.

— Po si do mundja t'i këndoja unë, more Vaskë, — m'u përgjegj me buzëqeshje Hyseni — se mos janë shqip? Ti si duket, harrove që unë nuk di rusisht?

— He, po tjatër gjuhë nuk di ti, a? — ja preva fjalën mikut duke ndjerë gaz në zemër se miku nisi ta simpatizonte Tolstoin.

— Po, se mënt harrova; ti përveç shqipes dhe turçes, nuk di tjatër gjuhë. Që të jetë përkthyer Tolstoi turçë, nuk besoj, ngaqë ai më shumë vise gojos Krishtin dhe perëndinë; prandaj nuk e besoj që të jetë përkthyer, se ata janë shumë fanatikë. Pa, sa për shqip, jam i sigurt që nuk është edhe, po munt të ndodhen njerëz që ta dinë gjuhën e tij dhe e përkthejnë dhe shqip, që ta këndojnë dhe ata që nuk dinë gjuhë tjatër.

— Po ktheje ti, — më tha me rrëmbim Hyseni —

ktheje që ta këndoj dhe unë, si dhe shumë të tjerë së unë:

— Mirë. ja do ta përkthej. do të të dëgjoj. o Hysen. Po, që të mund ta përhap, duhet shtypur, e unë që ta shtyp, para nuk kam: botonjës që të ma blenë përkthimin, për fat të keq. ne shqiptarët edhe nuk kemi: pa ta përkthej dhe të lodhem çosa muaj ose vite dhe ta vë në sënduq që ta hajë tymi. nuk kam ndër mend; andaj nuk do ta përkthej, sado që dëshiroj me gjithë zemër që ta bëj këtë punë.

— Për ta shtypur, nuk të zotohem. — më tha duke qeshur Hyseni — po sa për ta kënduar, meqë ma lëvdove kaqë shumë, sado që të kushtojë, do ta ble, se ti shumë më kureshtove.

U fjalosëm dhe shumë orë me mikun gjithë për Tolstoin. Kur unë shkova, miku kish arritur jo vetëm ta simpatizonte, po dhe ta adhuronte.

## II

Tre muaj kishin shkuar që nga dita e vdekjes së Tolstoit dhe të bisedimit me mikun dhe që nga ajo ditë nuk e kisha parë Hysenin. Unë nuk kisha dalë ngaqë miku doli profet, se që atë ditë u ftoha dhe më ktheu sëmundja, mirëpo tashi nuk kisha rënë si ahore, po e kisha plevit. Kisha kthyer për mirë, pasi pësova shumë; po të dilja, nuk kisha marrë leje nga shëronjësi<sup>1)</sup> dhe as që guxoja, se kisha frikë se mos e pësoja fare ligjsh. Mikun nuk e kisha parë dhe më kish marrë malli shumë, po, ngaqë e dija se ndodhej në çiflik, andaj nuk e fajto për mosardhjen e tij. Në atë hop që e kujtova, u hap dera dhe hyri miku i mallëngjyer shumë dhe, me

---

1) Shëronjësi — mjeku.

t'u afruar, pa pyetur si jam dhe si ja shpie, me zë të fortë më drejtoi posa breshër këto fjalë:

— Ama dhe ti, Vaskë, më lëvdove një plak duke thënë që ai është më i madhi shkrimtar i botës. Më marrtë të keqen e Gramenos<sup>1)</sup>, ku di ay të shkruajë. Fundi ç'më ka shkrojtur? Ca përralla, po dhe ato, pa nonjë ëmbëlsirë shkrimi, po me fraza posa të vdekura, me sllog<sup>2)</sup> posa të ngordhur; me fjalë të tjera, plakat tonë mundin të rrëfejnë njëqindmijë herë më të mira. Kur nuk ke kuptuar gjë, ç'të të them unë. Vete më turbullon aqë shumë, sa edhe sot s'e kam marrë veten që nga ajo ditë. Pastaj më quaje të marrë se nuk e dija Tolstoin, i cili paska shkrojtur ca përralla. Ku je ti sa më të mira janë të Kalimasë!<sup>3)</sup> Me të pushuar miku, e mora unë fjalën dhe i thashë:

— Duro pak të lutem se jam sëmurë. Folmë me zë të unjtër dhe mos u turbullo, po rrëfemë çkoqur si qëndron puna që të kuptoj dhe unë. Pa thuajmë, të lutem, si e këndove Tolstoin? Apo mos e këndoi njeri dhe tha ty aqë ligsht sa s'e kuptove?

— Jo, jo, — ma rrëmbeu fjalën miku, — unë e këndova vetë dhe e këndova shqip, ngaqë i lëvduari Aleks Koçi na e përktheu.

— Kush, more! — dhe u hodha nga shtresa. — Aleks Koçi! Ç'thua, more? Po ay e parë e punës nuk di rusishten; pra si mundi ta përkthejë?! Pa nema, të lutem, që ta shoh, ç'ka përkthyer prej të Tolstoit.

Miku futi dorën në xhep që ku nxori një libër të hollë, përbimi të cilën ish fytyra e famëmadhit plak. Me rrëmbim i këndova që të dy rrëfenjat: «Mbret i Asirisë Asarhadoni» dhe «Tri pyetje», të cilat ishin përkthyer jo mirë. Nuk desha t'i ndaja me mikun përshtypjet që më dha përkthimi po, duke dashur që sim-

---

1) Gramenos — Mihal Gramenos.

2) Sllog — fjalitë e dyta ndërmjetëse.

3) Përrallat e «Njëmijë e një netëve».

patia që ja futa pa kënduar Tolstoin t'i mbetej, i thashë:  
— Thuamë, të lutem, ç'domethënë graf?

— Nuk di as unë ç'domethënë kjo fjalë, po si duket do jetë titull. — Dhe më pa drejt miku, ngaqë, si e kuptova, dhe miku do mos e kish vënë re këtë fjalë.

— Po, titull, — i thashë me shpejtim mikut — dhe graf d.m.th. «kont», mirëpo meqë përkthenjësi i di mirë që të dy gjuhët, andaj e la ashtu si ish sllavinçe, nga që u mejtua se do të jetë më mirë që ta huajmë këtë fjalë nga sllavët se sa nga latinët.

— Po sido që të më thuash, me vërtetim<sup>1)</sup> Tolstoi nuk qenka ndonjë njeri i rrallë, se nuk ka ndonjë mejtim të thellë, këtë përrallë dhe jo gjë tjatër.

Fjalët e mikut më vunë të mejtohesha dhe t'i vija pyetje vetes: «Vërtet, shumë do ta humbasin simpatinë që ndjejnë për Tolstoin, duke kënduar të parin dhe të rrallin përkthim në gjuhë shqipe.» Duke mejtuar këto, i shtiva sytë mbi mikun, i cili kish marrë librën e Tolstoit dhe po i shikonte fytyrën. Vështrimet na u bashkuan dhe miku më tha:

— Kjo fytyrë, vërtet, duket si shumë e lëruar.<sup>2)</sup> Po... dhe e preu fjalën, siç dukej, ngaqë nuk desh të më zemëronte, se e kuptoi që unë qeshë adhuronjës i të rrallit plak.

— Dëgjomë, Hysen! Tolstoi madhësinë, nuk e fitoi me «Mbretnë e Asirisë» as me «Tri pyetjet», po e fitoi me të tjera; si, me «Sonatën e Kreutzerit», me «Koza-kët», me «Ana Kareninën», me «Luftën dhe paqen» me «Ringjalljen» dhe me ca të tjera. Këto, o i shtrenjti mik, që për fat të keq na u përkthyen shqip, mund t'i quajmë të shkarat e pendës së Tolstoit. Dhe kështu, të shkarat e penës të të lartit burrë, na i shtiu fati që të na i përkthejnë shqip; pa le me ç'gjuhë? Po, me ç'gjuhë të them dhe dua të të them që gjuha është e pakup-

---

1) me vërtetim — me siguri.

2) e lëruar — e zhvilluar.

tuarshme. — Kur heshta, miku e mori fjalën dhe më tha:

— Po pse, nuk janë këto që të gjitha sa ka shkrojtur Tolstoi? Kur është ashtu, përse nuk ka shkrojtur që vazhdon?

— Prapë nuk më kupton, Hysen! — ju përgjegja mikut. — Këto qenë dy rrëfenja, të cilat u mbaruan, po ka dhe të tjera, se Tolstoi ka shkrojtur më shumë se 15.000 faqe dhe jo vetëm dy rrëfenja, dhe më të shumat janë për shembell.

— He, kështu qenka?! — më tha me pendim miku.

— E unë, pasi këndova këto të paka faqe, nisa të kritikoja të varfërin plak.

— Ti ke të drejtë, — ju përgjegja mikut, me gëzim — se bota, kur përkthejnë, përkthejnë kurdoherë nga më të mirat dhe jo nga më të ligat; se ja këto dy rrëfenja, që u përkthyen shqip aq bukur, sa nuk meritojnë as kritikë, besoj që nuk janë përkthyer as më ndonjë gjuhë tjatër.

Pasi i dëgjoi që të gjitha këto, miku ra në mejtime, dhe pas pak, duke u ngrijtur, më tha:

— Më ndje, se të ngrita prehjen shumë. Ti, edhe të shikoj, qenke i sëmurë. Nga fjalët e tua kuptova që fajin nuk e paska Tolstoi, po përkthenjësi, andaj do pres gjersa të kthehen kryeveprat e Tolstoit, pa këto do t'i këndojo shkel e shko.

Mikun e qëndrova dhe ndenji prapë. Këtë kohë biseduan për shumë gjëra; gjendjen e ligë të Shqipërisë, urinë që mundon të ngratët ndënjosit e të dashurit tanë atdhe, mosmbjelljen e të tre vjetëve, shovinizmën dhe marrëzinë e honeve. Pasi i mbaruan këto, miku duke parë rreth e rrötull, më tha:

— A ke njeri këtu, Vaskë? — dhe më pa me një vështrim të zjarrtë, nga i cili dilnin shkëndija. Unë nuk dija se ç'të mejtoja për këtë dhe i thashë:

— Përse më pyet a ka njeri, Hysen?

— Më thua përse të pyes. Të pyes se dua të të

them ca fjalë, të cilat nuk dua t'i dëgjojë dot tjatër njëri, se kam frikë mos më kallëzojnë.

Pasi mori përgjigje që nuk kish asnjeri tjetër, përveç sime mëje, më tha:

— A do ngrihen vallë malësorët sivjet? A do dalë Isa Buletini?

— Gjethi, i dashur Hysen, ay do na i dëftejë —  
dhe një e teshtitur ma preu fjalën.

Miku, më tha:

— Me shëndet. Vërtet do ngrihen kur do nisë të gjelbërojë gjethi.

Pas kësaj u ngrit, më shtrëngoi dorën dhe më tha:

— Shëndet të dhëntë zoti, Vaskë; rri me shëndet,  
pa Tolstoin do pres që ta këndo — dhe kaptoi prakun.

Në trutë e mi rrrotulloheshin mejtimet: «O i shenjtëruar plak, përse nuk të lënë të qetë atje ku je, nën  
dhenë e Jasnaja Poljanës, po nisin të falsifikojnë ca që  
nuk të kupëtojnë shpirtin, po vetëm fjalët?»

*Odesë, 25.III/911*

---

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

Parathënje .....	3
------------------	---

## KUR RILINDEJ SHQIPËRIA

✓ Pranvera .....	13
✓ Për një telegram .....	16
✓ Pashka në Shqipëri .....	19
✓ Ustai dhe ciraku .....	26
✓ Një faqe nga jeta .....	31
✓ Letrat e vetëdashësit shqiptar .....	34
Dy mejtimet .....	40
Plaku i moçëm .....	50
Dëshmori .....	55
Marko Mjeri .....	59

## PLAGËT E KURBETIT

✓ Çeku i vonuar .....	65
Vuajtjet e kurbetit .....	68
✓ Mallëkimi .....	75
Djali dhe babai .....	81
✓ Mirë mëngjez me interes .....	84
✓ Djali i paprokopsur .....	88